REVISTË MUJORE KULTURORE INFORMATIVE ISLAME

ISSN 1857928 0

Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.372 | Shtator 2022 | Rebiul Evvel - Rebiul Ahir 1444 | Çmimi 50 den

"Hëna e Re", 35 vjet mes sfidave dhe suksesit

HAJRATE PËR SECILIN

Elhamdulilahi Rabbil-Alemin. Përsëri e arritëm këtë muaj, muajin Rabiul Evel, muajin që na përkujton Mevludin e Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, shkruan hoxhë Shefket Baftjari nga Shkupi.

Që nga dita e parë, ky muaj i bekuar do të reflektojë në çdo shpirt e në çdo zemër përmes njohjes dhe afrimit me të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.), përmes së cilës do të shijojë madhështinë e përkujtimit, të dashurisë ndaj Pejgamberit (a. s.), të rregullimit të jetës sonë të dynjasë dhe të ahiretit.

Ndaj dhe, prej obligimeve tona është që në çdo shtëpi, ndejë e mexhlis, dhe kudo që gjendemi, ky muaj i bekuar të shndërrohet në hajrate, në gëzim dhe pajtim, të jetë një sezon kulturor nga i cili do të ndriçohet njeriu besimtar dhe të përfitohet nga njeriu i ndritur, Pejgamberi (s.a.v.s.), duke e lexuar Siren (historinë) e Pejgamberit (a. s.).

Për hair ju qoftë muaji Rabiul Evel! - shkruan hoxhë Shefket Baftjari (Haraçinë).

Vlera e lartë e këndimit të Mevludit, titullohet teksti i hafëz Adnan Kadriut, hoxhë në Xhaminë e Haxhi Hajredinit në Shkup.

Imam Sujuti (r. a.) në librin e tij "Kitabul Uesail fi Sherh Eshemail" thotë: "Në çdo shtëpi, xhami, mëhallë etj. ku lexohet lindja e Pejgamberit (salallahu alejhi ue selem) - Mevludi sherif - atë vend e rrethojnë melaqet dhe atë e përfshin mëshira e Allahut.

Melaqet luten për mirësi e begati për ata që festojnë. Nëse Mevludi këndohet në shtëpi, prej asaj shtëpie largohen varfëria, sëmundjet, zjarri, gjërat e padëshiruara, belatë, fatkeqësitë, smira, urrejtja, syri i keq, hajduti etj.

Nëse personi që ka festuar Mevludin vdes, atij do t'i lehtësohet llogaria te varri. Ai do të jetë në pozitë të lartë. Për shkak se ai ka shfaqur dashurinë dhe gëzimin për zotërinë e dy botëve, Pejgamberin Muhamed - paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Mos i lini banesat tuaja dhe xhamitë pa Mevlud në muajin e Mevludit, shkruan hafëz Adnan Kadri. (HeR/në bashkëpunim)

HIQET RRISKA ME MISH DERRI

Më 28 shtator, 2022, ka reaguar Agjencia për Hallall Standard, që vepron në kuadër të BFI të RMV, pas lajmeve se në marketet "Stokomak" të Shkupit janë vërejtur rriska me mish derri me vulën Hallall.

Në komunikatën për shtyp të Agjencisë, që udhëhiqet nga Muhamer Veseli (drejtor), thuhet:

Të nderuar konsumatorë të marketeve "Stokomak" në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Agjencia për Hallall Standard në Republikën e Maqedonisë së Veriut është institucioni i vetëm në vend që merret me certifikimin e produkteve sipas sistemit Hallall Standard dhe ruan vlerën e logos Hallall. Me këtë rast, e ndjejmë për obligim t'ju njoftojmë se në marketet e STOKOMAK DOO Shkup shitet produkti: rriskë prej mishi, me logon Hallall, por me përbërje edhe të mishit të derrit.

Njoftojmë opinionin se produkti i njëjtë është prodhuar në Republikën e Serbisë dhe i njëjti e ka siguruar logon atje.

Si agjenci, në bazë të detyrimeve kushtetuese të BFI-së dhe statutit të Agjencisë për Hallall Standard, i kemi bërë kërkesë direkte kompanisë së përmendur që urgjentisht ta tërheqë këtë produkt nga qarkullimi tregtar. Njëherësh, Bashkësia Islame e Republikës së Serbisë të ndërmarrë masa në tërheqjen e certifikimit hallall për kompaninë prodhuese.

Shfrytëzojmë rastin që të falënderojmë të gjithë besimtarët myslimanë për paraqitjen e rastit në Bashkësinë Fetare Islame të RMV. Në të njëjtën kohë, apelojmë që raste të tilla drejtpërdrejt të paraqiten në BFI, thuhet në komunikatën e Agjencisë për Hallall Standard të BFI të RMV, pas letrës (nr. 03-61/16) që ajo i ka drejtuar firmës "Stokomak", Shkup, me zinxhir marketesh në tërë vendin më 28 shtator 2022. Në letër është kërkuar

që urgjentisht të tërhiqet rriska me mish derri.

Më pas Agjencia për Hallall Standard ka marrë njoftimin nga drejtori Martin Spasovski ('Stokomak"), në të cilin thuhet: "Ju njoftojmë se fjala është për lëshim, që është bërë pa qëllim dhe artikulli menjëherë është tërhequr nga shitja në të gjitha Marketet."

EDITORIAL

LINDJA E MUHAMEDIT (A. S.), LINDJE E DRITËS UNIVERSALE

Ndriçimi i hënës së re të muajit hixhri Rebbiul-Evvel dallon nga ndriçimi i hënave të reja të muajve të tjerë, ngase në këtë muaj, pikërisht në ditën e dymbëdhjetë të tij, ndriçoi drita që ndryshoi kahet e historisë njerëzore dhe kjo dritë u lind me ardhjen në jetë të Muhamedit (a. s.), i cili, si i përzgjedhuri i Krijuesit të Gjithësisë, e bëri të qartë kufirin mes së mirës dhe së keqes, mes dritës dhe errësirës, mes dijes dhe injorancës, mes moralit dhe amoralit - njeriu që i zhduku padrejtësitë që mbretëronin në shoqërinë e atëhershme; në radhë të parë, ato që bëheshin në baza gjinore, racore dhe fetare.

Muhamedi (a. s.) gjatë misionit të tij pejgamberik i vuri bazat e ekuilibrit të përsosur mes materies dhe shpirtit, të harmonisë së plotë mes trupit dhe shpirtit, të aftësisë dhe diturisë, të dëshirës dhe mundësisë, të tipareve njerëzore dhe atyre shtazarake. Në këtë baraspeshë qëndrojnë karakteristikat themelore të personalitetit, të veprimtarisë dhe të rrugës të të dërguarit të Allahut (xh. sh.), që sot dhe përgjithmonë është model dhe shëmbëlltyrë universale. Misioni i tij në vete përfshin porosi të shumta me vlera shumëdimensionale dhe me vlera të pashtershme, të cilat nuk mbyllen në vetvete as në kohë e as në vend.

Lindja e Muhamedit (a. s.) është një rast i mirë që, duke e përkujtuar misionin e tij, duke e përkujtuar biografinë e tij të lavdishme, duke i përjetuar të gjitha ato që i përjetoi ai për përhapjen e fjalës së Zotit, të bëjmë vlerësimin e punëve dhe të sjelljeve tona, për të parë se të njëjtat janë apo nuk janë në përputhshmëri me mësimet dhe porositë e të dërguarit të Allahut (xh. sh.).

Vlerat shumëdimensionale që i përhapi Muhamedi (a. s.) kanë bërë që ky të jetë personaliteti më madhështor që ka fituar vëmendjen dhe vlerësimin e dijetarëve, të historianëve, biografëve, shkrimtarëve, jo vetëm të kohës së tij, por gjithashtu edhe të atyre në ditët e sotme. Biografia e tij nuk është thjesht biografi e një individi, por edhe e një feje të predikuar prej tij; është vizioni i një epoke të re të njerëzimit.

Shumë mendimtarë dhe hulumtues kanë bërë kërkime të vazhdueshme për të mësuar të vërtetën, vlerat dhe rolin që ka luajtur Muhamedi (a. s.) në historinë njerëzore. Disa dijetarë, veçanërisht ata që janë kthyer nga shtetet myslimane, sollën në Evropë një mendim që ndikoi në evoluimin e mendimit evropian rreth Islamit dhe të dërguarit të Zotit (xh. sh.).

Duke pasur parasysh vlerën e porosive të Muhamedit (a. s.), lirisht mund të themi se për porositë dhe mësimet e të dërguarit të Krijuesit tonë nuk kanë nevojë vetëm myslimanët, por për to ka nevojë i tërë njerëzimi, pa dallim përkatësie gjinore, racore e fetare dhe pa dallim të vendbanimit të tyre. Ndërkaq, ne myslimanët fetarisht jemi të obliguar që të aplikojmë praktikën dhe porositë e Muhamedit (a. s.) në jetën tonë të përditshme.

Pavarësisht kësaj, të gjithë ne së bashku, për të mirën tonë të përbashkët, duke ndjekur rrugën e tij, do të krijojmë një shoqëri të shëndoshë, pa defekte dhe sëmundje të ndryshme shoqërore, të cilat janë shumë të shpeshta në kohën tonë bashkëkohore.

Lindja e Muhamedit (a. s.) është një rast i mirë që, duke e përkujtuar misionin e tij, duke e përkujtuar biografinë e tij të lavdishme, duke i përjetuar të gjitha ato që i përjetoi ai për përhapjen e fjalës së Zotit, të bëjmë vlerësimin e punëve dhe të sjelljeve tona, për të parë se të njëjtat janë apo nuk janë në përputhshmëri me mësimet dhe porositë e të dërguarit të Allahut (xh. sh.).

Me siguri, kjo do t`i jepte një dimension shtesë shënimit dhe përkujtimit të lindjës së Muhamedit (a. s.) në vazhdën e përkujtimeve që bëhen me rastin e lindjes së të Dërguarit (a. s.) anekënd botës.

Të theksojmë se lindja e Muhamedit (a. s.) përkujtohet edhe në vendin tonë, me tubime dhe manifestime të karakterit të ndryshëm, të organizuara nga vetë BFI dhe nga organet dhe institucionet edukativo-arsimore të saj. Këtu do të përmendim organizimin e manifestimit tradicional me moton "Mirë se erdhe, o Resulallah", i cili prej rreth dy dekadash organizohet nga Myftinia e Gostivarit, nën patronazhin e Reis'ul-Ulemasë së BFI-së.

Q. Osmani

Hëna e Re

Botues:
Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame të RMV

Kryeredaktor:
Nazif Zejnullahu

Redaksia:
Qufli Osmani,
dr. Qenan Ismaili,
prof. dr. Qani Nesimi,
prof. dr. Shaban Sulejmani,
Ibrahim Idrizi,
prof. dr. Musa Musai,
Jusuf Zimeri,
dr. Selver Xhemaili,
dr. Abdulkerim Iseni,
Agron Vojnika,
mr. Rejhan Neziri,
Usam Halimi

Redaktimi gjuhësor:
Ali Mashkulli

Redaktor teknik:
Halil Berisha

Telefonat e Redaksisë:
02/31 17 410;
02/ 31 17 412

Adresa:
rr. Çair nr. 52, NMK-1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Numri amë/BFI.RMV: 4069676;
numri tatimor: 4030998340480;
xhirollogaria në denarë:
270040696760488, Halkbank Shkup;
xhirollogaria devizore:
SWIFT code-EXPCMK22,
Halkbank AD Skopje,
IBAN code-MK0727072200027525;
parapagimi për një vit: 740 denarë
për RMV (+ptt), përkatësisht 18 euro
për Evropë (+ptt).

Ueb-faqja:
www.bfi.mk
e-mail: henaerebfi20@gmail.com
rijaseti.bfi@gmail.com

Shtyp:
Shtypshkronja AJ-GRAF matbaa,
Shkup, rr. Atanas Babata nr. 26;
HËNA E RE, tirazhi: 2.000 copë
(5 tetor 2022)

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen.

"HËNA E RE", 35 VJET MES SFIDAVE DHE SUKSESIT

I ka mbyllur me sukses punimet Konferenca shkencore "'Hëna e Re', 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit", që u organizua më 28 dhe 29 shtator, 2022, në Medresenë Isa Beu në Shkup, thuhet në njoftimin e MIB.

Konferenca shkencore u organizua nën patronazhin e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, dhe në të morën pjesë afër 30 akademikë, studiues dhe profesorë nga Shkupi, Prishtina, Tirana e më gjerë.

Konferenca filloi me ashere nga nxënësi hfz. Emrulla Hasipi, moderator i programit të hapjes së konferencës ishte mr. Lutfi Nexhipi, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Medresesë, prof. Ibrahim Idrizi, i priti mysafirët dhe iu dëshiroi mirëseardhje.

Fjala e rastit u mbajt nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, fjalë përshëndetjeje pati Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë h. Bujar ef. Spahiu, në emër të Myftiut të Kosovës përshëndeti Sekretari i Përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës h. Ahmet ef. Sadria, ndërsa në fund foli Kryetari i Këshillit organizativ, Jusuf ef. Zimeri.

Në kuadër të Konferencës shkencore u bë promovimi i veprës "Bibliografia e 'Hënës së Re' nga autori Shaban Ramani. Për librin, që është një përmbledhje e përmbajtjeve të revistës së Bashkësisë Fetare Islame nga viti 1987 deri në vitin 2020, folën Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, redaktori prof. Jusuf ef. Zimeri dhe vetë autori.

Kumtesat e paraqitura ndriçuan shumë aspekte të zhvillimit të organit të Rijasetit, "Hëna e Re", që nga themelimi (në fillim si: "El-Hilal") e deri më sot. Me këtë rast, u nxor konkluzioni që Konferenca shkencore në 35-vjetorin e "Hënës së Re" ishte një rast i mirë për ta parë rrugëtimin e kësaj medie të rrallë në gjuhën shqipe, si zëri i Bashkësisë Fetare Islame dhe i tërë Islamit në këto hapësira e më gjerë.

Po ashtu, u tha që Revista ka nevojë për pasurime të mëtejshme në përmbajtje dhe për rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve, të cilët do të trajtonin tema të ndryshme me interes për lexuesit e saj, numri i të cilëve do të duhej të shënonte rritje.

Një sukses i radhës i BFI-së është edhe digjitalizimi i tërë "Hënës së Re", që tashmë ka filluar dhe një pjesë e tij u promovua në Konferencën shkencore, thuhet në njoftimin e MIB.

Disa lidhje të drejtpërdrejta gjatë dy ditëve, sa i zhvilloi punimet Konferenca shkencore në 35-vjetorin e revistës "Hëna e Re", ka pasur në të gjitha platformat elektronike të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, me qëllim që në kohë reale të informohen të gjithë qytetarët.

FJALA E REISIT NË KONFERENCËN SHKENCORE KUSHTUAR 35-VJETORIT TË "HËNËS SË RE"

***"Nun. Pasha lapsin dhe atë ça shkruajnë."* (Al Kalem: 1)**

- I nderuar Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar ef. Spahiu;
- I nderuar Përfaqësues i Kryetarit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, h. Ahmet ef. Sadria;
- Të nderuar Myftinj dhe Koordinatorë të Myftinive të Bashkësisë Fetare Islame në vendin tonë;
- Të nderuar përfaqësues të institucioneve edukativo-arsimore të Bashkësisë Fetare Islame, të nderuar profesorë e pedagogë;
- Të nderuar drejtorë e përgjegjës të shërbimeve të Rijasetit;
- Të nderuar ju studiues, që sot jeni këtu me kontributet tuaja shkencore;
- Të nderuar të pranishëm;

Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes e t'ju falënderoj në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, të organeve dhe të institucioneve të saj dhe në emrin tim personal për kohën që keni ndarë që të jeni prezent sot me ne, në Konferencën e parë shkencore kushtuar revistës "Hëna e Re", me titullin "Hëna e Re - 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit", për të hedhur pak dritë mbi kontributin e saj historik dhënë në zhvillimin e jetës fetare islame jo vetëm te ne, por edhe më gjerë në rajon.

Jo rastësisht në fillim e lexova ajetin kuranor të kaptinës "El Kalem": "Nun. Pasha lapsin dhe atë ça shkruajnë", ku i Madhi Zot, duke u betuar në shkronjë, në laps dhe në atë që shkruhet, na tregon rëndësinë që ka fjala e shkruar për vetë njeriun, sepse ajo mbetet në histori.

Andaj, konsiderojmë se Vendimi i marrë në vitin 1987, nga ana e Bashkësisë Islame në vendin tonë për botimin e revistës "Hëna e Re", apo "El-Hilal", siç është quajtur në fillim, është vendimi i dytë i radhës me rëndësi të madhe dhe largpamësi për zhvillimin e jetës fetare islame, pas vendimit për ndërtimin dhe hapjen e Medresesë Isa Beu, të nxjerrë në fillim të viteve tetëdhjetë. Pra, gjatë dekadës së fundit të sistemit monist, myslimanët e vendit tonë arritën që të kenë shkollën e mesme islame dhe të kenë shtypin periodik islam dymujorësh, falë punës strategjike të udhëheqjes së atëhershme të Bashkësisë Islame në vendin tonë.

Rrethanat shoqërore-politike të asaj kohe kanë ndikuar që "Hëna e Re" të botohet në tri gjuhë dhe atë: maqedonisht, shqip dhe turqisht. Me ndryshimet e sistemit politik, nga sistemi monist në atë pluralist, ndryshojnë edhe rrethanat shoqërore politike, kështu që Meshihati i Bashkësisë Islame vendos që nga numri 34, janar 1992, "Hëna e Re" të botohet si revistë e veçantë në gjuhën shqipe dhe botimi tjetër i përbashkët në gjuhën maqedonase dhe turke dhe atë një herë në muaj.

Për një kohë të shkurtër revista "Hëna e Re" bëhet udhëzues profesional jo vetëm për lexuesit e shtresave të ndryshme, por edhe për nëpunësit fetarë, sepse me përmbajtjen e saj ajo ofron informacione të hollësishme dhe të organizuara në mënyrë profesionale që kanë të bëjnë me të gjitha fushat e përhapjes, zhvillimit dhe praktikimit të Islamit.

Me kalimin e kohës, "Hëna e Re" gjithnjë ka pasur rol shumë të rëndësishëm në fushën informative e kulturore të shoqërisë sonë, sepse gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur shumë ngjarje me karakter vendimtar për qenien e identitetit tonë fetar dhe kombëtar në këtë nënqiell. Revista "Hëna e Re" është një përkujtues i

përpiktë i ngjarjeve gjatë kësaj periudhe, ngjarje këto shumë të rëndësishme për popullatën myslimane të trevave ballkanike.

Këtu dua të përmend ndryshimet e sistemit shoqëror në shtetin amë, që kishte si rezultat lejimin e praktimit të mësimeve fetare, pas ndalesës administrative që zgjati rreth dy dekada e gjysmë. "Hëna e Re" këtyre ndryshimeve në Shqipëri ua kushtoi një numër special, tirazhin e të cilit e shpërndau po në Shqipëri.

Po ashtu, revista "Hëna e Re" ka shumë informata dhe artikuj të tjerë të rëndësishëm rreth shpërbërjes së Federatës ish-jugosllave, rreth luftërave që ishin rezultat i kësaj shpërbërje, rreth luftës në Bosnjë dhe eksodit të refugjatëve nga ky vend. Në veçanti "Hëna e Re" u është përkushtuar ngjarjeve dhe luftës në Kosovë, eksodit masiv të shqiptarëve në fillim të vitit 1999, më pastaj konfliktit luftarak të vitit 2001 në Maqedoni. Me një fjalë, "Hëna e Re" është edhe dëshmi historike për atë që ka ndodhur gjatë kësaj periudhe me qenien tonë kombëtare.

Përveç ofrimit të materialeve të ndryshme, Revista i ka ndihmuar lexuesit me dinamizmin e informacioneve dhe përditësimin e tyre. Pos kësaj, "Hëna e Re" në përmbajtjen e vet ka punime të shumta nga shumë lëmenj të shkencave islame, të shkruara nga autorë të respektuar të hapësirës kulturore dhe shkencore të vendit tonë, por edhe më gjerë. Ajo ka edhe shumë intervista të personaliteteve fetare e kombëtare me renome ndërkombëtare. Pos kësaj, revista sjell studime nga disa disiplina shkencore: mjekësia, gjuhësia, letërsia, historia etj.

S`ka dyshim se përmbajtja e saj cilësore është rezultat i punës së palodhshme e përkushtuese të bashkëpunëtorëve, autorëve dhe redaktorëve, të cilëve me këtë rast u shprehim mirënjohet dhe falënderimet tona për punën dhe mundin që kanë dhënë në fizionominë dhe disenjimin përmbajtësor të Revistës, e cila tanimë është shndërruar në një burim referues për të gjithë ata që duan të hulumtojnë sfera të ndryshme të cilat janë të lidhura me zhvillimet e jetës fetare në këtë nënqiell.

Duke marrë parasysh këtë që u potencua më lart, thellë jemi të bindur se pjesëmarrësit e kësaj konference me kumtesat e tyre shkencore do t`i thonë vlerësimet e tyre rreth kontributit të revistës "Hëna e Re".

Në fund, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në hulumtimet tuaja të mëtejshme.

Reis'ul-Ulema i BFI të RMV
h. hfz. Shaqir ef. Fetahu

PROGRAMI I KONFERENCËS SHKENCORE

Konferenca është dyditore dhe realizohet më 28-29 shtator, 2022, në **Medresenë Isa Beu** në Shkup.

Dita e parë: 28.09.2022

Konferenca ditën e parë fillon me faljen e përbashkët të namazit të iqindisë në Mesxhidin e Medresesë. Namazi i iqindisë falet në ora 16:00.

- **Hapja solemne e konferencës** ***16:15 – 17:10, me ashere kënduar nga*** **nxënësi hfz. Emrulla Hasipi**
- ***Pauza dhe kokteji: 17 :10 – 17:40***

Promovimi i veprës "Hëna e Re" 17:40 – 18:40

Prezantues (redaktori/recensenti)	**H. Jusuf Zimeri**	**17:40 -17:50**
Referues	Dr. Muhamed Mufaku	17:50- 18:05
Fjala e autorit	H. Shaban Ramani	18:05 – 18:15
Fjala rasti Reis'ul-Ulema	H. Shaqir ef. Fetahu	18:15 : 18:30
Përmbyllja		18: 30

Pauzë 15 minuta 18:30 -18:40.

Seanca e parë më 29.09.2022 me fillim në ora: 18:40 – 19:40

Kryesia e punës: **Abdulkerim Iseni, Ziber Lata, Fahrush Rexhepi**

01	**Dr. Feti Mehdiu**	Prania e Kurani kerimit në *Hëna e Re* 1987- 2017 bazash dhe shihzash.
02	Dr. Sulejman Osmani – Ligjërues në FSI	**Punimet e *Hënës së Re* në peshoren e përmbushjes së standardeve të Hadithit.**
03	Driton Dikena	**Trajtimi i Vakëfit në revistën "Hëna e Re"**
04	Dr. Ziber Lata, ligjërues në FSHI	***Hëna e Re,* mes sfidave të së kaluarës dhe dilemave të së ardhmes.**
05	Dr. Fahrudin Ebibi, ligjërues në FSHI	**Kontributi i revistës "Hëna e Re" në fushën e informimit.**

Përgatitja dhe falja e namazit të akshamit 19:50
Darka në Medrese 20:10

Dita e dytë: 29.09.2022

Dita e dytë e Konferencës do të ketë katër seanca shkencore, kurse Konferenca me punë do të fillojë në orën 9:30.

Seanca e parë: 9:30 – 10:30

Kryesia e punës: **Jusuf Zimeri, Resul Rexhepi, Elez Ismaili**

01	**Dr. Abdulkerim Iseni**	Qasja akaidologjike në *Hënën e Re.*
02	Prof. dr. Fahrush Rexhepi, Prishtinë	**Shkrimet për Muhamedin (a.s.) në revistën *Hëna e Re***
03	Abdulxhemil Nesimi	**Tefsiri në *Hënën e Re.***
04	H. Shaban ef. Ramani	**Pesë autorë që me shkrimet e tyre më së shumti kontribuuan për revistën "Hëna e Re".**
05	Bashkim Mehani	**Arti islam në revistën "Hëna e Re"**

Kafe-pauzë: 10:30 -10:40

Seanca e dytë: 10:40 – 11:40

Kryesia e punës: **Fahrudin Ebibi, Sadik Memeti, Driton Dikena**

01	**Dr. Selver Xhemaili**	Kontributi i revistës "Hëna e Re" në prezantimin e aktiviteteve fetare dhe kombëtare tek mërgata.
02	Resul ef. Rexhepi	**Kontributi i revistës *Hëna e Re* në kultivimin e mendimit sheriatik ndër ne**
03	Ramadan Shkodra	**Kosova në revistën "Hëna e Re" gjatë viteve 90-të të shekullit të shkuar**
04	Mr. Elez Ismaili	**Kontributi i revistës 'Hëna e Re' në promovimin e figurave islame dhe kombëtare.**
05	Dr. Mumin Omerov	**Verskite praznici i mubarek nokji vo spisanieto *Hilal.***

Kafe-pauzë: 11:40 -11:50

Seanca e tretë: 11:50 – 12:50

Kryesia e punës: **Ramadan Shkodra, Muhamer Veseli, Abdulxhemil Nesimi**

01	**Mr. Sc. Ali Sadiku**	Lënda e Kuranit fisnik në faqen e gazetës informative islame "Hëna e Re" (1987-2008)
02	Mr. Muzemil Osmani	**Trajtimi i Hadithit në revistën *Hëna e Re* nga viti 2006-2014.**
03	H. Muhamer Veseli	**Trajtimi i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në revistën "Hëna e Re" dhe mbrojtja e vlerave të saj.**
04	Prof. dr. Sadik Memeti	**Dijetarët shqiptarë në revistën "Hëna e Re".**
05	Jusuf ef. Zimeri	**Trajtimi i Medresesë Isa Beu në gazetën "Hëna e Re" dhe i arsimimit islam në vendin tonë.**

Namazi i drekës ora 13:00 – 13:20

Seanca e katërt: 13:25 – 14:50

Kryesia e punës: **Selver Xhemaili, Rexhep Suma, Muzemil Osmani**

01	**Besnik Jaja**	Kultura shqipe, gjuha dhe letërsia në revistën "Hëna e Re"
02	Mr. Mustafa Dauti	**Revista *Hëna e Re*, promotore e luftës kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.**
03	Dr. Faton Murseli, PhD	**Sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet revista "Hëna e Re" në kohën e digjitalizimit** (nuk ishte i pranishëm)
04	Nizam Reshit	**35 godini na spisanieto *Hilal.***
05	Dr. Rexhep Suma	**Revista "Hëna e Re", agjens i thirrjes dhe mendimit islam në Maqedoni**
06	Nazif Zejnullahi	**Bibliografia e "Hënës së Re" 1987-2020**

Dreka në Medrese ora 15:00 dhe pas drekës përcjellja e mysafirëve.

U PROMOVUA BIBLIOGRAFIA E HËNËS SË RE

Më 28 shtator, 2022, në kuadër të Konferencës shkencore u promovua libri "Bibliografia e Hënës së Re" nga autori Shaban Ramani, thuhet në njoftimin e BFI.
Libri është botuar nga BFI e RMV. Është një vepër shumë e rëndësishme, ku përmblidhen të gjithë numrat e Hënës së Re dhe, me gjithë digjitalizimin e saj, tashmë është hapur rruga drejt hulumtimit më të lehtë të temave të ndryshme në revistën "Hëna e Re". Urime autorit. Zoti e bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

EKSKLUZIVE

Bashkësia Fetare Islame e RMV, me rastin e Konferencës shkencore "Hëna e Re - 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit", sjell për herë të parë, në formë të digjitalizuar, numrat nga 1 deri në 148 të kësaj reviste, me përjashtim të numrave prej 91 deri 113, thuhet në njoftimin e BFI.

Të gjithë të interesuarit mund t'i shkarkojnë këta numra në këtë vegëz:

https://bfi.mk/revista-hena-e-re-numrat-prej-1-deri-148/

TË DHËNA NGA BIBLIOGRAFIA

Nga emrat që më së shumti lakohet në revistën "Hëna e Re" është ai i Qufli Osmanit.

Qufli Osmani në "Hënën e Re" ka mbi dyqind (200) shkrime të natyrave të ndryshme. Është nga autorët që për "Hënën e Re" ka shkruar rreth 140 editoriale, në të cilat ka trajtuar tematika dhe fenomene të ndryshme varësisht nga koha kur është botuar gazeta (revista) "Hëna e Re".

Q. Osmani ka shkruar dhe ka përkthyer edhe disa shkrime me tematikë islame, por ajo që është më interesant nga veprimtaria e tij në "Hënën e Re" është rubrika e "Leksikut islam", në të cilën për 30 numra rresht, më konkretisht prej numrit 35 deri në numrin 65, ka paraqitur leksikun islam në formë të fjalorit, me shpjegimin e tyre në gjuhën shqipe - si në aspektin gjuhësor, ashtu dhe në aspektin terminologjik islam.

Shaqir Fetahu si kuadër i ri dhe i formuar pikërisht në kohën kur ka pasur nevojë "Hëna e Re", pra në fund të viteve tetëdhjetë, është paraqitur edhe me temat e para në "Hënën e Re". Shaqir Fetahu në vazhdimësi është paraqitur me shkrimet e tij në revistën "Hëna e Re" dhe ka mbi njëqind (100) shkrime autoriale dhe rreth dhjetë (10) përkthime.

Shaqir Fetahu me mprehtësinë e penës së tij në revistën "Hëna e Re", si autor, ka trajtuar tematika shumëdimensionale, që përfshijnë një spektër të gjerë të shkencave islame. Më së shumti ka shkruar në fushën akaidologjike, ku ka trajtuar problemet e besimit dhe herë pas here me precizitet ka trajtuar edhe problematikat e fraksioneve të ndryshme, siç janë mu'tezilët, kadijanitë, ahmeditë etj.

Shaqir Fetahu ka shkruar edhe në interpretim, respektivisht në lëmin e tefsirit, siç është komentimi i sures El-Fatiha dhe komentimi i sures El-Xhumua, por gjithnjë me shqyrtime mbi bazat e parimeve akaidologjike...

BUJAR EF. SPAHIU: REVISTA, SI NJË IMAM NË XHAMI

Me ftesë të Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, h. Bujar ef. Spahiu mori pjesë në Konferencën shkencore "Hëna e Re – 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit".

Fjala e Kryetarit Spahiu në Konferencë:

I nderuar Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu, i nderuar Kryeredaktor i revistës "Hëna e Re", gazetarë, redaktorë e analistë të saj ndër vite, profesorë e pjesëmarrës në këtë konferencë.

Është kënaqësi e veçantë për mua të ndodhem sot këtu mes jush në këtë përvjetor të 35-të të revistës "Hëna e Re", botim zyrtar i Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpeshherë bëhet pyetja: Përse shërbejnë në thelb revistat fetare dhe ç'rëndësi, apo çfarë misioni kanë, kur në të vërtetë produkti i saj është Kurani dhe librat e haditheve apo komentet e dijetarëve?

Njëra përgjigje mund të jetë se, libri është baza, është mjedisi dhe atmosfera e mbirjes së filizit. Pra, është ajo fara e parë.

Porse, nga ana tjetër, ka një nevojë të përhershme për të zbërthyer fluksin intelektual e shpirtëror që buron nga libri, dhe këtë gjë e plotësojnë revistat e mirëfillta shkencore, siç është rasti i revistës "Hëna e Re". Nëpërmjet informacionit që përcillet nëpërmjet revistës, si editoriale, shkrimet, komentimet e ajeteve kuranore e haditheve, bëhet i mundur kristalizimi dhe përçimi i fesë te besimtarët e kategorive të ndryshme kulturore e intelektuale.

Në çdo libër ka gjithmonë gjëra që nuk janë lehtësisht të kuptueshme nga kushdo. Për të "korrigjuar" këtë pamundësi të të kuptuarit të librave nga kushdo, për arsye objektive, duhet të shërbejë revista - ajo ka një mision të ngjashëm me atë të një imami, apo ligjëruesi në xhami.

Revista dallohet nga libri njëlloj siç dallohet thellësia e një liqeni me thellësinë e detit.

Botimi i një reviste në mënyrë periodike u përgjigjet gjykimeve më imediate, dyshimeve të shpeshta, kureshtjes së vazhdueshme të besimtarit dhe çdo qytetari.

Revista fetare paraprin, parashikon, zbulon dhe polemizon, madje përgatit edhe përkthyesit dhe shkrimtarët e së nesërmes që mund të botojnë libra në lëmin fetar.

Kur është fjala për fushën e letrave, të botimeve, të revistave etj., 35 vite vazhdimësi janë goxha shumë dhe ky është një moment për të përgëzuar të gjithë kontribuesit që nga dita e parë deri në ditët e sotme.

Nuk është punë aspak e lehtë botimi në mënyrë periodike i një reviste me informacion fetar.

Por, edhe shpërblimet e secilit kontributor ishallah janë të pamata, sepse këtu bëhet fjalë për davanë tonë, për Islamin. Çuarja e mesazhit të drejtë e të pastër të fesë te besimtarët, dhe jo vetëm, është një shërbim i jashtëzakonshëm.

Revista Hëna e Re ka shërbyer si tribunë, ku janë shpalosur njohuritë dhe dijet e personalitetève të ndritura të Islamit në RMV, në Shqipëri e Kosovë, por edhe më tej.

Për mbyllje, duke i uruar jetëgjatësi revistës tuaj, do të shtroja edhe një kërkesë për botuesit e saj dhe siguristh do t'ia sugjeroj edhe botuesve të revistave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Zani i Naltë dhe Drita Islame, për një bashkëpunim më të ngushtë mes jush.

Është shumë i nevojshëm shkëmbimi i informacionit kulturor dhe fetar mes nesh.

Ju falënderoj edhe një herë për ftesën dhe ju uroj shumë suksese më tej!

(Burimi: KMSH)

INSTITUTI I HIFZIT NË SHKUP PROMOVOI HAFËZIN E PARË

Promovohet hafëzi i parë i institutit "Hafëz Ismail Efendiu" në Shkup: Më 30 shtator, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga anëtarët e Kabinetit, nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, nga Kryetari i Kuvendit të BFI-së h. Fejsall ef. Kadriu dhe nga stafi i Myftinisë së Shkupit, ndanë së bashku gëzimin e familjes Idrizi me rastin e promovimit të hafëzit të ri hfz. Sejjid Idrizi, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm hoxhallarë, hafëzllarë, mysafirë, familjarë të hafëzit dhe një numër i madh xhematlinjsh.

Me një program të begatë dhe në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore, u promovua fryti i institutit të hifzit "Hafiz Ismail Efendiu", hafëzi i parë i tij.

I bëjmë lutje Allahut fuqiplotë që hafëzin, muhafizin hfz. Xhemail ef. Nuhijun dhe familjen e muhafizit t'i begatojë me mirësi të shumta në këtë dhe në botën tjetër, thuhet në njoftimin e BFI.

ÇAIR: DUA-HIFZI PËR BUSHRA JAHIUN

Më 13 shtator, 2022, në Xhaminë e Re të Çairit (Shkup) u promovua hafëzja e re Bushra Jahiu. Manifestimi u mbajt në organizim të Myftinisë së Shkupit, me në krye Myftiun dr. Qenan ef. Ismaili, dhe të familjes Jahiu, thuhet në njoftimin e BFI.

Në ceremoni morën pjesë Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal Jakupi dhe anëtarë të Kabinetit, pastaj Kryetari i Kuvendit të BFI-së h. Fejsall ef. Kadriu, profesorë, hoxhallarë, hafëzllarë, mysafirë, familjarë të hafëzes dhe xhematlinj.

Programi filloi me fjalën e Allahut, me ashere, të lexuar nga imami i Xhamisë së Re, hfz. Avni ef. Asani.

Në fjalën e tij përshëndetëse Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili shprehu mirënjohjen e Myftinisë së Shkupit për familjen Jahiu, me faktin që nga kjo shtëpi po del një mbrojtëse e Kuranit, Bushra, që do të jetë e dobishme për veten, kontribuese ndaj familjes së saj dhe gjithë shoqërisë.

Fjalën kryesore e pati Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe foli për vlerën e hifzit, për aktivitetin në vazhdimësi që bën BFI në nxjerrjen e hafëzave të rinj/hafëzeve të reja, të cilët do të jenë mbrojtësit e Kuranit famëlartë.

Në fund, para gjithë të pranishmëve hafëzes iu dorëzua certifikata e hifzit të mbrojtur dhe një laptop nga Myftinia, ndërsa mualimi pranoi mirënjohje dhe një dhuratë modeste për angazhimin e tij.

I bëjmë lutje Allahut fuqiplotë që hafëzes t'ia shtojë dijen e hairit, thuhet në njoftimin e BFI.

Muhafizi hfz. Xhelil Shabani në faqen e vet në Facebook më 1 shtator, 2022, kishte shkruar: "Sot filluam dëgjimin e hafëzes Bushra Jahiu. Allahu i dhashtë shëndet, forcë dhe durim. Bashkë me Komisionin. Allahu e ruajtë nga çdo e keqe. Amin." Ndërkaq, më 10 shtator Muhafizi kishte shkruar: الله دمرحلا "Pas mundimit vjen suksesi. Ishte një ditë e veçantë për hafëzen Bushra Jahiu. Ajo përfundoi hifzin para Komisionit të Myftinisë së Shkupit, duke e lexuar Kuranin brenda 9 ditëve. Sot ishte dita e fundit, gjatë së cilës lexoi xhuzin 28, 29 dhe 30. Urime dhe shumë suksese në vijim. Allahu e ruajtë. Allahu ia bëftë Kuranin udhërrëfyes në jetë. Amin."

Manifestimi me rastin e promovimit të hafëzes së re Bushra Jahiu nga Shkupi u transmetua drejtpërdrejt, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI-së: https://fb.watch/fwpyCo-7JE/.

REISI PARAQITET ME LIGJËRATË NË KONFERENCËN E KAJROS

Më 25 shtator, 2022, përfundoi Konferenca ndërkombëtare në Kajro (Egjipt), ku mori pjesë dhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Në mbrëmje u mbajt seanca e konfirmimit të konkluzioneve të Konferencës, tema kryesore e së cilës ishte "Islami dhe domosdoshmëria e prezantimit dhe aplikimit të tij në sfera të ndryshme".

Fjalimin e përfundimit të Konferencës e mbajti Ministri i Ministrisë së Vakëfit, prof. dr. Muhamed Muhtar Xhum'a. Konferenca është me rëndësi të madhe botërore dhe në të morën pjesë mbi njëqind delegacione nga të gjitha kontinentet.

Bashkësinë Fetare Islame të RMV në këtë konferencë e përfaqësoi Kryetari i saj, i cili që nga ardhja në postin e Reis'ul-Ulemasë merr pjesë për herë të tretë në konferenca të ngjashme në Egjipt. Në këtë udhëtim Kryetarin e BFI e shoqëroi h. Ismet ef. Ademi, Drejtor i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 25 shtator paraqiti ligjëratën e tij në seancën e pestë të Konferencës. Seanca u zhvillua nën udhëheqjen e Shejh Sami Sherif, Dekan i Fakultetit të Gazetarisë në Kajro, me pjesëmarrje të Shejh Halid el Xhundi, anëtar i Këshillit të Lartë për Çështje Islame të Egjiptit; dr. Hasan Musa, Sekretar i Përgjithshëm i Institutit të Vakëfit për Da've dhe Lidhje në Suedi; Shejh Shaban Ali, Myfti i Burundit; Shejh Ahmed Sulejman, anëtar i Këshillit të Lartë për Çështje Islame të Egjiptit.

Seanca zgjati plot një orë e gjysmë. Mendimet e dala nga kjo seancë nxitën interesim të madh në mesin e të pranishmëve, thuhet në njoftimin e BFI.

NË LAJMET QENDRORE TË ARABISË SAUDITE

Me rastin e takimit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Kajro me Ministrin e Vakëfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Shejh dr. Abdul'latif Abdulaziz al-Shejh, gjatë të cilit Kryetari i BFI i uroi Ditën Nacionale të Mbretërisë së Arabisë Saudite, lajmi u dha edhe në lajmet qendrore të Mbretërisë së Arabisë Saudite, në një kronikë speciale për këtë ngjarje, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemaja gjithashtu u falënderua për rregullin e shkëlqyer të Haxhit të sivjetëm dhe vizitën që Ministri mund të bëjë në të ardhmen në RMV, përfundon njoftimi.

Me këtë rast, në platformat elektronike të BFI është transmetuar një video audiovizive në kohëzgjatje prej 47 sekondave nga kronika e emetuar në medien saudite. Transmetimi ka shkuar në këtë lidhje:
https://www.facebook.com/bfinmk/videos/592254469348749

KAJRO: TAKIM ME MINISTRIN EGJIPTIAN XHUM'A

Më 23 shtator, 2022, Ministri i Çështjeve Fetare në Qeverinë e Egjiptit dhe organizator i Konferencës ndërkombëtare, dr. Muhamed Muhtar Xhum'a, mbajti një takim miqësor me pjesëmarrësit në Konferencën e Kajros, ku mori pjesë një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve, ndër të cilët edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me Botën Arabe, h. Ismet ef. Ademi, thuhet në njoftimin e BFI.

I nderuari Ministër, vazhdon njoftimi, falënderoi mysafirët dhe mbajti një fjalim të shkurtër, ku preku disa nga çështjet që kanë të bëjnë me rrjedhat e Islamit në botë, si dhe me rolin e konferencave në shpjegimin e Islamit konform rrjedhave të kohës dhe të vendit. Në diskutim u kyçën edhe personalitete të mirënjohura të botës islame.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu udhëtoi në Kajro më 22 shtator, me ftesë të prof. dr. Muhamed Muhtar Xhum'a, Ministër i Ministrisë për Çështje Fetare dhe të Vakëfeve pranë Qeverisë së Egjiptit, ku do të marrë pjesë aktive në Konferencën ndërkombëtare që do të mbahet atje më 24-25.09.2022.

Konferenca është me rëndësi të madhe botërore dhe në të do të marrin pjesë mbi njëqind delegacione nga e gjithë bota. Tema kryesore e saj do të jetë Islami dhe domosdoshmëria e prezantimit dhe aplikimit të tij në sfera të ndryshme.

Kjo është ftesa e tretë në konferenca të këtilla në Egjipt. Është rast i mirë për afirmimin e BFI të RMV në nivel ndërkombëtar, si dhe për njohjen e BFI dhe të myslimanëve me rrjedhat fetare-shkencore islame në botë, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME MINISTRIN SAUDIT PËR ÇËSHTJE FETARE

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në prag të Konferencës ndërkombëtare në Kajro, më 23 shtator, 2022, u prit nga Ministri për Çështje Fetare Islame të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Shkëlqesia e Tij Abdul'latif AbdulAziz al-Shejh, në apartamentin e tij në Kajro me rastin e pjesëmarrjes në Konferencë, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja i BFI i shprehu falënderime të sinqerta për takimin e organizuar dhe i shprehu urime të përzemërta në emër të BFI të RMV për Ditën Nacionale të Arabisë Saudite (23 Shtator 1932) Eminencës së Tij, Mbretit Selman b. Abdulaziz dhe trashëgimtarit të Fronit, Eminencës së Tij Muhamed bin Selmani, si dhe drejtpërdrejt Ministrit Abdul'latif Abdulaziz al-Shejh, duke i dëshiruar përparim dhe zhvillim edhe më të madh në të gjitha sferat e jetës.

Kryetari i BFI, njëherësh, e falënderoi Ministrin për pritjen dhe organizimin e mirë të Haxhit të sivjetëm nga ana e institucioneve të Arabisë Saudite dhe biseduan edhe për vizitën e Ministrit që pritet të realizohet kah fundi i tetorit.

Ministri i Mbretërisë së Arabisë Saudite falënderoi Reis'ul-Ulemanë për takimin dhe vizitën e bërë dhe foli gjerë e gjatë për zhvillimin e rrjedhave të Islamit në vende të ndryshme të botës, duke potencuar se Islami është fe e paqes, e tolerancës, e humanitetit dhe e zhvillimit të përgjithshëm. Njëherësh, konfirmoi se së shpejti do ta vizitojë Bashkësinë Fetare Islame të RMV.

Në shenjë respekti, Ministri saudit Reis'ul-Ulemasë dhe shoqëruesit të tij, h. Ismet ef. Ademi, u dhuroi nga një Mus'haf të Mbretit të ndjerë Fahd, duke iu dëshiruar çdo të mirë në jetë, thuhet në njoftimin e BFI.

KRYETARI I BFI-së FALËNDERON QEVERINË PËR MEDRESENË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, falënderues për miratimin e Vendimit mbi Propozimligjin për institucionet e arsimit të mesëm të Bashkësive Fetare, thuhet në njoftimin e BFI të datës 30 gusht, 2022.

Në faqen e tij personale, Kryetari i BFI-së ka falënderuar Qeverinë e RMV-së për miratimin e Vendimit mbi Propozimligjin për arsim të mesëm të Bashkësive Fetare, i cili kaloi në Seancën e 75-të të Qeverisë, së bashku me vendime të tjera të rëndësishme.

Në postimin e tij Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu thotë: "Nga vendimet e Qeverisë së RMV: U MIRATUA VENDIMI MBI PROPOZIMLIGJIN PËR ARSIM TË MESËM TË BASHKËSIVE FETARE.

Në Seancën e 75-të të Qeverisë u miratuan vendime të rëndësishme, ndër të cilat edhe:

Mendimi mbi Propozimligjin për institucionet e arsimit të mesëm të Bashkësive Fetare.

FALEMINDERIT TË GJITHËVE. U R I M E!"

Pas këtij miratimi të Ligjit të propozuar, ai së shpejti do të kalojë në Parlament, ku, pas shqyrtimit në Komisione, do t'i nënshtrohet votimit final, thuhet në njoftimin e BFI.

Më 31 dhjetor, 2022, BFI në platformat e saj elektronike ka transmetuar një deklaratë të ministrit të Arsimit, Jeton Shaqiri, në kohëzgjatje prej 55 sekondave, në të cilën veç tjerash thuhet: "Nxënësit e Medresesë do të përfshihen brenda sistemit arsimor dhe do të kenë mundësi të barabarta të konkurrojnë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë."

Me rastin e 1 shtatorit, fillimit të vitit të ri shkollor, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame ka uruar të gjithë bartësit e procesit edukativo-arsimor, nxënësit dhe prindërit e tyre, duke i kujtuar se dija është vlera më e lartë e njeriut dhe investimi në të e afron njeriun më tepër te Zoti i Madhërishëm, thuhet në njoftimin e BFI.

"URIME DITA E DIJES - VITI I RI SHKOLLOR. Sot është dita e parë e vitit të ri shkollor. Është ditë e gëzimit të madh, sepse është ditë e vlerës së shenjtë, dita e dijes dhe e shkencës.

Dija është baza e të kuptuarit të jetës, besimit, moralit, respektit, sjelljes ndaj njeriut, popullit, atdheut dhe njerëzimit në përgjithësi, ka shkruar Kryetari i BFI-së.

Andaj, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, kam nderin dhe fatin që në emrin tim dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV t'u shpreh urimet e sinqerta bartësve të procesit edukativo-arsimor, nxënësve dhe nxënëseve, prindërve dhe familjeve në përgjithësi.

Dija është vlera më e lartë e njeriut, andaj le të investojmë gjithçka në këtë sferë, sepse kjo është rruga e vetme e zhvillimit, e ngritjes dhe e përparimit tonë në sfera të ndryshme të jetës dhe me këtë jemi afër Zotit të Madhërishëm.

Urime. Zoti i bekoftë dijen dhe institucionet e dijes", thuhet në urimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bëhet e ditur në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë (1.09.2022) ka bërë dhe një urim të veçantë për medresantët e Medresesë Isa Beu në Shkup. Në të thuhet:

"Sot është dita e parë e vitit të ri shkollor në SHMI Medreseja Isa Beu. Është ditë e gëzimit të madh, sepse është ditë e vlerës së shenjtë, ditë e dijes dhe e shkencës. Dija është baza e të kuptuarit të jetës, të besimit, moralit, respektit, sjelljes ndaj njeriut, popullit, atdheut dhe njerëzimit në përgjithësi.

Andaj, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, kam nderin dhe fatin që në emrin tim dhe në emrin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Drejtorisë, Këshillit edukativo-arsimor, nxënësve dhe nxënëseve, prindërve dhe familjeve në përgjithësi t'u shpreh urimet më të thella shpirtërore, me lutje drejtuar të Madhit Zot që t'ju japë shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të reja.

Dija është vlera më lartë e njeriut, andaj le të investojmë gjithçka në këtë sferë, sepse kjo është rruga e vetme e zhvillimit, e ngritjes dhe e përparimit tonë në sfera të ndryshme të jetës, në veçanti në sferën e prezantimit të vlerave islame dhe me këtë jemi afër Zotit të Madhërishëm.

Urime. Zoti i bekoftë dijen dhe institucionet e dijes, në veçanti SHMI Medreseja Isa Beu - Shkup dhe Paralelet e Shtrira të saj", thuhet në urimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

MENDIMI POZITIV PËR MEDRESENË ISA BEU

Duhet falënduar institucionin e Zeqatit dhe të Sadakatul-Fitrit, i cili vazhdimisht i ka sfiduar politikat e vendit për mirëmbajtjen e sistemit arsimor fetar në nivel republikan. Është thënie profetike se buka e mund gurin. Pleqtë na thoshin: 'Ti me bukë, ai me gurë. Do të vijë koha kur buka do të fitojë kundër gurit.'

Nga Taxhudin Hamidi

Fitrat dhe zeqati i besimtarëve myslimanë shqiptarë, influenca konstruktive e Qeverisë së RMV dhe një digjital i lëvizjeve progresive: rrufeja mori të gjitha frymat e liga të deritanishme në prag të vitit shkollor 2022/2023.

Golgota e vokabularit dhe kuçedra ateiste me shtatë kokë dhe sy të përgjakur amputoi identitetin antifetar, për t'u konvertuar dhe transferuar në laicizmin liberal perëndimor.

Era dhe suferina e shtatorit na solli një lajm pozitiv dhe shumë konstruktiv në drejtim të shqyrtimit të statusit dhe të akreditimit të shkollave fetare nga Qeveria e RMV-Shkup.

Besimtarët islamë të trojeve shqiptare, në bashkëpunim me BFI-në, me shumë sakrifica dhe mundime ruajtën imazhin dhe vijimin e mësimit në Medresenë Isa Beu, me shumë patriotizëm, me elan për punë, me energji magjike...

Mbështetja e statusit juridik, apo akreditimi i Medresesë nga Qeveria e RMV, pa dyshim se është një lajm i pazëvendësueshëm për kontributin e establishmentit politik, të partive politike, të opinionit mbarëpopullor, influencë e pashtershme e xhematit në të gjitha xhamitë e Republikës, pa harruar shkollat fillore dhe të mesme, universitetet me studentë dhe, së fundmi, guximin dhe gatishmërinë e BFI-së në krye me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Pa dyshim se fjala duhet thënë në çastin e duhur dhe në kohën e cila e përmbledh dhe e justifikon fatin e shoqërisë në rajon, dimensionin dhe platformën e paraqitjes së problemit arsimor-pedagogjik fetar si një koncept përparimtar dhe demokratik, i cili e avancon demokratizimin e shtetit pa rezervë dhe në sytë e korit diplomatik në vend.

Për fat të mirë, në Seancën e 75-të të Qeverisë u miratua Mendimi Pozitiv mbi propozimligjin për institucionet arsimore të Bashkësive Fetare. Ishte ky lajmi i parë, i shumëpritur në prag të këtij viti shkollor.

Shpresojmë që në një të ardhme shumë të shpejtë paraqitja e Poropozimligjit për arsimin fetar do të debatohet në formën më të pëlqyer të mundshme në Kuvend, sepse të gjithë ata deputetë që e kanë karrigen e deputetit aty janë me votën e qytetarëve të krishterë dhe myslimanë, nëse i pyesim për përkatësinë fetare.

Duhet falënduar institucionin e Zeqatit dhe të Sadakatul-Fitrit, i cili vazhdimisht i ka sfiduar politikat e vendit për mirëmbajtjen e sistemit arsimor fetar në nivel republikan.

Është thënie profetike se buka e mund gurin. Pleqtë na thoshin: 'Ti me bukë, ai me gurë. Do të vijë koha kur buka do të fitojë kundër gurit.'

Miratimi i mendimit pozitiv nga Qeveria e RMV po ul tensionet radikale. Gjithashtu, rrymat e ndryshme, të cilat, eventualisht, e kishin imunitetin ekonomik që të manipulojnë me ndjenjat e besimtarëve, po e humbin gjedhen dhe dimensionin e propagandave në shumë sfera të ndryshme.

Në Maqedoninë e Veriut duhet të fillojë era e bashkëpunimit mes Bashkësive Fetare dhe institucioneve shtetërore në dobi të shoqërisë dhe të politikave në rajon e më gjerë.

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

PËR IDENË E PEJGAMBERISË

Nga Ibrahim Idrizi

Dynjallëku është "vend tregu" idesh dhe ideologjish qëkur ekziston kjo botë. Rregulli dhe caktimi i Allahut në këtë botë janë të tillë.

Pasuesit dhe ndjekësit e të Vërtetës, ata që i kanë përcjellë të dërguarit e Allahut, që e përcjellin Muhamedin (a. s.), nuk duhet të kenë frikë për shkak të paraqitjes së ndonjë ideologjie të huaj, por Besimdrejtët duhet të kujdesen dhe të jenë të vëmendshëm për atë se a e kanë përcjellë me besnikëri idenë e pejgamberisë në çështjen e Besimit dhe të Veprimit.

Gjithçka tjetër është jashtë kufijve të mundësive tona.

Allahu e bën caktimin dhe ndodh vetëm ajo që Ai do.

(Autori është Drejtor i Përgjithshëm i Medresesë Isa Beu-Shkup)

AKSION HUMANITAR 'KOMISIONI DHE BASHKËSITË FETARE'

Në bashkëpunim me Komisionin për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze të RMV, më 27 shtator, 2022, në Shkup u organizua një aksion i përbashkët humanitar, me pjesëmarrje të KOM-AO, të BFI të RMV etj., thuhet në njoftimin e BFI.

Përfaqësues të organizatave humanitare të Kishës Ortodokse Maqedonase – Arkipeshkopia e Ohrit, të Bashkësisë Fetare Islame, të Kishës Katolike dhe të Kishës Ungjillore, së bashku me drejtorin e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), vizituan familjet e rrezikuara sociale në rajonin e Shkupit dhe dhuruan ushqime, produkte higjienike dhe zhvilluan biseda të ngrohta me ta,

duke i inkurajuar në përballjet e tyre me sfidat që vijnë si pasojë e krizës aktuale.

Aksioni mbahet edhe për të dërguar mesazhin se në një kohë të tillë krize na duhet një solidaritet, bashkim, dhembshuri, të cilat mund t'i shprehim bashkërisht. Edhe pse bindjet tona janë të ndryshme, u përkasim popujve të ndryshëm, flasim gjuhë të ndryshme, të gjithë e kemi të përbashkët të qenët njerëz dhe kjo shihet në humanizmin tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

KËRÇOVARJA OFRON TËRË PASURINË PËR XHAMI

Në historinë islame kemi shumë shembuj të bukur të ndihmës dhe të sakrificës në rrugë të Allahut të madhërishëm, të cilët i lexojmë me ëndje dhe na rrëqethet trupi, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Kërçovës, mr. Qamil ef. Rushiti.

Por, për mua, sot shembulli ishte i veçantë: nuk e lexova, por e përjetova.

Sot, 14 shtator, 2022, në zyrën time duket që pata mysafirin historik të detyrës sime, edhe atë një Nënë besimtare, e cila më tha: "Jam këtu të ofroj tërë pasurinë time për ndërtimin e një xhamie të re në Kërçovë. Këtë vendim e kam marrë pasi i kam kryer obligimet ndaj familjes dhe pjesën tjetër e investoj në xhami - për shpirtin e bashkëshortit tim të ndjerë, me të cilin kemi jetuar dhe punuar mbi tridhjetë vjet në Zvicër."

I befasuar nga vendimi dhe gatishmëria e flaktë e kësaj Nëne, mora përsipër që të bëjmë gjithçka që amaneti i saj të realizohet. I thashë që do të angazhohemi maksimalisht, në bashkëpunim dhe me ndihmën e institucioneve, me Bashkësinë Fetare Islame dhe me Komunën e Kërçovës, që ta vëmë edhe praktikisht në jetë këtë projekt në të mirë të myslimanëve të Kërçovës.

Allahu i madhërishëm e shpërbleftë dhe i dhashtë jetë e begati! – thuhet në njoftimin Myftiut të Myftinisë së Kërçovës.

Të njëjtën ditë ky njoftim ishte emetuar edhe nga TV Uskana, Kërçovë: https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid

"Sot morëm pjesë në Seminarin e dytë për këtë vit kalendarik dedikuar imamëve të Zvicrës, të organizuar nga SZIG dhe FIDS, me temë: 'Imamët si faktorë në xhami dhe në shoqëri - sfidat, rolet dhe perspektivat'. Seminari i parë u mbajt më 28 mars 2022 në Hotel Lilienberg, Ermatingen (TG), kurse ky i sotmi në Xhaminë Shqiptare në Wil (SG)", ka shkruar Imam Rejhan Neziri (Kreuzlingen) në faqen e vet në Facebook më 26 shtator, 2022.

MYFTINIA E DIBRËS ME OBJEKT TË MADH AFARIST-VAKËF

Me ftesë të Myftiut të Myftinisë së BFI-Dibër, h. Reshat ef. Kaçallniku, një delegacion i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 26 gusht, 2022, qëndroi në mesin e besimtarëve dibranë. Reis'ul-Ulemaja shoqërohej edhe nga teologu i mirënjohur mr. Eljesa ef. Hasani, Drejtor i Institutit të Hifzit në Gostivar dhe Referent i Myftinisë së Gostivarit, thuhet në njoftimin e BFI.

Kreu i BFI-së me Myftiun e Dibrës bisedoi për rrjedhën e punëve në Myftininë e Dibrës, për aktivitetet e kësaj myftinie dhe për projektet që janë në realizim e sipër. Reis'ul-Ulemaja mbeti i kënaqur me vullnetin dhe ambiciet e kësaj myftinie, në krye me Myftiun dhe bashkëpunëtorët e tij.

Delegacioni i BFI namazin e xhumasë e fali në faltoren e mirënjohur Xhamia e Konjarës, ku imam është teologu i mirënjohur dr. Kujtim ef. Mirzo, i cili me sukses të madh e udhëheq këtë xhematë të mirënjohur. Ai i bëri një pritje vëllazërore Kreut të BFI dhe shoqëruesve të tij.

Reis'ul-Ulemaja i foli xhematit nga minberi i Xhamisë, ndërsa namazin e xhumasë e fali mr. Eljesa ef. Hasani, i cili njihet me zërin e tij të bukur, me çka fascinoi xhematin e shumtë të Dibrës.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të

RMV e vizitoi Myftininë e Dibrës me synimin kryesor: që të përcjellë nga afër punimet në objektin e madh afarist që po ndërtohet në suaza të Myftinisë së Dibrës.

Gjatë kësaj vizite Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përcolli me vëmendje dhe nga afër punën në këtë objekt, i cili është vakëf, dhe shprehu kënaqësinë e tij për angazhimin e Myftinisë.

Kryetari i BFI mbeti i kënaqur me rrjedhën e ndërtimit, që është në fazën përfundimtare, kështu që objekti shumë shpejt do të futet në funksion dhe do të jetë një burim shumë i mirë financiar në mbështetje të jetës fetare islame. Objekti është me një madhësi prej 800 metra katrorë.

Mbi bazë të protokollit të Myftinisë së Dibrës, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 26 gusht pati edhe një takim me bashkatdhetarët tanë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Myftinia e Dibrës, në krye me Myftiun Reshat Kaçallniku, takimin e organizoi në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin që japin për Dibrën bashkatdhetarët, si dhe për angazhimet e tyre në SHBA në kultivimin e vlerave kombëtare, fetare dhe gjithënjerëzore.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemaja pati një fjalim vëllazëror para mërgimtarëve, me ç'rast i njoftoi të gjithë me angazhimet e Bashkësisë Fetare Islame të RMV në përgjithësi dhe më pas u bisedua për shumë çështje me rëndësi. Në fund, Myftiu i Dibrës falënderoi të pranishmit dhe shprehu kënaqësinë për këtë tubim vëllazëror, thuhet në njoftimin e BFI.

MYFTINIA E GOSTIVARIT ANALIZON AKTIVITETET

Më 21 shtator, 2022, Myftinia e BFI-Gostivar mbajti mbledhjen e saj, për të shqyrtuar të gjitha rezultatet dhe aktivitetet e periudhës së Ramazanit, të Haxhit dhe të Kurban-Bajramit: me Sadekatul-Fitrin dhe Zeqatin dhe ndarjen e mishit të kurbaneve, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte kjo Mbledhja e Tretë e rregullt për vitin 2022 dhe me të kryesoi Myftiu i Myftinisë së Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli. Ai në mënyrë të hollësishme i njoftoi anëtarët e Myftinisë me të gjitha aktivitetet gjatë kësaj periudhe.

Mbledhja nisi me lexim Kurani nga mr. Eljesa ef. Asani-Drejtor i Institutit të Hifzit dhe të Bukurleximit të Kuranit Famëlartë dhe përgjegjës i Sektorit për kulturë në Myftininë e Gostivarit.

Mbledhjen e nderoi me pjesëmarrje Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me bashkëpunëtorët e tij: h. Irsal ef. Jakupi-Sekretar i Përgjithshëm i BFI dhe dr. Abdulkerim ef. Iseni-Shef i Kabinetit të

Reis'ul-Ulemasë. Me këtë rast Reis'ul-Ulemaja mbajti fjalën e rastit në fund të mbledhjes, duke e vlerësuar tejmase punën e Myftinisë së Gostivarit për këto të arritura gjatë vitit 2022, në periudhën nëntëmujore. Ai potencoi se Gostivari në vazhdimësi edhe më mirë po jep rezultate të shënuara në nivel të lartë, fakt i cili tregon koordinimin e mirë mes imamëve, këshillave të xhamive dhe xhematit.

Të gjithë anëtarët e Myftinisë i elaboruan dhe i diskutuan në detaje të gjitha aktivitetet e bëra brenda kësaj periudhe nga të gjithë sektorët e Myftinisë me materiale të shkruara.

Me këtë u përmbyllën edhe pikat e diskutimit, për çka u jemi mirënjohës anëtarëve të Myftinisë, imamëve, mualimëve, myderrizëve, myezinëve, këshillave të xhamive, xhematit, si dhe të gjitha strukturave të tjera organizative në nivel lokal dhe qendror, që nuk kursyen asgjë nga vetja e tyre për këto të arritura të përbashkëta, thuhet në njoftimin e BFI.

NË MESIN E BESIMTARËVE TË MANASTIRIT

Me ftesë të Myftiut të Manastirit, h. Amit Rasimi, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga dy bashkëpunëtorët e tij - z. Nizam Reshit dhe z. Driton Dikena, më 31 gusht, 2022, vizitoi Myftininë e BFI-Manastir dhe u takua me besimtarët e këtij qyteti, me ç'rast pati mundësi që të vizitojë dhe të përcjellë punët e kryera nga kjo myftini, thuhet në njoftimin e BFI.

Myftinia e Manastirit i ka kryer punët me sa vijon: 1. Punët në Xhaminë Haxhi Mahmud Bej - e cila është një vepër e përkryer dhe në përfundim e sipër; 2. Punët e kryera te varrezat myslimane, si: ndërtesa e shërbimit funeral me të gjitha kushtet, me sallonet për pritje e ngushëllime, rrugicat e varrezave, rregullimin dhe pastrimin e tyre; 3. Vizita Xhamisë Koxha Kadi, e cila do të restaurohet nga Drejtoria e Vakëfeve e Turqisë; 4. Vizita e fshatit Llazhec, ku u takuan me disa nga besimtarët e fshatit Llazhec, ku me dekada pamundësohet ndërtimi i xhamisë dhe aty u këqyrën vendet dhe mundësitë e gjetjes së rrugëdaljes deri në ndërtimin e xhamisë për nevojat e besimtarëve të këtij fshati; 5. U panë dhe analizuan vendet dhe objektet që janë në proces për denacionalizim; 6. U vizitua Xhamia Hajdar Kadi e bukur, ku delegacioni i BFI me në krye Reisul Ulemanë fali namazin e drekës dhe u takua me besimtarët, duke ndarë pak kohë për të dëgjuar hallet dhe gëzimet e tyre; 7. Po ashtu, u përcollën punët e ndërtimit të Qendrës së Re Kulturore (për zhvillimin e mësimbesimit islam dhe aktivitete të tjera), e cila vërtet është një objekt i bukur, me të gjitha kushtet – tani, në përfundim e sipër; 8. Dhe në fund, ajo që ishte synimi kryesor i vizitës së Reis'ul-Ulemasë në Myftininë e Manastirit: u nënshkruan dy protokolle me Drejtorinë e Vakëfit të Turqisë, një donacion i madh për restaurim dhe revitalizim e Hanit të Manastirit dhe të pesë lokaleve afariste, si pjesë përbërëse të kompleksit të Xhamisë Haxhi Mahmud Bej dhe restaurimit dhe revitalizimit të Xhamisë Koxha Kadi - objekt fetar i kulturës islame. Gjatë vizitës njëditore, Reis'ul-Ulemaja dhe shoqëruesit e tij mbetën të kënaqur dhe të bindur se Myftinia e Manastirit, në krye me Myftiun h. Amit ef. Rasimi, po punon me përkushtim të madh në organizimin e jetës fetare, e menaxhon zhvillimin e kësaj myftinie me strategji në sigurinë e saj infrastrukturore, financiare dhe fetare islame.

Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

BFI NËNSHKRUAN DY PROTOKOLLE ME VAKËFIN TURK

E mërkura, 31 gusht 2022, ishte një ditë e madhe për BFI të RMV dhe Myftininë e Manastirit, thuhet në njoftimin e BFI.

Në selinë e kësaj myftinie, në mënyrë solemne u nënshkruan dy protokolle me vlerë të madhe, edhe atë me sa vijon: 1. Restaurimi dhe revitalizimi i Hanit dhe i lokaleve afariste që janë pjesë e kompleksit të Xhamisë Haxhi Mahmud Bej në Manastir; 2. Restaurimi dhe revitalizimi i Xhamisë Koxha Kadi në Manastir.

Këto objekte janë të periudhës osmane dhe paraqesin një pasuri ta jashtëzakonshme të kulturës islame në Ballkan.

Prezent në solemnizimin e Protokolleve ishin: nikoqiri, Myftiu i Manastirit, h. Amit Rasimi me bashkëpunëtorët e tij; z. Driton Dikena, Drejtor i Sektorit të Vakëfit pranë BFI; z. Nizam Reshit, Përgjegjës për Marrëdhënie me Republikën e Turqisë; përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Republikës së Turqisë (T. C. Vakıflar Genel Müdürlüğü).

Protokollet janë nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Vakëfeve, z. Burhan Ersoj (Burhan Ersoy) dhe Reis'ul-Ulema i BFI, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Me këtë rast, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në emër të BFI dhe të gjithë besimtarëve myslimanë të këtij nënqielli shprehu falënderimet e përzemërta për këtë donacion të madh të kësaj drejtorie.

Nga përcjellja e punëve të restaurimit dhe revitalizimit të Xhamisë Haxhi Mahmud Bej, të gjithë mbetën të mahnitur me punën e shkëlqyer dhe me bukurinë e xhamisë - si një vepër e përkryer, e cila tashmë është drejt përfundimit.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja i shprehu mirënjohje Myftiut të Manastirit për menaxhimin e shkëlqyer të punëve në përgjithësi, në veçanti të protokolleve të nënshkruara në selinë e Myftinisë dhe përkrahjen e BFI në vazhdimësi, thuhet në njoftimin e BFI.

Të njëjtën ditë, në platformat elektronike të BFI-së është transmetuar Deklarata e Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu pasi BFI nënshkroi dy Protokollet me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve të Republikës së Turqisë, në kohëzgjatje prej 2:37 minuta (video).

SHENTOP VIZITOI MYFTININË E SHTIPIT

Kryetari i Kuvendit të Madh të Turqisë, prof. dr. Mustafa Shentop (Mustafa Şentop), vizitoi më 23 shtator, 2022, Myftininë e Shtipit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shtip dhe Maqedoni lindore.

Delegacioni, i përbërë nga deputetë të Kuvendit të Madh të Republikës së Turqisë (Türkiye), u prit nga Myftiu Nasir ef. Rexhepi, i cili mysafirët e lartë i informoi me aktivitetet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Myftinia me të cilën udhëheq ai.

Mysafirët fillimisht vizituan Orta-Xhaminë në Strumicë, xhami kjo e cila ende vazhdon të shfrytëzohet si depo nga autoritetet vendore dhe e cila deri në një të kaluar të afërt ka qenë e regjistruar si pronë e bashkësisë inekzistente "Bashkësia Fetare e Myslimanëve" dhe e cila, pas përpjekeve të Myftinisë, tashmë është pronë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV.

Kryetari i Kuvendit të Madh u zotua se do të japë përkrahje që kjo xhami të restaurohet dhe të hyjë në funksion sa më shpejt.

Më pas delegacioni ishte i pranishëm në xhaminë e fshatit Koxhali të Radovishit, ku u fal dhe namazi i xhumasë.

Delegacioni më pas u prit në zyrën e Myftinisë në Shtip, ndërsa vizitoi dhe Paralelen e Shtrirë të Medresesë Isa Beu në Shtip, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shtip dhe Maqedoni lindore. (30.09.2022)

PËR PASTËRTINË E ISLAMIT

VEPRA, JO FJALË TË KOTA

Nga Shaqir ef. Fetahu

Pastërtia e Islamit bazohet në vepra, jo në fjalë të kota.

Rrugëtimi i pastër dhe i drejtë - është fjala që ndriçon më bukur dhe më fuqishën. Vetëm kjo depërton kudo, në çdo skaj dhe në çdo vend.

Ky rrugëtim është vlerë dhe nuk lë hapësirë për muhabete të kota. Aksioni për vepra, ndërkaq, nuk jep kohë për të parë kush çka flet.

Ec përpara, fuqishëm - sepse koha shkon dhe nuk kthehet më. Bëje veten si një tren i fuqishëm, që pret aq sa ka nevojë. Nëse i pret ata që vonohen nga neglizhenca, vonon veten dhe të tjerët.

Kujdes! Të veprojmë shumë e të flasim pak. Dinamizmi i kohës është i rrezikshëm dhe i pamëshirshëm për ata që vonohen.

Nuk është e rastit që koncepti islam betohet në shenjtërinë e kohës dhe të veprës; jo në fjalët e kota dhe të zbrazëta.

Por, ndihmoni edhe ata që kanë vetëm fjalë dhe vonohen. Nxitni ata, që fjalën ta shumëzojnë me vepra madhore.

Kështu na do Zoti i madhërishëm. /14.09.2022/

(Autori është Reis'ul-Ulema i BFI të RMV. Teksti është publikuar në faqen zyrtare të BFI-së në Facebook.)

URIME PËR DITËN E BOSHNJAKËVE

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka uruar 28 Shtatorin – Ditën nacionale të boshnjakëve. Urimi është bërë në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën shqipe, thuhet në njoftimin e BFI.

Përmbajtja e Urimit:

"Kam nder të veçantë që bashkësisë boshnjake në RMV dhe gjithë popullit boshnjak kudo që jeton t'u shpreh urimet e përzemërta me rastin e datës nacionale 28 Shtatori - Dita e boshnjakëve.

Populli boshnjak me sakrifica të mëdha, gjatë tërë historisë, ka mbrojtur traditën e vet kombëtare dhe dinjitetin e boshnjakëve kudo që jetojnë. Bashkësia Fetare Islame e RMV ka respekt të veçantë për këtë popull, duke qenë se është dhe pjesë e pandashme e familjes së madhe që quhet BFI.

28 Shtatori - Dita e boshnjakëve shënon datën e një organizimi të mirëfilltë të boshnjakëve kudo që janë, në veçanti të boshnjakëve të vendit tonë, në ngritjen e identitetit të tyre fetar dhe kombëtar.

Me qëllim të respektit ndaj popullit boshnjak si pjesë integrale e BFI, morëm pjesë në programin kulturor të organizuar nga partia Lidhja Demokratike e Boshnjakëve, e udhëhequr nga z. Munir Kolashinac.

Urime. Zoti e bekoftë popullin boshnjak", përfundon Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

NË MANIFESTIMIN TRADICIONAL "DRITA E GONXHES"

Më 26 gusht, 2022, me ftesë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në manifestimin tradicional kulturor-shkencor "Drita e Gonxhes", në Sheshin e Shkupit, me rastin e 112-vjetorit të lindjes së nobelistes sonë Gonxhe Bojaxhiu - Nënë Tereza, thuhet në njoftimin e BFI.

Urime Drejtorit të ITSHKSH të RMV prof. dr. Skënder Hasani për ftesën dhe organizimin e mirëfilltë të këtij manifestimi, që aktualizon dhe shpalos personalitetin me famë botërore në sferën e humanizmit njerëzor, njëherësh dhe nobeliste e njohur, që nderon vendin dhe kombin tonë edhe si shqiptare, edhe si shkupjane - Gonxhe Bojaxhiu.

BFI e RMV do jetë gjithmonë në përkrahje të personailiteteve që i shërbyen njeriut dhe zhvillimit njerëzor në të gjitha sferat, thuhet në njoftimin e BFI.

REISI NË PËRKUJTIMIN E 11 SHTATORIT

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 13 shtator, 2022, mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Ambasada Amerikane në Shkup, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të RMV dhe Institutin e Mjekësisë Transfuzive, në nderim të Ditës së Shërbimit dhe të përkujtimit të 11 Shtatorit, thuhet në njoftimin e BFI.

Ambasadorja Kate M. Byrnes mbajti një fjalim përshëndetës dhe mjaft prekës, duke kujtuar vullnetarët të cilët u përgjigjën të parën për të ndihmuar viktimat e tragjedisë së 11 shtatorit 2001. Ajo po ashtu përkujtoi edhe viktimat që sot, për fat të keq, po radhiten në Ukrainë. Më pas, falënderoi të pranishmit dhe përfaqësuesit e Bashkësive Fetare.

Pas fjalimit, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Drejtori i Zyrës për Informim të BFI, z. Agron Vojnika - i cili njëherësh është edhe ndërlidhës mes BFI dhe Ambasadës së SHBA në Shkup - bisedoi me Shkëlqesinë e Saj, Ambasadoren Kate M. Byrnes dhe e falënderoi për gjithë kontributin që ajo e ka dhënë në vendin tonë, duke qenë një nga promotorët kryesorë, që e radhiti vendin tonë në familjen e madhe të NATO-s dhe shërbeu si makineria shtytëse e të gjitha lëvizjeve dhe ndryshimeve pozitive demokratike në vend.

Shkëlqesia e Saj po ashtu e falënderoi Kreun e BFI-së për mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë këtyre katër viteve të mandatit të saj si Ambasadore e SHBA-ve në RMV.

Vlen të theksohet se për të katërmbëdhjetin vit radhazi Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bashkëpunon me Kryqin e Kuq të Qytetit të Shkupit dhe me Institutin e Mjekësisë Transfuzive, duke organizuar aksione për grumbullimin e gjakut dhe të ushqimeve në nderim të Ditës së Shërbimit dhe të përkujtimit të 11 Shtatorit, me ç'rast do të plotësojë furnizimet me gjak dhe do t'u sigurojë familjeve në nevojë ushqime dhe gjëra të tjera të nevojshme për muajt e dimrit në vijim, thuhet në njoftimin e BFI.

NË DITËN NACIONALE TË ARABISË SAUDITE NË TIRANË

Një delegacion i BFI të RMV më 23 shtator, 2022, mori pjesë në shënimin e Ditës Nacionale të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në delegacionin pjesëmarrës në Ambasadën e Arabisë Saudite në Shqipëri ishin: Sekretari i Përgjithshëm i BFI të RMV h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Kumanovës h. Abedin ef. Imeri dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim ef. Iseni. Ata ishin atje me ftesë të Ambasadës Saudite në Tiranë.

Delegacioni përfaqësoi Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahun, i cili ka udhëtuar në Kajro (Egjipt), për pjesëmarrje në konferencë ndërkombëtare.

Delegacioni i BFI u takua me Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, z. Fejsal bin Gazi Hifdhi, dhe i shprehën urimet e përzemërta Shkëlqesisë së Tij Mbretit Selman bin Abdulaziz dhe trashëgimtarit të Fronit mbretëror, Eminencës së Tij Muhamed bin Selman, si dhe popullit saudit, thuhet në njoftimin e BFI.

BFI për këtë takim kishte edhe një informatë, e shkruar dhe anglisht, ku paralajmërohej shkuarja në Tiranë.

SEMINAR I MYFTINISË SË SHKUPIT NË DURRËS

Sot filluam seminarin treditor "Identiteti fetar dhe sfidat e kohës", të cilin Myftinia e Shkupit kësaj radhe e realizon në Shqipëri, thuhet në njoftimin e Myftiut Qenan ef. Ismaili të datës 18 shtator, 2022.

Në këtë seminar marrin pjesë 103 nëpunës fetarë dhe ka për qëllim ngritjen profesionale të tyre.

Për të realizuar këtë, për nëpunësit fetarë sot kishim nderin të kemi ligjërues opinionistin Redi Shehu me temat: "Komunikimi në shoqërinë e sotme të spektaklit" dhe "Rreziku i identiteteve të lëngshme".

Allahu e shpërbleftë edhe donatorin nga Shkupi për përkrahjen e dhënë!

Sot (19.09.2022) vazhdoi dita e dytë e seminarit treditor "Identiteti fetar dhe sfidat e kohës", me ligjëruesin prof. dr. Ardian Muhaj. Ai u paraqit me temat "Dimensionet e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në kontekstin ballkanik, evropian dhe mesdhetar" dhe "Njeriu si njësi matëse e historisë".

Sot e përmbyllëm seminarin treditor, duke bërë vlerësim të përbashkët rreth punimeve, plotësuam pyetësorin dhe njëkohësisht shpërndamë certifikatat, thuhet në njoftimin e Myftiut Qenan ef. Ismaili të datës 20 shtator, 2022.

Falënderoj nga zemra administratën e Myftinisë për angazhimin, të gjithë hoxhallarët pjesëmarrës, me të cilët njëzëri u dakorduam se aktiviteti i këtillë na bashkon zemrat dhe na motivon për angazhim më të madh në shërbim të besimtarëve.

Mirënjohje e veçantë për hoxhën Vladimir Kera, që na lehtësoi rrugën e kontaktit me ligjëruesit Redi Shehu dhe Ardian Muhaj. Lutje tek Allahu, që donatorit shkupjan t'ia shtojë pasurinë. Allahu na e ruajtë unitetin mes hoxhallarëve dhe sinqeritetin në punë, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit.

Seminari është mbajtur në Durrës, Golem, Hotel Klajdi Resort, në 17-20 shtator, 2022.

DISKUTIME INTERAKTIVE KUNDËR TERRORIZMIT

Diskutime interaktive me Komitetin Kombëtar për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm,

organizuar nga OSBE dhe Komiteti Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, thuhet në njoftimin e BFI.

Punëtoria me diskutime interaktive është mbajtur më 12 dhe 13 shtator, 2022, në Shkup. Komiteti Kombëtar për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit po shqyrton prioritetet dhe propozimet për Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2022 - 2026).

Të pranishëm ishin personalitete të ndryshme nga institucionet e vendit, nga sektori privat, atij politik dhe faktorë ndërkombëtarë, organizata të ndryshme, si dhe përfaqësues nga ambasadat etj.

Nga BFI i pranishëm ishte mr. Mustafa Dauti, Drejtor i Punëve të Jashtme.

Temat që u diskutuan ishin: 1. Forcimi i shoqërise civile dhe shkëmbimi i praktikave në vende të ndryshme; 2. Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe organeve të zbatimit të ligjit; 3. Roli i komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit; 4. Mirëqenia sociale dhe shëndeti mendor - sfidat dhe mundësitë në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm; 5. Angazhimi i bashkisë dhe komunitetit: forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit; 6. Rehabilitimi dhe riintegrimi; 7. Sfidat e ardhshme dhe hapat për të zgjidhur problemet që paraqiten, thuhet në njoftimin e BFI.

PËRFAQËSUES NGA LONDRA VIZITOJNË BFI-në

Një delegacion i Xhamisë së Londrës lindore dhe i Qendrës Myslimane të Londrës vizitoi Rijasetin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV më 22 shtator, 2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili udhëtoi në një konferencë ndërkombëtare në Kajro (Egjipt), delegacioni u prit nga Drejtori i Sektorit të Mërgatës dr. Selver ef. Xhemaili, në shoqërim të Shefit të Kabinetit dr. Abdulkerim ef. Iseni dhe të Përgjegjësit të Shërbimit për Informim Publik të BFI, z. Agron Vojnika.

Delegacioni nga Londra përbëhej nga imamë, juristë, biznesmenë, specialistë të emigracionit, xhematlinj dhe aktivistë të Xhamisë etj.

Fillimisht, dr. Selver ef. Xhemaili u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve nga Londra dhe iu paraqiti një letërnjoftim të shkurtër të BFI-së, funksionimin dhe organizimin e saj, foli për institucionet edukativo-arsimore në vend dhe posaçërisht për Medresenë Isa Beu dhe Fakultetin e Shkencave Islame.

Ai po ashtu shtoi se në RMV ka rreth 700 xhami aktive dhe se mësimi fillestar bëhet nëpër mejtepet e xhamive, ndërsa mësimi i mesëm në 5 medrese, të cilat funksionojnë - 2 për gjininë mashkullore dhe 3 për atë femërore, ndërsa nxënësit që duan të vazhdojnë më tej e kanë edhe Fakultetin e Shkencave Islame.

Dr. Xhemaili po ashtu foli edhe rreth rolit që BFI ka në organizimin e jetës fetare në vend dhe në mërgatë, ku jeton një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë, kryesisht në vendet perëndimore, përfshi këtu edhe Mbretërinë e Bashkuar.

Në emër të delegacionit të mysafirëve foli drejtori i Xhamisë së Londrës lindore, z. Dilavar H. Khan, i cili u falënderua për pritjen e ngrohtë të BFI dhe shprehu befasinë e tij për sa i përket organizimit dhe funksionimit të përkryer të BFI. Ai tha se është një kënaqësi që të vizitohet Maqedonia e Veriut dhe të shihet se edhe këtu ka myslimanë. Ky është një mësim për ne, por edhe për fëmijët tanë, që të dihet se edhe në këtë nënqiell janë vëllezërit tanë që e praktikojnë Islamin sipas mësimeve të Kuranit famëlartë.

Ai po ashtu foli rreth nivelit të lartë të demokracisë që ekziston në Mbretërinë e Bashkuar, ku komuniteti mysliman është mjaft i organizuar, nën udhëheqjen e Këshillit Britanik të Myslimanëve, e ku ka mbi 2.000 xhami aktive dhe mbi 100 medrese, nga të cilat mbi 15 janë nën përkujdesjen financiare të shtetit. Ai po ashtu foli edhe rreth përfaqësimit politik, ku vetë Kryetari i Londrës është i përkatësisë myslimane, pastaj ka dhe përfaqësues myslimanë në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar etj. Kjo flet qartë për nivelin e demokracisë që ekziston në këtë vend, tha ai.

Delegacioni nga Londra erdhi në Shkup pas një vizite që i bëri Bashkësisë Islame të Kosovës. Shumica e tyre para disa viteve kanë vizituar edhe Bashkësitë Islame të Bosnjë e Hercegovinës, të Malit të Zi, të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera evropiane, thuhet në njoftimin e BFI.

"BFI DO T'I RIKTHEJË VARREZAT QË I KA MARRË KISHA NË ORKOC"

Varrezat myslimane në Orkoc të Kumanovës prej vitesh i ka marrë Kisha Ortodokse Maqedonase-Arkipeshkopia e Ohrit. Më 19 shtator, 2022, BFI e RMV ka dalë me një komunikatë për të sqaruar problemin, ndërsa në ditët në vijim ka shpërndarë video-incizimin e TV Shenja (Shkup), ku Drejtori i Sektorit të Vakëfit, Driton Dikena, flet për këtë çështje. Deklarata është marrë nga gazetarja Linda Ebibi më 19 shtator.

Komunikata e BFI-së: "Bashkësia Fetare Islame e RMV, në koordinim me Myftininë e saj në Kumanovë, pasi u njoftua burimisht për problemin në lidhje me varrezat myslimane në fshatin Orkoc të Komunës së Likovës, menjëherë angazhoi sektorët e saj për të mësuar të vërtetën rreth këtij problemi.

Sipas informacioneve të para, bëhet fjalë për një vendim për denacionalizim të vitit 2013, me të cilin vendim Kishës Ortodokse Maqedonase i janë dorëzuar të dy parcelat, pa e njoftuar Myftininë dhe BFI të RMV, të cilat në terren paraqesin varreza myslimane.

Pas kompletimit të dokumentacionit përkatës, BFI do të marrë iniciativë që të kontaktojë me KOM- in që ta zgjidhë këtë problem me marrëveshje; përndryshe, do të ndërmerren të gjitha procedurat ligjore dhe gjyqësore deri në kthimin komplet të vakëfit te pronarët e vërtetë. Shërbimi për Informim i BFI."

TV Shenja: Pas publikimit të lajmit në Televizionin Shenja, Bashkësia Fetare Islame ka nisur të angazhohet lidhur me skandalin e varrezave të vjetra të fshatit Orkoc, të cilat me denacionalizm kanë kaluar në pronësi të Kishës Ortodokse Maqedonase.

Driton Dikena, Drejtor në Sektorin e Vakëfëve pranë BFI-së, informoi se gjatë ditës së sotme ka lëshuar kërkesë në institucionet kompetente dhe kanë kontaktuar me Kishën Ortodokse Maqedonase, për të mësuar më shumë në lidhje me këtë rast. Ai shtoi se kjo çështje është shumë sensitive dhe duhet pasur kujdes në mënyrën se si do të veprojnë:

-Sot në mëngjes kam bërë kërkesë nëpër institucionet relevante, të cilat janë përgjegjëse për këtë çështje. Kam bërë kërkesë që të bëj një shikim të lëndës dhe për të mësuar të vërtetën se si ka ardhur deri te kjo. Ndoshta do të duhet të përgjigjemi më saktë pas disa ditësh, kur unë veç më do ta kem lëndën nga Komisioni për decionalizim. Veç më kemi vënë edhe kontakte me Kishën Ortodokse Maqedonase, thotë ai.

Dikena më tej sqaroi se Bashkësia Fetare Islame deri më tani nuk ka qenë në dijeni për këtë rast dhe se kjo nuk është hera e parë me pronat e vakëfeve, por këto çështje gjithmonë janë zgjidhur në bazë të asaj se cilit institucion i takon pronësia:

-Për këtë çështje kemi marrë vesh nëpërmjet medies tuaj, për arsye se Bashkësia Fetare Islame ka disa milionë metra katrorë vakëfe dhe nuk bëjmë kontroll të përditshëm të vakëfeve. Praktika jonë juridike gjatë viteve, në Sektorin e Vakëfit, ka bërë që ne të kemi raste të tilla, për arsye se edhe prona e Bashksisë Fetare Islame quhet vakëf, por edhe Kisha Ortodokse Maqedonase e thirr tokën vakëf dhe të këtilla mosmarrëveshje rreth pronave kemi pasur herë pas here me Kishën Ortodokse Maqedonase. Një pjesë e këtyre lëndëve janë zgjidhur në favor të institucionit kujt i përket toka, thotë ai.

Drejtori i Sektorit të Vakëfeve gjithashtu theksoi se në qoftë se pas shqyrtimit të dokumentacioneve rezulton që varrezat myslimane janë në pronësi të Kishës Ortodokse Maqedonase, atëherë do të veprojnë në bazë të kompetencave ligjore:

-Ne jemi të pakompromis në atë se toka e vakëfit duhet t'i kthehet pronarit, duhet t'i kthehet Bashkësisë Fetare Islame, dhe ne do të kërkojmë që të anulohet vendimi i denacionalizimit dhe toka për fshatin në fjalë t'i kthehet Bashkësisë Fetare Islame. Ne do t'i marrim të gjitha aspektet juridike parasysh; në fillim gjithsesi do të kërkojmë që vetë Kisha Ortodokse Maqedonase të shprehet pak më e logjikshme dhe vetë ta dorëzojë tokën në BFI. Por, nëse Kisha vazhdon të sillet në mënyrë jo të interesuar, atëherë do të ndjekim të gjitha proceset gjyqësore, thotë ai.

Ndërkaq, nga Kisha Ortodokse Maqedonase ende nuk janë deklaruar në lidhje me pronësinë e varrezave myslimane në fshatin Orkoc, të cilat janë në pronësi të tyre. Edhe sot tentuam të marrim qëndrimin e tyre, por nga ana e tyre ende mbizotëron heshtja – përfundon raporti i TV Shenja i datës 19 shtator, 2022, me gazetare Linda Ebibin.

APEL QË ENERGJIA ELEKTRIKE TË SHFRYTËZOHET RACIONALISHT

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 19 shtator, 2022, priti në kabinetin e tij Ministrin e Ekonomisë, z. Kreshnik Bekteshi, i cili e informoi kreun e BFI-së për krizën e mundshme energjetike gjatë periudhës së ardhshme në vend, thuhet në njoftimin e BFI.

Pasi u këmbyen informata të kësaj natyre, Kryetari i BFI-së u zotua se do ta përdorë tërë autoritetin e tij dhe të gjitha kapacitetet e mundshme që ka BFI, që të kontribuojë në gjetjen e mundësive për ta tejkaluar sa më lehtë këtë situatë në të cilën ndodhet i tërë rajoni si pasojë e luftës në Ukrainë.

Në një prezencë masive të medieve të vendit, që kishin ardhur ta ndiqnin takimin, Reis'ul-Ulemaja po ashtu i premtoi Ministrit Bekteshi se BFI do ta japë kontributin e saj për shpenzim racional të energjisë elektrike. Reis'ul-Ulemaja me këtë rast u bëri thirrje të gjithë qytetarëve të RMV, posaçërisht besimtarëve të konfesionit islam, që energjinë elektrike ta shpenzojnë në mënyrë racionale dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në tejkalimin e krizës energjetike.

"Me Ministrin Kreshnik Bekteshi biseduam për çështjen e shfrytëzimit racional të energjisë elektrike, me qëllim të zbutjes së situatës, për ta kaluar më lehtë këtë sfidë. E kemi dëshmuar gjithmonë se në momente të krizave, por edhe tani, do të jemi në shërbim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve që të jemi racionalë në shfrytëzimin e rrymës elektrike, çka është në dobi të mbarë shoqërisë. BFI nuk e ka shumë problem që të kursejë apo të harxhojë energji në mënyrë racionale. Ne në të gjitha objektet tona, në mbi 700 xhami në vendin tonë, gjithmonë e kemi shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë racionale", tha Kryetari i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. "Gjatë ditëve dhe javëve në vijim, bashkë me 13 Myftinitë e BFI dhe mbi 1.200 të punësuarve në BFI, do të japim kontributin maksimal në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve – fillimisht, duke bërë apele gjatë ditëve të xhumaja, e më pas edhe në forma të tjera", tha ai.

Nga ana tjetër, Ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi tha se me kursimin e energjisë elektrike, besimtarët do të kursejnë edhe në buxhetin e tyre familjar. "Realizuam një takim me Kreun e BFI-së, me të cilin biseduam për krizën energjetike. Shpresojmë se BFI me apelin për kursim të energjisë do të ndihmojë në sfidën me krizën energjetike. Qëllimi është që të kursejmë sa më shumë energjinë elektrike - të gjithë të kursejnë; jo vetëm në energjinë elektrike, por edhe në buxhetin e tyre familjar. Ky bashkëpunim edhe në të ardhmen do të zhvillohet dhe do të thellohet", tha Ministri Bekteshi.

Bashkësia Fetare Islame në raste krizash, siç ishte për shembull pandemia me Covid-19, gjithmonë ka pasur ndjesinë dhe gatishmërinë që të kontribuojë në lehtësimin e situatave, duke qenë gjithmonë në shërbim të besimtarëve dhe përkrah tyre, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM PUNE ME MINISTRIN E MËRGATËS

Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame të RMV, përkatësisht Drejtori i Sektorit të Mërgatës, dr. Selver Xhemaili, zhvilloi takim pune me Ministrin e Mërgatës në Qeverinë e RMV, z. Xhemail Çupi, thuhet në njoftimin e BFI.

Zhvillimi i bisedës kishte për qëllim shpalosjen e aktiviteteve dhe veprimtarive, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, për të arritur realizimin e projekteve të parapara për të ardhmen.

Duke e ditur rëndësinë dhe vlerën e qytetarëve tanë që jetojnë jashtë, Ministri Xhemail Çupi dhe Drejtori dr. Selver Xhemaili u dakorduan për një bashkëpunim në finalizimin e projekteve për mërgatën tonë, thuhet në njoftimin e BFI. (16.09.2022)

MIRËNJOHJE PËR SEVGANI HASANIN DHE XHEMATIN E NYRNBERGUT

Më 22 gusht, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti teologun e mirënjohur dhe aktivistin e madh në Qendrën Islame - Xhaminë e Nyrnbergut (Nürnberg), Gjermani, h. Sevgani ef. Hasani, thuhet në njoftimin e BFI.

Në praninë e Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili dhe Drejtorit të Mërgatës në Rijasetin e BFI, dr. Selver ef. Xhemaili, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu mysafirit të nderuar i shprehu mirënjohje për aktivitetin e tij gjatë dekadave të kaluara në prezantimin e Islamit në Nyrnberg dhe Evropë, e në veçanti për kontributin e dhënë në fondin e BFI të RMV për mirëmbajtjen e institucioneve fetare-arsimore.

H. Sevgani ef. Hasani njihet si ligjërues dhe orator i spikatur dhe menaxhues i njohur dhe tashmë xhemati i kësaj qendre është me renome në Evropë dhe gëzon një respekt të lartë. Në shenjë respekti për kontributin e dhënë xhematit të kësaj qendre, Kryetari i BFI të RMV i ndau Mirënjohje, duke iu uruar suksese në punën e tyre, thuhet në njoftimin e BFI.

MIRËNJOHJE PËR HAFËZ SHEVAL EF. AZIZIN

Më 15 shtator, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në kabinetin e tij priti në një takim vëllazëror hafëzin e mirënjohur të trevave tona, njëherësh mësimdhënës në SHMI Medreseja Isa Beu në Shkup, prof. Sheval ef. Azizin, thuhet në njoftimin e BFI.

Pritja ishte me rastin e pensionimit të tij. Edhe pse iu ofrua që të vazhdojë edhe më tutje, Profesori vendosi që të pushojë dhe t'i japë fund mësimdhënies në Medrese.

Ai vërtet ka qenë mësimdhënës, që tërë jetën ia kushtoi lëndës së Kiraetit me nxënësit, kështu që ka nxjerrë me qindra nxënës. Ka qenë i urtë, i moralshëm, i afërt me nxënësit, me qëllim që lënda e Kiraetit të jetë e dashur te nxënësit dhe ta njohin sa më mirë.

Është një hafëz i spikatur, që është i gatshëm në çdo moment ta lexojë krejt Kuranin famëlartë përmendsh, pra hafëz me plot kuptimin e fjalës.

Ka qenë anëtar i komisionit për dëgjimin e hifzit të hafëzëve të rinj për të marrë diplomën e hifzit. Shumë namaze të teravive të Ramazanit i ka falur si imam, duke lexuar krejt Kuranin përmendsh.

Ka lexuar me vite mukabele në Sarajevë, në Novi-Pazar, në Shkup dhe në qytete të tjera.

Në shenjë respekti për punën e bërë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i ndau mirënjohje hafëz Sheval ef. Azizit dhe i uroi përzemërsisht shkuarjen në pension, duke i dëshiruar shëndet dhe jetë të gjatë dhe angazhim dhe aktivitete të nduarnduarta. Zoti e bekoftë- thuhet në njoftimin e BFI.

MYFTIU I KUMANOVËS TAKON MINISTRIN ALITI

Kisha nderin dhe kënaqësinë që në zyrat e Myftinisë së Kumanovës të mirëpres ministrin e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, të nderuarin mr. sc. Admirim Aliti, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Kumanovës, Abedin ef. Imeri.

Gjatë këtij takimi me Ministrin biseduam për shumë çështje. Në mesin e çështjeve që u biseduan ishte situata dhe sfidat aktuale. Gjithashtu, u bisedua edhe rreth gjendjes aktuale në Myftini dhe zhvillimit të jetës fetare në Kumanovë.

Në emrin tim dhe në emër të Myftinisë e falënderoj Ministrin për vizitën që na e bëri dhe u pajtuam që takimet tona do të vazhdojnë edhe më tej. Zoti e nderoftë, e ruajtë dhe i dhëntë suksese të shumta në të ardhmen, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Kumanovës. (11.09.2022)

TAKIM ME IMAMIN E HAMBURGUT

Më 20 shtator, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset hoxhën e mirënjohur h. Zulhajrat ef. Fejzullahu nga Shkupi, Imam në Qendrën Kulturore Islame Shqiptare në Hamburg (Gjermani), thuhet në njoftimin e BFI.

Kjo qendër është më e madhja në mesin e mërgimtarëve tanë. Zulhajrat efendia njihet si shpjegues i famshëm i Islamit dhe organizator i madh i jetës fetare në Gjermani.

Ai me dekada ka vepruar si misionar i Islamit, duke ngritur Qendrën e madhe në Hamburg, si pronë të Shoqatës, me të gjitha kushtet për një zhvillim të jetës fetare islame dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe kulturore të besimtarëve tanë me punë në Gjermani.

Imami vite me radhe ka qenë edhe Koordinator i Unionit të Bashkësive Islame në Gjermani dhe ka hapur një numër të madh xhematesh, xhamish dhe mesxhidesh. Është anëtar i rregullt i Mexhlisit Shura të myslimanëve të Gjermanisë.

Gjatë takimit u bisedua për jetën fetare islame në mërgim, sfidat dhe rrethanat me të cilat ballafaqohen bashkatdhetarët tanë në Gjermani e më gjerë.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV e falënderoi për punën e madhe që ka bërë në Gjermani dhe që vazhdon të bëjë dhe në shenjë respekti i ndau Mirënjohje dhe Letërnjoftimin më të ri të BFI të RMV.

Po ashtu, u vendos që bashkëpunimi dhe marrëdhëniet me BFI të vazhdojnë, duke qenë sa më fuqishëm në shërbim të Islamit dhe iu dëshirua shëndet, jetë të gjatë e suksese të reja.

Në pritje të mysafirit të nderuar ishin pranishëm dr. Selver Xhemaili, Drejtor për Mërgimtarë dhe z. Qufli ef. Osmani, Përgjegjës i Administratës së BFI të RMV.

Zoti e bekoftë Imamin nga Hamburgu, h. Zulhajrat ef. Fejzullahu, thuhet në njoftimin e BFI.

HIDHEN THEMELET E XHAMISË NË TATESH

Më 27 shtator, 2022, në organizim të mrekullueshëm të Myftiut të Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani dhe bashkëpunëtorëve të tij, u hudh guri i themelit i xhamisë së re në fshatin Tatesh, thuhet në njoftimin e BFI.

Prezenca e myftinjve, e drejtorëve, e ulemave islamë dhe e besimtarëve nga Struga dhe Tateshi, e zbukuroi dhe e madhëroi këtë akt të madh fetar.

Ishte një gëzim i madh kur ke besimtarë siç është sportisti i famshëm z. Mirdi Limani me vëllezërit e tij, të cilët kanë marrë përsipër ndërtimin e plotë të xhamisë - personalitet ky që ka garuar në arenën ndërkombëtare të boksit, duke arritur rezultate të mirëfillta, me çka ka afirmuar kombin dhe besimin tonë në nivel ndërkombëtar.

Falënderime Myftiut për organizimin e bukur, falënderime të gjithë të pranishmëve, në veçanti z. Mirdi Limani për vendosmërinë e tij për këtë vepër madhore për hir të Zotit dhe të shpirtit të babait të tij të ndjerë, haxhi Lutfi Limani. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Ceremonia e gurthemelit në Tatesh (Strugë) është transmetuar drejtpërdrejt, në kohë reale, përmes platformave elektronike të BFI të RMV.

Vizitë e këndshme në Ohrin e bukur të Xhamisë së Ali Pashës: Pas ngjarjes solemne të xhamisë së re në fshatin Tatesh të Strugës, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu vizitoi Myftiun e Ohrit, h. Samet Ajdari, në shenjë urimi me rastin e kryerjes së Haxhit. Njëherësh, u zhvillua një muhabet i këndshëm dhe u bënë shëtitje në qendrën e Ohrit, deri te Xhamia e Ali Pashës - bukuri e rrallë e vendit tonë, ku me kënaqësi u fal namazi i drekës. Me këtë rast, Kreu i BFI falënderoi për pritjen Myftiun dhe bashkëpunëtorët e tij, thuhet në njoftimin e BFI. (27.09.2022)

KRYETARI I BFI-së NË HAPJEN E XHAMISË NË SISAK

Më 8 shtator, 2022, u bë hapja solemne e Qendrës Islame (xhamisë) në Sisak të Kroacisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte një ambient impozant. Me qindra besimtarë e përjetonin këtë solemnitet. Manifestimin e nderoi pa masë prezenca e dy presidentëve: atij të Turqisë, z. Rexhep Tajib Erdogan dhe të Kroacisë, z. Zoran Milanoviq, bashkë me përfaqësues të qeverive, të cilët mbajtën fjalime dhe përshëndetën hapjen solemne të këtij kompleksi të madh fetar.

Të pranishmit i përshëndetën Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Islame të BeH, prof. dr. Husein Kavazoviq, Myftiu i Meshihatit të Kroacisë prof. dr. Aziz Hasanoviq dhe Kryetari i Dijanetit prof. dr. Ali Erbash e të tjerë.

Delegacioni i BFI të RMV, në krye me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në shoqërim të Myftiut të Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli dhe Myftiut të Strugës h. Salim ef. Sulejmani, pati një pritje vëllazërore, me çka respektuan ftesën, tubimin dhe të pranishmit.

Prezentë ishin edhe Presidentët e mëparshëm të Kroacisë si: z. Stipe Mesiq, znj. Kolinda Grabar-Kitaroviq, ish-Kryeministrja znj. Jadranka Kosor etj.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu shfrytëzoi rastin për takime me shumë miq, në veçanti me bashkatdhetarët tanë, si: me prof. dr. Milaim Fetain, Ambasador i RMV në Kroaci; me z. Martin Berisha, Ambasador i Kosovës; me znj. Ermina Lekaj, deputete e pakicave në Kroaci dhe shumë afaristë të tjerë, si: me familjen Idrizi nga Forina (Gostivar), respektivisht z. Talib Idrizi, dr. Gëzim Rexhepi nga Piroku (Tetovë), h. Zufer dhe Nexhbi Zendeli dhe shumë miq nga Kuvajti dhe Katari.

Në të kthyer për në vendlindje, gjatë rrugës, iu bë një vizitë familjes Zendeli, afaristë të njohur në qytetin Pag të Kroacisë, parardhësit e të cilëve kanë qenë iniciatorët kryesorë të xhamisë së parë në Sisak.

Pritja e delegacionit të BFI të RMV nga ana e Meshihatit të BI të Kroacisë ishte protokollare, pjesëmarrësit nga BFI e RMV janë falënderues, në veçanti kreatorëve kryesorë: Myftiut prof. dr. Aziz Hasanoviq, Zv/Myftiut mr. Mevludin Arsllani e të tjerëve.

Ishte kënaqësi të marrësh pjesë në këtë tubim madhështor. Zoti i bekoftë! – thuhet në njoftimin e BFI.

Në njoftimin e parë të BFI të RMV, të datës 7 shtator, thuhej: Qendra Islame në Sisak është vazhdimësi e xhamisë së parë - mesxhid, të hapur më 1967, edhe atë nga bashkatdhetarët tanë me punë në këtë qytet kroat, konkretisht me iniciativën e hoxhës së mirënjohur, rahmetli h. hafëz Hasan Zendeli, gjysh i Myftiut të Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli.

Ceremonia e hapjes së Xhamisë në Sisak është transmetuar drejtpërdrejt, në kohë reale, përmes platformave elektronike të BFI të RMV.

VULLNET ILAZI, IMAM I XHAMISË KËRÇOVA (ZVICËR)

Faqja Xhamia Kulturverein Kercova ka raportuar më 10 shtator, 2022, se Xhamia Kërçova në Füllinsdorf të Zvicrës (Kanton Basel-Landschaft, BL) ka zgjedhur Vullnet Ilazin Imam të Xhamisë.

Në informatën e plotë thuhet se Xhamia Kërçova ka mbajtur mbledhje me këtë rend dite:

1.Votimi për Imam të rregullt; 2.Diskutimi për ecurinë e procesit të blerjes së objektit; 3.Të ndryshme.

Gjatë mbledhjes dhe votimit me përfaqësuesit e Xhamisë Kërçova u votua unanimisht, pa asnjë votë kundër kandidaturës së Vullnet Ilazit si Imam i rregullt i Xhamisë Kërçova.

Gjatë raportimit për anëtarët e Xhamisë, Kryetari i Xhamisë Kërçova, Enver Ibrahimi, pasi uroi Imamin e rregullt, falënderoi të gjithë imamët që kanë shërbyer në Xhaminë Kërçova gjatë kësaj periudhe.

Imami i Xhamisë Kërçova, Vullnet Ilazi, gjatë fjalës përshëndetëse falënderoi për besimin dhe premtoi se do ta kryejë me nder dhe përgjegjshmëri detyrën e marrë, thuhet në njoftimin e Kryesisë së Xhamisë Kërçova.

KTHEHET XHAMIA NË MATKË

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 5 shtator, 2022, vuri gurin e themelit të xhamisë së re në fshatin Matkë të Shkupit, që graviton në komunën e Sarajit, thuhet në njoftimin e BFI.

Delegacioni i Rijasetit u shoqërua nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, si nikoqir dhe organizator i kësaj ceremonie, bashkë me operativën e Myftinisë etj. Ishin të pranishëm Ministri i Shëndetësisë, z. Bekim Sali dhe Sekretari i Komunës së Sarajit, z. Sefi Shabani.

Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, uroi banorët e Matkës dhe u dëshiroi përfundim sa më të shpejtë të punimeve, duke premtuar se BFI do të qëndrojë pranë në ndërtimin e këtij bejtullahu, deri në hapjen përfundimtare. Vetëm njerëzit që kanë iman të palëkundur në Allahun fuqiplotë ndërtojnë xhami, ndërsa të njëjtët do të shpërblehen me pallate në botën e përtejme nga Allahu fuqiplotë, nënvizoi ai.

Guri i themelit i xhamisë së Matkës vihet mbi themelet e xhamisë së vjetër, e cila nuk ekziston më. Së shpejti pritet që banorët e këtij fshati të Shkupit të kenë xhaminë e re, ku do të mund t'i kryejnë obligimet e tyre fetare, thuhet në njoftimin e BFI.

FILLOI NDËRTIMI I QENDRËS ISLAME NË WINTERTHUR

Një delegacion i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i përbërë nga Drejtori i Mërgatës dr. Selver ef. Xhemaili - që përfaqësoi Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahun, pjesëmarrës në një konferencë në Kajro – Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Gostivarit mr. Sabahudin ef. Zendeli dhe Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani, mori pjesë në hedhjen e gurit të themelit të Qendrës Kulturore Islame në qytetin Winterthur të Zvicrës (Kanton Zürich) më 26 shtator, 2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Bëhet fjalë për një projekt madhështor, i projektuar mirë, i organizuar dhe i financuar nga shqiptarët që punojnë dhe veprojnë në Zvicër.

Në këtë eveniment madhështor morën pjesë edhe autoritetet komunale të Winterthurit, përfaqësues të Bashkësive Islame nga trojet shqiptare, zyrtarët e KMSHZ-së (DAIGS), imamë, si dhe një numër i madh besimtarësh myslimanë shqiptarë.

Delegacioni i BFI përshëndeti dhe uroi të pranishmit në emër të Kryetarit të BFI-së, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, si dhe falënderoi udhëheqjen e Xhamisë dhe Imamin Ismail ef. Halilin për organizimin e bukur të këtyre programeve dhe për mikpritjen e ngrohtë që ua bënë anëtarëve të delegacionit të BFI të RMV.

Dhashtë Zoti që ky projekt të përfundojë në mënyrën më të mirë. Ju qoftë për hair. Gjithnjë paçi suksese, thuhet në njoftimin e BFI.

Me lajme nga ky manifestim, me tekst dhe me fotografi, janë paraqitur, përveç tjerësh, Imami i Xhamisë Hëna e Re në Kreuzlingen TG, Rejhan ef. Neziri, dhe hoxha Muaz H. Agushi nga Tetova. Agushi ka dhënë dhe këtë njoftim: "Në manifestimin e gurthemelit të xhamisë 'Qendra Kulturore Islame Winterthur', ku projektues i tërë këtij projekti grandioz është vëllai im, Muhamed Agushi.'

BFI e RMV që nga data 21 shtator, 2022, ka transmetuar një video-regjistrim të Xhamisë Winti (Xhamia Winterthur), me njoftimin për nisjen e Qendrës Kulturore Islame, me adresat dhe me numrat e xhirollogarisë për të ndihmuar ndërtimin e saj.

RESTAUROHET XHAMIA E PLUMBIT NË SHKODËR

Sipas Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam (Tiranë), Xhamia e Plumbit është një monument kulture i kategorisë së parë në Shkodër. Është e vetmja xhami shqiptare e përfshirë mes 50 objekteve më të bukura myslimane në botë.

Xhamia e Mehmet Pashë Bushatit, ose Xhamia e Plumbit, u ndërtua në vitin 1773-1774. Kjo xhami është një nga ndërtesat më të vjetra të Shkodrës dhe xhamia më e madhe dhe më e bukura e Shqipërisë deri në gjysmën e parë të shekullit XX, periudhë në të cilën filluan të ndërtohen xhami të dimensioneve të mëdha. Xhamia ka qenë e veshur me plumb dhe nga kjo u quajt Xhamia e Plumbit, e me këtë emër njihet edhe sot, thuhet në njoftimin e AIITC-së.

Më 9 shtator, 2022, ATSH ka dhënë lajmin se së shpejti nis puna për transformimin e Xhamisë së Plumbit në Shkodër. Xhamia e Plumbit, pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, këtë vit do t'i nënshtrohet transformimit rrënjësor. Me ndërhyrjet në këtë xhami, besimtarëve do t'u kthehet një tempull në kushte optimale, ndërsa Shkodrës dhe gjithë Shqipërisë do t'i shtohet një tjetër atraksion i madh turistik.

Ndërkohë, janë kryer sondazhet gjeologjike në terren me pjesëmarrjen e specialistëve turq e atyre shqiptarë të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër. Ndërhyrja kryesore pritet të zgjidhë problemin e përmbytjeve, krijimin e një sistemi kullimi të sigurt, pengimin e ujërave vërshuese dhe restaurimin e ndërtesës. Mjedisi përreth saj do të kthehet në një park të denjë për besimtarët e turistët.

Teknikat e ndërtimit dhe materialet e përdorura në monumentin e kulturës dhe të gjitha detajet arkitektonike origjinale nuk do të cenohen. Xhamia është ndërtuar sipas modelit të ar-

kitekt Sinanit dhe njihet edhe Xhamia e Mehmet Pashë Bushatit. Është një nga më të veçantat në Shkodër dhe në Shqipëri. Është një xhami historike dhe monument kulture i kategorisë së parë dhe xhamia osmane më e madhe në të gjithë Shqipërinë. Të dhënat tregojnë se Xhamia u ndërtua me gurë të sjellë prej popullit me sistem zinxhir (dorë më dorë) prej Gurit të Zi, dhe me tepricat u ndërtuan këmbët e urës së Kirit.

Një vit më parë Ministria e Kulturës e Shqipërisë nënshkroi marrëveshjen për restaurimin e Xhamisë me Ministrinë e Kulturës së Turqisë, thuhet në njoftimin e ATSH-së.

REFLEKSIONE

M'U KUJTUA XHAMIA E PLUMBIT...

Nga Xhahid Bushati

Sa herë që marr rrugën për në Tiranë, sa herë që kthehem prej andej, sa herë dal në shëtitje për të kërkuar e shijuar paksa gjelbërim të ëndërruar; si gjithnjë në të djathtë më shfaqet Xhamia e Plumbit. E heshtur, e plakur dhe e re, e ditur dhe e mençur. Mes dallgëve të historisë, dhimbjeve dhe kalvarit që priti e përcolli gjatë shekujve, në zemrën e saj ruajti Dritën Hyjnore. E ruan edhe sot.

Xhamia e Plumbit, që i ngjan një 'Zoje të Randë", fisnike në zojallëkun e vet shkodran, diç don të thotë e diçka pret… Ajo hesht e plaket. Ajo hesht e rinohet. Ajo, Xhamia e Plumbit, që është një xhami historike dhe monument kulture i kategorisë së parë në qytetin tim, Shkodër.

Dokumentet e dëshmitë historike na rrëfejnë se viti i ndërtimit njihet ai i vitit 1773, ndonëse ka dhe versione të tjera vitesh të ndërtimit të saj. I përket periudhës së Bushatllinjve. Financuesi i ndërtimit të saj ka qenë Mehmet pashë plaku, themeluesi i pashallëkut. Në vitin 1863, siç dëshmojnë përsëri dokumentet e kohës, ka një fazë të dytë meremetimi financuar nga Mahmut Berberi.

Xhamia e Plumbit është e vetmja në Shqipëri për nga lloji, që fillon me një oborr me kolona të gjera, para se të hysh në sallën e faljes. Salla e faljes paraqitet si një bllok i ulët, kapërcyer nga një tambur tetëkëndësh (oktogonal) shumë i lartë, në majë të së cilës qëndron kubeja gjysmë rrethore. Interieri shfaqet si një dhomë e gjatë dhe e gjerë, pavarësisht se përmasat janë jo aq të mëdha. Tremi i xhamisë është i tipit të mbyllur me hapësirën e zbrazët qendrore. Nga brenda, harqet gjysmë rrethore të shtyllave janë të mbuluara me dymbëdhjetë kupola të vogla, që xhamisë i japin një pamje madhështore klasike, ndërsa elementet e hershme të stilit të Stambollit janë përfaqësuar në pjesët e stolisura mbi derë dhe dritare, me harqe interesante dhe parmakë prej hekuri.

Xhamia e Plumbit është e vendosur në pjesën e jashtme të ish-pazarit të Shkodrës, rrëzë kalasë Rozafat, në një livadh në rrafshinën e lumenjve Kir e Drin. Në këtë soditje hapësinore malli dhe përmallimi, dashnia e hyjnia e shoqërojnë historikisht. Qëndron si 'Zojë Mirane', e fisme, e papërkulur, si një gur i çmuar dhe relikte, me të cilën krenohet Shkodra dhe Shqipëria.

Edhe pse e heshtur, ka jetuar historinë dhe kohërat e saj, i jeton ato dhe i sfidon ato me vlerat e saj të rralla e të papërsëritshme.

Xhamia e Plumbit me urtësinë e saj diç don të flasë… Ajo pret. Po çfarë pret?.. Ajo e di. Urtësia dhe Dituria e saj na ftojnë përherë në rrugëtimin e saj fisnik.

Shkodër, 6.09.2022

DIKUSH DËSHIRON TË NA NDAJË NË SHQIPTARË E KOSOVARË...

Nga Ajni Sinani

Shqiptarë e kosovarë! Bota na njeh si shqiptarë. Dikush dëshiron të na ndajë në shqiptarë e kosovarë!

Ata që nuk e dinë sa jemi, do të mendonin se jemi 1 miliardë, prandaj duam të ndahemi në shqiptarë e kosovarë. Mbi 200 milionë arabë, me mbi 20 shtete arabe, të gjithë janë arabë.

Po ne shqiptarët, sa qindra milionë jemi, që të ndahemi në shqiptarë e kosovarë?! Disa shqiptarët në Maqedoni të Veriut po i quajnë maqedonas! Shqiptarët e Luginës dhe ata që jetojnë në Mal të Zi, si do t'i thërrasim!? Po çamët, që janë në Greqi, janë shqiptarë apo janë kombi çam?

Pse serbët e Kosovës e të Bosnjës janë serbë dhe nuk janë kosovarë e boshnjakë?! Pse duhet të shpikim një komb të ri kosovar?!

Kurrë s'e kam ditur se neve na quajnë kosovarë. Qëkur jam bërë i vetëdijshëm, familja dhe rrethi më kanë mësuar se jam shqiptar. Kur kam shkuar në Shqipëri, në vitin 1992, kam dëgjuar se jemi kosovarë!

Reagoja vazhdimisht, duke thënë "nuk jam kosovar, por shqiptar i Kosovës; edhe pse e kemi këtë ndarje në Shqipëri e Kosovë, unë jam shqiptar".

Nuk më bën shqiptar pasaporta e Shqipërisë. Atë pasaportë mund ta posedojë apo ta fitojë një grek, një serb a një italian etj. Por, ata nuk janë shqiptarë. Unë nuk e kam shtetësinë e Shqipërisë, por jam shqiptar.

Është e dukshme se kemi edhe disa dallime në mendësi mes nesh, ngase kemi jetuar të ndarë, por kjo s'na bën dy kombe. E kam thënë dhe besoj se ndarja e kombit tonë është e gatuar në kuzhina të huaja. Janë disa të paskrupull që u thonë shqiptarëve myslimanë se "ju jeni me identitet tjetër, andaj shkoni në Arabi"...

Kemi qenë, jemi dhe do të jemi shqiptarë me besim mysliman si mazhorancë. Por, si komb jemi një: shqiptarë! (Në bashkëpunim/5.09.2022)

DO TË MEREMETOHET MEDRESEJA ALAUDDIN

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përkatësisht Drejtoria e Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, fton mërgatën për të përkrahur financiarisht medresenë "Alauddin" të Prishtinës, thuhet në njoftimin e BIK.

Meremetimi i Medresesë do të bëhet në dy faza. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës në pamundësi që të përballojë financiarisht koston, fton mërgatën që të participojë në meremetimin e Medresesë. Medreseja gjithherë është mbajtur nga bamirësit, nga njerëzit bujarë dhe të vullnetit të mirë, nga dashamirët e arsimit dhe të edukimit dhe nga miqtë e saj.

Vatra arsimore-edukative "Alauddin" është e njohur jo vetëm ndër ne për misionin e saj kombëtar e fetar që nga vitet '50-të të shekullit të kaluar. Aktivitete të theksuara ka pasur gjatë periudhës 1989-1999 dhe luftës së fundit në Kosovë. Nga kjo vatër arsimore deri më tani kanë diplomuar mbi 5.300 kuadro nga të gjitha viset shqiptare dhe jo vetëm.

Medreseja është ndërtuar në vitin 1985 dhe asaj do t'i bëhet meremetimi i plotë, për shkak të dëmtimeve dhe amortizimit si pasojë e viteve dhe e kohës, thuhet në njoftimin e BIK, nënshkruar nga Myftiu mr. Naim Tërnava, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës. (2.09.2022)

TAKIM ME DELEGACIONIN E INSTITUTIT NGA PRISHTINA

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një takim shumë të rëndësishëm me delegacionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, i udhëhequr nga mr. Sabri Bajgora, Drejtor i Institutit për Hulumtime Shkencore dhe Kulturore pranë BI të Kosovës, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë takim u bisedua për forcimin e bashkëpunimit mes dy Bashkësive në realizimin e projekteve të përbashkëta në sfera të ndryshme të hulumtimit të vlerave islame dhe më gjerë.

Në prezencë të prof. Jusuf ef. Zimerit, Drejtor në Sektorin për Arsim Fetar dhe të dr. Selver Xhemailit, Drejtor i Mërgatës, edhe një herë u vendos që BFI e RMV të japë përkrahjen maksimale, me të gjitha kapacitetet intelektuale, në arrit-

jen e këtyre qëllimeve madhore.

Në takim u bisedua në mënyrë vëllazërore edhe për shumë çështje të tjera, thuhet në njoftimin e BFI. (31.08.2022)

NËSE JE BESIMTAR, JE PËR PAQE

Çdokush që dhunon nderin, dinjitetin, integritetin, autoritetin, pasurinë dhe familjen e dikujt, apo sajon diçka për dikë, le të thotë ashtu siç tha Nuhu (a. s.): "...Nëse e sajova, faji im është mbi mua..." (Hud: 35)

Nga Prof. dr. Qani ef. Nesimi

Në ajete kuranore përmes gojës së Nuhut (a. s.) vihen në spikamë dy relacione me rëndësi për njeriun: relacioni vertikal dhe ai horizontal. Dimensioni vertikal vë në pah pikën kyç e kulminante të besimit të njeriut, si dhe të orientimit apo kahezimit të tij. Nëse në majë të piramidës së besimit nuk është Allahu fuqiplotë, si dhe nëse çdo gjë nuk vlerësohet duke u bazuar në relacionin me Të, atëherë lirisht mund të themi se fillojnë të mbijnë elementet e dhunës. Mu për këtë Pejgamberi i Allahut shprehet se tek ai nuk janë thesaret e Allahut, se ai nuk është person që i di të fshehtat, se ai nuk është melaqe, si dhe se ai nuk e di se kujt i jep apo s'i jep Allahu të mira. Në fund të ajetit shprehet se, në të kundërtën, ai do të ishte prej dhunuesve/keqbërësve.

TEVHIDI NUK E LEJON SISTEMIN DESPOTIK

Koncepti i tevhidit (besimit në një Zot) nuk e lejon një koncept/sistem despotik politiko-social, që tërë shoqërisë t'ia imponojë një formë të vetme të të kuptuarit të gjërave. Përkatësisht, që tërë shoqërisë t'i imponohet një qasje e njëjtë ndaj sendeve. Kjo, para së gjithash, është në kundërshtim me amshueshmërinë e Allahut, konkretisht me fenomenin që Allahu çdoherë krijon krijesa dhe gjësende të ndryshme nga ajo e mëparshmja. Pra, të menduarit imponueshëm, edhe nëse për momentin mund të duket si diç e mirë dhe atraktive, ajo në fund rezulton me një padrejtësi, përkatësisht nëse jo me dhunë konkrete, me një dhunë të fshehtë sigurisht.

Për mendimin tim, detajet janë shumë më të rëndësishme sesa vetë sjellja apo vepra që ka marrë formën e dukshme për të gjithë. Mu ky është vendi ku edhe qëndron ajo që mund të quhet burim i dhunës ose i jodhunës. Në suren Hud, ajeti 117, Allahu fuqiplotë shprehet: "*Sepse, Zoti yt kurrë nuk e shkatërron një bashkësi (vetëm) për (besime) të gabuara, derisa pjesëtarët e saj sillen drejtësisht (ndaj njëri-tjetrit).*" Fahrudin Raziu, duke e shpjeguar këtë ajet kuranor thotë: "Ndëshkimi i Zoti nuk i bie një populli vetëm për shkak të besimeve të tyre që arrijnë në shirk dhe qufër (kufr), por i bën të vuajnë vetëm nëse ata, në mënyrë këmbëngulëse, bëjnë të këqija në marrëdhëniet reciproke, dëmtojnë qëllimisht (qeniet e tjera njerëzore) dhe veprojnë në mënyrë tiranike (ndaj tyre)." (*Mesazhi i Kuranit*, fq. 323-324)

Këtu mund të rikujtojmë njerëzit e këqinj në vendin tonë (RMV), të cilët me anë të shkrimeve, bisedave, ligjëratave, mendimeve, debateve, nxjerrjes në *Facebook* të fotove që janë të montuara, mundohen që të bëjnë çmos vetëm e vetëm që të dështojë Institucioni.

JO DHUNËS SË FSHEHTË

Ndryshe, dhunë e fshehtë është të flasësh në një vend jo të duhur; të qëndrosh në një vend jo të duhur; të merresh me punë që nuk të takojnë; të mos e përdorësh forcën tënde për dobi të shoqërisë, edhe nëse do të fajësohesh; të tregohesh shumë i mençur dhe i aftë atje ku nuk sheh rrezik; të jesh dyfytyrësh; t'u shesësh mend të tjerëve; të paraqitesh i moralshëm, derisa amoraliteti të ka kapluar në të katër anët; të tregohesh se je shumë i gatshëm për sukses, edhe pse më herët ke dështuar disa herë; të mendosh se bota rrotullohet vetëm rreth vetes tënde; t'i ekskomunikosh të tjerët…etj.

Ndërkaq, tre parimet e tevhidit: *selam*/paqe, *eman*/siguri dhe *vahdet*/bashkim, e thonë të kundërtën. Njeriu i cili veten e mendon kontribues për të mirën e vetvetes së tij, të familjes dhe të shoqërisë ku ai jeton, si dhe në veçanti ai që e mendon veten si një besimtar i mirë dhe i devotshëm, duhet t'i ketë parasysh këto tre terma që u përmendën më lart. Pra, nëse je besimtar - je për paqe, për siguri dhe për bashkim. Kjo bindje nuk mund të lejojë njeriun që të jetë agresiv, terrorist, dhunues - as ndaj vetes e as ndaj tjetrit, pa marrë parasysh se cili është qëllimi apo synimi i tij.

Si rrjedhojë, çdokush që dhunon nderin, dinjitetin, integritetin, autoritetin, pasurinë dhe familjen e dikujt, apo sajon diçka për dikë, le të thotë ashtu siç tha Nuhu (a. s.): "*…Nëse e sajova, faji im është mbi mua…*" (Hud: 35)

(Autori është Myfti i Myftinisë së BFI-Tetovë)

TË JETOJMË ME SUNNETIN E PEJGAMBERIT (A. S.)

Si pjesëtarë të ummetit të tij duhet të bëhemi shembull i të mirës për të tjerët përmes sjelljeve, qëndrimeve dhe veprimeve tona, sepse në një farë mënyre ne jemi ambasadorët e Islamit, e sidomos ndaj atyreve që iu mungon udhëzimi dhe kanë nevojë për ta njohur të vërtetën.

Shkruan: Seid Fejzuli

Pejgamberin (a. s) e përzgjodhi dhe e lavdëroi Allahu (xh. sh.), në dallim nga të Dërguarit tjerë, edhe atë duke ia zbritur Kuranin e bëri shembull të së mirës për tërë njerëzimin - të besuarit në të është prej besimit, ndërsa të ndjekurit e sunnetit (fjalëve dhe praktikës së tij), është prej detyrimeve. Që nënkupton se mohimi apo mosbindja, si dhe mospraktikimi i sunnetit të tij, tregon për mosplotësimin e besimit dhe mosarritjen e ëmbëlsisë së tij. Allahu (xh. sh.) në Kuran thotë: "**Kush i bindet Pejgamberit, ai i është bindur Allahut**".[i]

Arsyet pse çdo njeri që jeton në sipërfaqen e kësaj toke duhet të jetojë me Pejgamberin (a. s.), konkretisht me udhëzimet dhe këshillat e tij, është fakti se ai përfshin modelin më të mirë në të gjitha aspektet e jetës. Ai shumë pak fliste, por vepronte me maturi, e që fjalët dhe veprimet e tij vazhdojnë të lënë gjurmë të pashlyera, me të cilat ne duhet ta stolisim moralin tonë në përditshmëri. Veten e përshkruan në këtë formë: "*Jam dërguar për të përsosur moralin e mirë.*"[ii]

Sunneti i Pejgamberit (a. s.) rekomandon unitet, barazi, drejtësi, edukim të mirëfilltë, ruajtjen e vlerave njerëzore dhe të lidhjeve farefisnore, mbrojtjen e natyrës dhe të ambientit, kryerjen e çdo përgjegjësie me nder dhe përkushtim; po ashtu rekomandon edhe përkujdesje dhe maturi në raport me shoqëritë dhe krijesat tjera, pastaj luftimin e çdo dukurie apo fenomeni që ka për qëllim devijimin e shoqërisë dhe të familjes.

MODEL PËR KOHËN

Rreziku i mospraktikimit të sunnetit prodhon pasoja negative që mund të jenë me fatalitet për familjen dhe shoqërinë. Andaj, sunneti është metodologjia e vetme që e ndriçon jetën tonë, sunneti e ndihmon dhe drejton atë që përmes formave dhe mënyrave tjera mundohet të gjejë zgjidhje për ndonjë çështje jetësore. Prandaj, pa dallim të statusit tonë shoqëror, model më të përshtatshëm se gjurmët e Pejgamberit (a. s.) nuk ekziston ndonjë që duhet të ndiqet. E, sidomos në këto kohëra dhe situata me të cilat po përballet shoqëria jonë, e rrethuar me plot probleme, sfida, sprova të ndryshme, rënie të moralit, shpërngulje masive të popullatës etj., medoemos duhet t'u rrekemi udhëzimeve pejgamberike, me qëllim që ta mbrojmë vetvetën dhe familjen nga të gjitha nxitjet, fenomenet dhe dukuritë negative, të cilat tanimë janë përhapur në mesin e shoqërisë sonë si rezultat i faktorëve të ndryshëm.

Pa dyshim se të jetuarit dhe vepruarit sipas sunnetit të Pejgamberit (a. s.), përveç se është prej besimit, ndërkohë është edhe prej shenjave të dashurisë ndaj tij, mirëpo kur analizojmë vendin ku jetojmë dhe rrethanat e ndryshme me të cilat përballemi në përditshmëri, është vështirë të praktikohet në përpikëri sunneti i Pejgamberit (a. s), nga fakti se ekzistojnë rastet kur shpërfillet dhe veprohet sipas traditës, zakonit, dëshirës apo përmes ndonjë imponimi ose kulture të huaj. Allahu (xh. sh.) në Kuran thotë: "**Çka t'ju japë Pejgamberi, atë merreni; çka t'ju ndalojë, asaj përmbajuni dhe kini frikë Allahun.**"[iii] Ndërsa Pejgamberi (a. s.) ka thënë: "*Përmbajuni sunnetit tim dhe sunnetit të Hulefai Rashidinëve. Kapuni fort për të me dhëmballë. Kujdes ndaj shpikjeve (trillimeve) të gjërave, sepse çdo gjë e re është risi; çdo risi është humbje.*"[iv]

Sa u përket fryteve të praktikimit të sunnetit të Pejgamberit (a. s.), s'do mend se fillimisht arrijmë ta përforcojmë binjden ndaj Allahut (xh. sh.), ta mbrojmë nderin, ta ripërtërijmë moralin, të shpëtojmë nga intrigat dhe devijimet e mundshme; gjithashtu, me praktikimin e sunnetit të Pejgamberit (a. s.) jemi më të përkushtuar në adhurime, ndërkohë shpresojmë edhe në ndërmjetësimin e tij për falje dhe mëshirë tek Allahu (xh. sh). Pra, sunneti është mekanizëm mbrojtës, nuk i lë hapësirë të depërtojë e keqja në mesin tonë, përmes së cilës vijmë deri te shkatërrimi apo humbja si rezultat i mashtrimit, i tradhtisë, vjedhjes, përgojimit, shpifjes, nënçmimit, poshtërimit, xhelozisë, zhveshjes, përngjasimit, lakmisë, syefaqësisë, shirkut, imoralitetit, pirjes së alkoolit, ryshfetit etj.

PAVARËSISHT DALLGËVE TË JETËS

Andaj, të jetojmë me Pejgamberin (a. s.) çdo ditë; të përpiqemi në mënyrë maksimale që t'i praktikojmë udhëzimet dhe porositë që i parasheh sunneti si burim i dytë i sheriatit islam - qofshin ndaj vetvetes, familjes, të tjerëve, duke përfshirë edhe raportet ndaj krijesave tjera, si dhe marrëdhëniet me natyrën, me vendin dhe ambientin ku jetojmë dhe veprojmë. Pavarësisht sfidave dhe sprovave me të cilat përballemi, ngushëllimin dhe motivin për jetë dhe punë duhet t'i kërkojmë tek udhëzimet e tij. Pavarësisht se dallgët e jetës ku na dërgojnë, si pjesëtarë të ummetit të tij krenarinë dhe lumturinë nuk mund t'i arrijmë në asnjë formë dhe mënyrë tjetër përveç se duke ndjekur porositë pejgamberike - porosi me të cilën jetuan edhe shokët e tij, si dhe gjenerata të ndryshme. Ashtu edhe sot, të njëjtën gjë duhet ta bëjmë ne, sepse Pejgamberi (a. s.) neve si pjesëtarë të ummetit të tij na përshkruan në këtë formë dhe thotë: "*Më të mirët nga ummeti im janë ata që jetuan në shekullin tim, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre.*"[v]

Prandaj, ashtu siç është shembull Pejgamberi (a. s.), edhe ne si pjesëtarë të ummetit të tij duhet të bëhemi shembull i të mirës për të tjerët përmes sjelljeve, qëndrimeve dhe veprimeve tona, sepse në një farë mënyre ne jemi ambasadorët e Islamit, e sidomos ndaj atyreve që iu mungon udhëzimi dhe kanë nevojë për ta njohur të vërtetën.

Allahu (xh. sh.) e bëftë që secili prej nesh ta stolisim moralin tonë me edukatë të mirëfilltë, ashtu siç urdhëron sunneti i Pejgamberit (a. s.).

(Autori ka kryer Fakultetin e Shkencave Islame. Është edukator në Medresenë Isa Beu në Shkup. Jeton në Sllupçan, Kumanovë)

[i] Nisa, 80.
[ii] Kitabu tahrixhi ehadith, ihjau ulumid-din. 3, faqe 1381, nr, 2077. El-Mektebeh esh-Shamile, version elektronik 1.0, fq.6.
[iii] Hashr, 7.
[iv] Ebu Davud, Sunen Ebi Davud: Daru-l-fikri, 4, 200.
[v] Buhari. *Sahihu-l-Buhari, 9.* Përktheu në gjuhën shqipe: Bahri Aliu. Prishtinë, 2002, faqe 5, nr. 3650.

GEGA I DAMASKUT

Një nga figurat e shquara kombëtare shqiptare në botën arabe e më gjerë.

Shpërngulja apo migrimi i shqiptarëve në vendet e ndryshme të botës, pavarësisht motiveve, është një dukuri e hidhur, për vetë qenien shqiptare. I vetmi satisfaksion i kësaj dukurie është suksesi dhe kontributi i personaliteteve me rrënjë shqiptare, të cilët me punën e tyre kanë bërë që trojet shqiptare të njihen nga shumë popuj të ndryshëm, sepse sa herë që atyre iu është dhënë rasti, ata kanë folur për origjinën e tyre me krenarinë më të madhe. Me siguri që ata kanë hasur në shumë peripeci dhe sfida gjatë krijimit të karrierës së tyre, por falë punës, ia kanë dalë që të realizojnë sukseset e veta, ndërsa dikush prej tyre ka realizuar edhe ëndrrat e tyre për t`u kthyer dhe për ta vazhduar veprimtarinë në trojet e vendlindjes.

Pa dyshim njëri nga këto figura të shquara kombëtare është profesori ynë i respektuar Muhamed Mufaku Gega, me orgjinë nga Kosova. Ai u lind në Damask, Siri, më 23 shkurt 1952. Ai ka titujt shkencorë: PhD në Letërsi Krahasuese dhe PhD në Historinë Moderne nga Universiteti i Prishtinës - Kosovë.

Gjatë viteve 1974-2018 ka punuar Profesor në një numër universitetesh kosovare dhe jordaneze. Ka qenë Drejtor i Institutit të Studimeve Orientale në Prishtinë 2018-2020, kryeredaktor i revistës "Studime Orientale" në Prishtinë 2018-2021.

Për punën e tij ka marrë shumë çmime, si: Certifikatë Mirënjohjeje "Baghdala" për kontributin në afirmimin e letërsisë arabe, 1985; Medalje të Republikës së Kosovës, për veprimtari të përgjithshme, 2012; Certifikatë Mirënjohjeje për "Ambasador i Universitetit të Sarajevës", 2012, për punën e tij të përgjithshme në historinë e Bosnjës; Certifikatë Mirënjohjeje dhe një çmim nga Forumi për Marrëdhëniet Arabe dhe Ndërkombëtare në Katar për përkthimet e tij të përgjithshme, 2014; "Vehbi Dibra" në Maqedoni të Veriut, për punën e tij të përgjithshme dhe kontributin për shqiptarët myslimanë, 2022, ndarë nga Rijaseti i BFI-së.

Muhamed Mufaku Gega, ndërkaq, ka qenë anëtar akademik dhe anëtar redaksie i revistave shkencore: anëtar i Akademisë së Gjuhës Arabe në Damask që nga viti 2000; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës që nga viti 2010; anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnjë-Hercegovinës që nga viti 2018; anëtar i Shoqatës së Orientalistëve Kosovarë që nga viti 2002; anëtar i redaksisë së revistës "Prilozi za Orientalnu Filologiju", Sarajevë 2000-2022; anëtar i Bordit Shkencor të Shoqatës Tuniziane Mesdhetare për Studime Historike dhe Sociale dhe Ekonomike 2013-2022; anëtar i Komisionit këshillimor të revistës "Astoor" për studime historike 2015-2022; anëtar i Komitetit Këshillimor të Gazetës Historike Egjiptiane 2021-2022.

Profesor Muhamed Mufaku Gega ka fond të madh hulumtimesh shkencore: 55 punime të botuara në revista shkencore të referuara në disa gjuhë (arabisht, shqip dhe anglisht). Gjatë viteve 1977-2021 ka marrë pjesë në shumë tubime, seminare dhe konferenca ndërkombëtare. Ka rreth 82 kumtesa të prezantuara në simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare gjatë viteve 1976-2022, të mbajtura në universitete dhe institucione shkencore evropiane, arabe dhe turke, shumica e të cilave janë botuar.

Kontribut të madh ka dhënë në lëmin enciklopedik. Artikuj nga "Al-Alban", "Albania", "Vahbi Ismail", "Ivo Andriq" dhe të tjerë për "Enciklopedinë e Madhe Arabe" (24 vëllime), Damask, 1998. Ndërkaq, veprat autoriale të shkruara dhe të botuara të profesor Muhamed Mufaku Gega janë:

1. Kultura arabe në alfabetin arab, Kuvajt (Bota e Dijes), 1983.
2. Historia e Beogradit islamik, Kuvajt (Dar Al-Urubah), 1987.
3. Shqiptarët në botën arabe (në shqip), Prishtinë, Rilindja, 1990.
4. Veçoritë arabe islame në letërsinë shqipe, Damask (Unioni i Shkrimtarëve Arabë), 1990.
5. Islami në Jugosllavi nga Beogradi në Sarajevë, Aman (Shtëpia e Al-Bashir), 1993.
6. Të dhëna për Damaskun dhe Shamin Jugor në fund të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, Damask (Dar Al-Hassad), 1993.
7. Studime në historinë e civilizuar të Shamit në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, Damask (Dar Al-Abjadah), 1995.
8. Studime në historinë e civilizuar të Islamit në Ballkan, Tunizi/Dubai (Fondacioni Al-Tamimi/ Juma Al Majid), 1995.
9. Kosovo/Kosova epiqendra e konfliktit shqiptaro-serb në shekullin e njëzetë, Kajro (Qendra Hadara për Studime Politike), 1998.
10. Ndërhyrjet arabo-ballkanike në historinë mesjetare dhe moderne, Damask (Unioni i Shkrimtarëve Arabë), 2000.
11. Roli i vakëfit në shoqëritë islame, Damask (Dar Al-Fikr), 2000.
12. Studime mbi dhurimin e parave, Tunizi (Fondacioni Tamimi), 2000.
13. Studime mbi Qeverinë/Shtetin Arab në Damask 1918-1920, Irbid-Amman (Al-Shorouk/Hamada), 2000.
14. Të shkruarit në gjuhën arabe në Bosnjë, Amman - Irbid (Al-Shorouk - Hamada), 2001.
15. Rishikimi i orientalizmit: vetvetja dhe tjetri - përvoja e Jugosllavisë, Bejrut (Dar Al-Madar Al-Islami), 2000.
16. Nga shtëpia e Islamit në atdhe dhe nga patriotizmi në nacionalizëm, Bejrut (Shtëpia Arabe e Shkencës), 2004.
17. Bosnja ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, Damask (Unioni i Shkrimtarëve Arabë), 2005.
18. Islami në një Evropë në ndryshim: Përvoja e Shqipërisë në shekullin e njëzetë, Bejrut (Shtëpia Arabe e Shkencës), 2007.
19. Kosova ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes, Bejrut (Shtëpia Arabe e Shkencës), 2008.
20. Dokumente arabe në Qendrën e Arkivave në Dubrovnik, Kajro (Këshilli i Lartë i Kulturës), 2008.
21. Lidhjet letrare shqiptare-arabe, Tiranë (ACFOS), 2009.
22. Sinan Hasani, romancieri, dëshmitar i jetës dhe vdekjes së Jugosllavisë, Amman (Times), 2009.
23. Kosova: Manifestimet kulturore ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, Bejrut (Shtëpia Arabe e Shkencës), 2009.
24. Vakëfi në botën islame-e kaluara dhe e tashmja, Bejrut (Jadal), 2011.
25. Nga historia kulturore e kafesë dhe e kafeneve, Bejrut (Jadal), 2012, botimi i dytë: 2014.
26. Studime në marrëdhëniet arabo-ballkanike në historinë mesjetare dhe moderne, Bejrut (Tabela), 2012.
27. Vakëfi i grave në botën e Islamit: Një qasje e re ndaj statusit të gruas në shoqëri, Bejrut (Dar Jadawel), 2014.
28. Islami në Ballkan (bashkautor), Dubai (Al-Misbar), 2014.
29. Ballkani nga Lindja në Orientalizëm, Doha (Forumi Arab dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), 2014.
30. Nga historia e shqiptarëve të Egjiptit gjatë shekujve XV-XX, Prishtinë (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës), 2016.
31. Komuniteti i Fshehur - kapituj nga historia e shqiptarëve në Egjipt, Kajro (Dar Al-Shorouk), 2018.
32. Nga historia e qytetëruar e Shamit gjatë shekullit të parë të sundimit osman, Amman (tani botues dhe shpërndarës), 2019.
33. Bosnja dhe Hercegovina gjatë sundimit osman, Aman (tani botues dhe shpërndarës), 2019.
34. Nga qeveria në shtet: përvoja e Qeverisë Arabe në Damask 1918-1920, Amman (tani botues dhe shpërndarës me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës), 2020.
35. Personalitetet shqiptare në Lindjen e Mesme gjatë shekujve 16-20, Shkup, 2021:

Figura shqiptare në Lindjen e Mesme-shek. XVI-XX, Shkup (Logos A), 2021.

36. Nga historia e shqiptarëve në Egjipt-version i zgjeruar, Shkup (Logos A), 2022.
37. Shpërngulja e shqiptarëve në Damask në shekullin e njëzetë dhe kontributi i tyre në jetën kulturore, Amman (tani botues dhe shpërndarës), 2022.

Profesor Muhamed Mufaku Gega ka edhe vepra me karakter hulumtues, të cilat janë:

1. Muhamed bin Muhamed Al-Khanji, Thelbi i Zotit në biografinë e studiuesve dhe poetëve boshnjakë, redaktuar dhe paraqitur, Kuvajt (Fondacioni Al-Babtain), 2010.
2. Muhamed bin Muhamed Al-Khanji, Egypt News, hetim dhe prezantim në partneritet me Amin Yusef Odeh, Damask (Shtëpia Al-Hassad), 2010.
3. Shawkat Suleiman Ghawji, Kujtimet e mia të Shqipërisë, të Egjiptit dhe të Shamit në shekullin e njëzetë, redaktuar dhe paraqitur, Bejrut (Dar Jadwal), 2011.
4. Tawfiq Tannous, Historia e Luftës Ballkanike 1912-1913, Hetimi dhe Paraqitja, Bejrut (Tabela), 2013.
5. Kujtimet e Muhsin al-Barazi, kopje e verifikuar, e bazuar në arkivin personal, Aman (tani botues dhe shpërndarës), 2022.

Profesori ka shkruar më shumë se një mijë artikuj të specializuar në revistat kulturore "Al-Arabi", "Al-Bayan", "Al-Faisal" etj. dhe në suplementet kulturore në gazetat arabe "Al-Hayat", "Al-Sharq", "Al-Awsat", "Al-Araby Al-Jadid" etj. dhe në ato kosovare.

Në fund, vlen të përmendim se Muhamed Mufaku Gega flet dhe shkruan në gjuhën arabe, shqipe, boshnjake dhe angleze. Aktualisht jeton në Prishtinë (Kosovë) dhe në Amman (Jordani).

Përgatiti: Qufli Osmani

"Në solemnitetin e OSBE-së", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 14 shtator, 2022, shpërndarë pastaj edhe nga BFI. Takimi i organizatës së sigurisë në botë, me seli në Shkup, ka qenë i rregullt dhe i lamtumirës i Ambasadorit Clemens Koja (Klemens Koja). Reisi është shoqëruar nga bashkëpunëtorët Mustafa Dauti dhe Abdulkerim Iseni.

T'IA JAPIM HAKUN RRUGËS: TË ULIM SHIKIMIN!

Nga Irfan Agushi

Sikur vetëm këtë këshillë të Pejgamberit (a. s.) të dëgjonim, do na të mjaftonte që ta trajtojmë me respekt çdo femër që takojmë...

Keni dëgjuar për gruan e pejgamberit Lut (alejhis-selam)? Epo, ajo ishte besimtare, i praktikonte ritet e fesë, nuk ishte pjesë e mëkatit të popullit të shfrenuar. Mirëpo, ajo u dënua, sepse faji i saj i vetëm ishte neglizhenca, moskujdesi, pranimi i së keqes si diçka normale. Asaj nuk i pengonte se ç'bënte populli dhe mu për këtë Allahu e dënoi edhe atë, bashkë me popullin e shthurur, për t'i dhënë botës një mësim të denjë. Por, njeriu harron dhe i përsërit mëkatet.

Kur dikush bën një mëkat të rëndë - si ai me përdhunimin e vajzës së mitur në Prishtinë kohë më parë - ne mërzitemi, reagojmë, protestojmë, e ngremë zërin dhe kërkojmë të vendosim gjijotinën në mes të Prishtinës! Por, kjo gjendje zgjat dy ditë, një javë dhe më pas, vendin e kësaj ndodhie e zë ndonjë "i mençur" i Tik-Tok-ut, të cilët po shtohen si kërpudhat pas shiut.

REAGIMI I MASËS, I VONUAR

Reagimi i masës është i drejtë, por është i vonuar. Masa duhej të reagonte më herët, me qëllim që të parandalonte akte të këtilla makabre, të ushqyera nga mentaliteti i këtillë primitiv i një brezi injorantësh. Duhej reaguar atëherë kur fjalori i asaj që ne e njohim si art, „kënga, emisionet argëtuese, koncertet…", shndërrohet në një armë e cila një ditë vret. Duhej të reagonim atëherë kur emisionet e famshme të amoralitetit zinin vend në TV-të tona, në ato emisione ku sheh dhe dëgjon gjithçka, pos Artit: lakuriqësi deri në skaj, ku nuk ka më ku të shkojë; dëgjon djem dhe vajza duke treguar „barcoleta" me fjalët më banale, aq sa edhe rrugaçët do të turpëroheshin prej tyre.

Gjërave që na mësonin për moralin, për respektin ndaj femrës dhe shoqërisë,

po ua kthejmë shpinën. Del plaku 70-vjeçar, me një këmbë në varr, dhe në pyetjen mbi Festën e Bajramit me tallje thotë: „Kush është ai?! Nuk e njoh unë! S'e kam parë asnjëherë! S'e kam takuar!…"

Epo, do ta takosh shumë shpejt; mos u mërzit shumë…

Del tjetri dhe thotë: "Shamia nuk është jona! Shkoni në Arabi!…" Tipave të tillë nuk u pëlqen ta shohin femrën me shami, pasi nuk kanë çfarë shohin pastaj! U pëlqen zhveshja; u pëlqen të zgurdullojnë sytë dhe pastaj të shtiren si patriotë!

Fenë nuk e duam, "se është e arabëve"... Po tradita shqiptare e kujt është, që ia kemi kthyer shpinën shumë kohë më parë?! Ku shkuan veshjet e bukura që visheshin në dasmat shqiptare?! Ku shkuan çiftelia dhe fyelli?

A, po! Për pak harrova: ne jemi shtet „laik" dhe „evropian". Ja ku na solli gjithë ky "emancipim", gjithë ky "modernizim", gjithë ky "përparim". Rinia jonë po „edukohet" nga TV-të dhe rrjetet sociale, ku pos edukatës, gjen gjithçka tjetër.

"OSE DO TË NA DALIN MENDTË, OSE Ç'KE ME TË"

Epo, ose do të na dalin mendtë, ose ç'ke me të! Kanale shqiptare nuk e di sa janë - po supozoj: nja 80, apo edhe më shumë. Në Zvicër numërojmë srf 1, srf 2, srf 3 dhe s'ka më; ndonjë privat andejkëndej. Epo, zviceranët nuk janë të emancipuar sa duhet - ata nuk dinë të mbajnë emisione si ato që shohim ne në TV-të tona.

Kulmi i gjithë kësaj „edukate" është që në moshën 70-vjeçare të vdesësh në motel me „Schatz-in" (- dashnoren) në krah, në vend që vdekja të të gjejë në xhami, në kishë a në sinagogë, duke iu lutur Zotit për falje. Epo, një gjë është e sigurt: këta njerëz (pleq ose të rinj) nuk i ka mësuar të sillen kështu as Jezusi, as Muhamedi; as Teuta, as Agroni...

Në këtë mes më erdhi në mend, si vetëtimë, një ngjarje nga koha e pejgamberit Muhamed (alejhis-selam): Disa të rinj që po qëndronin rrugëve të Medinës, e pyetën atë se a u lejohet atyre të qëndrojnë rrugëve të qytetit për të biseduar. Muhamedi (s.a.v.s.) u tha atyre se nuk është e pëlqyeshme një gjë e tillë. Por, nëse vazhdojnë të rrinë, duhet t'ia japin hakun rrugës. E, si kështu, o Pejgamber? - pyeti njëri. Duke ulur shikimin - tha Muhamedi (s.a.v.s.).

O Zot, i them vetes. A nuk është po ai xhematë që i dëgjoi Fjalët e Zotit dhe ato të Pejgamberit nga hoxha dhe pas namazit u ul në kafeteritë buzë rrugicave, me fytyrë kah rruga, pa lënë asgjë që t'i shpëtojë "radarit", syve të tyre?! Sikur vetëm këtë këshillë të Pejgamberit ta dëgjonim, do na mjaftonte për ta trajtuar me respekt çdo femër që takojmë.

O Zot, Ti je i drejtë! O Zot, sa larg Islamit jemi! Sa shumë e kemi dëmtuar Islamin me sjelljet tona!

Zoti na udhëzoftë.

(Zvicër, 31.08.2022)

HARAMI VJEN NGA GJËRAT E NDALUARA

Sipas mendimit të Sujutiut, përkujtimi i ditëlindjes së Muhamedit (a. s.) është i argumentuar me: sunnet, ixhma dhe kijas. Të gjithë myslimanët në botë e festojnë ditëlindjen e tij. E festoi edhe vetë Pejgamberi, ngase agjëronte ditën e hënë dhe të enjte, kështu që kur e pyetën 'pse agjëron të hënën', ai u përgjigj: "Të hënën linda, të hënën më erdhi shpallja, të hënën bëra hixhretin."

Shkruan: Sherif Ahmeti

Sipas mendimit të disa individëve që i takojnë grupit të ashtuquajtur "selefijjun", siç është edhe drejtimi "vehabij", mevludi, respektivisht, tubimi i njerëzve për të lexuar Mevlud, duke menduar se me atë arrihet ndonjë *thevab* (sevap, shpërblim) është bid'at i përbuzur. Sipas tyre, tubimet e tilla për të dëgjuar ndonjë kaside, salavate, apo për të lexuar ndonjë ashere nga Kurani, janë risi, bid'ate të këqija, andaj duhet larguar dhe braktisur ato.

Sa është i drejtë dhe me vend ky konstatim i tyre? Sa është i lavdishëm, ose i përbuzur, organizimi i tubimeve për këtë qëllim? Me këtë organizim a fitohet ndonjë e mirë – *thevab*, apo jo? Lidhur me këtë përgjigjen dijetarët më eminentë të botës islame.

Së pari, po e sjellim përgjigjen që e dha Hafidh (Hafëz) Xhelaludin Abdurahman bin Ebi Bekr es-Sujuti Iidhur me mevludin. Në veprën e tij "El-Havilu li'l-Fetava" ai thotë: "Thelbi i punës rreth mevludit, siç është: tubimi i njerëzve, lexim i pjesëve të Kuranit, rrëfim i ngjarjeve dhe i ndodhive para, gjatë dhe pas



lindjes së Pejgamberit, të mbështetura në fakte, shtruarja e sofrës, ngrënia dhe shpërndarja e njerëzve nga ai tubim, pa shtuar diçka tjetër, është *bid'ati hasene* dhe organizuesi i tij shpërblehet me *thevab*, ngase me të i bëhet respekti autoritetit të Pejgamberit (a. s.) dhe shprehet kënaqësi e gëzim për lindjen e tij të famshme."

MBRETI I IRBILIT, MUZAFER EBU SEID, E NISI...

Kjo është përgjigjja dhe fetvaja e Sujutiut rreth Mevludit. Mandej, në veprën e tij "El-Havi" ai shënon: "Mbreti i Irbilit, Muzafer Ebu Seid, sundimtar i lavdishëm, i devotshëm dhe bujar, ishte i pari që e filloi organizimin e manifestimit për

ditëlindjen e Pejgamberit. E, për hir të madhështisë së këtij manifestimi Ebu'I-Hatab ibni Dihje e thuri një vepër në vargje mbi lindjen e Muhamedit (a. s.) dhe e quajti "Ndriçim mbi lindjen e Më të Gëzuarit...". Sipas Ibni Hal-likan-it, Ebul Hatabi ishte një nga dijetarët e dalluar dhe autoritativë.

Sujutiu na sjell edhe vërejtjen e Taxhudin Ymer Fakihaniut dhe përgjigjen që ia kushton vërejtjes së tij. Taxhudin Fakihaniu ishte një nga malikijët e fundit, i cili e shkroi veprën "El-Mevridu 1i'1- kelam ala amel'il-mevlid", në të cilën pos tjerash thotë: "Unë nuk di se për mevlud ka bazë në Kuran apo në Sunnet. Nuk është përcjellë se dikush prej dijetarëve, që ishin shembull në fe dhe që u përmbaheshin traditave të të parëve, kanë bërë diçka kështu. Pra, ky është bid'at i shpikur prej grykësve, për t'u ushqyer. Këtë, nga fakti se kur shqyrtojmë pesë dispozitat e sheriatit, themi: do të jetë *vaxhib*, *mendub*, *mubah*, *mekruh* ose *haram*. E, s'ka dyshim se nuk është vaxhib. Nuk është as mendub; sepse mendub është ajo që e kërkon sheriati, por pa qortim për moskryerje. E, këtë nuk e kërkoi sheriati. Për sa di unë, nuk e bënë sahabët, as tabiinët. Kjo është përgjigjja ime para Zotit, nëse do të pyetem. Nuk është as mubah, sepse sipas ixhmait të myslimanëve risia në fe (bid'at), nuk mund të jetë *mubah*. Nuk mbetet tjetër vetëm se të jetë *mekruh* ose *haram*. E, kjo varet nga organizimi që mund të jetë: nëse njeriu e bën këtë për familjen e vet, duke mos tubuar njerëz për ngrënie e të tjera, është *bid'at mekruh*; e, nëse e bën për një rreth më të gjerë, shtron sofra të ushqimit, dhe posaçërisht nëse aty sjell edhe muzikë, përzihen meshkuj e femra të shfrenuara, pa kurrfarë dyshimi është *haram*…"

Në këto konstatime të Fakihaniut, imam Sujuti përgjigjet: "Thënia e Fakihaniut se: nuk di ndonjë bazë për mevlud as në Kuran e as në Sunnet, nuk paraqet kurrfarë fakti, sepse mosdija nuk do të thotë mosekzistim i bazës."

DIALOGU MIDIS SUJUTIUT DHE FAKIHANIUT

Fakihaniu: "E shpikën grykësit për të ngrënë, dhe jo dijetarët."
Sujutiu: "E shpiku një sundimtar i drejtë dhe fetar, ndërkaq e prezantuan dijetarë të devotshëm. Dihje i thuri vargjet. Të gjithë ata, pra, ishin dijetarë të devotshëm: e pëlqyen, e vërtetuan dhe nuk e urrejtën!"

Fakihaniu: "Nuk është mendub, pasi që nuk e kërkoi sheriati."
Sujutiu: "Kërkesa e sheriatit ndonjëherë është me tekst (en-nassu), e ndonjëherë me kijas – me analogji. Sipas analogjisë, bid'atet mund të jenë: vaxhib, haram, mendub, mekruh, mubah. Këtë mund ta kuptojmë kur e parashtrojmë bid'atin përbri rregullave të sheriatit. Nëse bën pjesë në rregullat e vaxhibit, ai është vaxhib; dhe kështu me radhë, edhe në të tjerat. Imam Shafiu thotë: "Çka është kundër Kuranit, Sunnetit dhe ixhmait, është bid'at i keq, është haram; dhe, çka sjell dobi, është *bid'at i mirë*, nuk është e përbuzur". Në këtë nuk ka kundërthënie. E ky nuk është kundër Kuranit, kundër Sunnetit, as kundër ixhmait dhe, si i tillë, është *bid'at i mirë*."

Fakihaniu: "Nuk është mubah, sepse risia në fe nuk mund të jetë mubah."
Sujutiu: "Është tezë e papranueshme, sepse risitë nuk janë të kufizuara vetëm në haram e në mekruh. Përkundrazi, ato mund të jenë edhe mendub, edhe vaxhib. Neveviu thotë: "Bid'at në sheriat është një shpikje, që s'ka qenë në kohën e Pejgamberit; e, ai mund të jetë i mirë ose i keq!"

Fakihaniu: "Nuk duhet shtruar sofër për të ngrënë…"

Sujutiu: "Shtruarja e sofrës së ushqimit konsiderohet bujari, dhe bujaria është virtyt i porositur!"

Fakihaniu: "Po sjellja e muzikës dhe përzierja e meshkujve me femra?"
Sujutiu: "S'ka dyshim se një punë e tillë është haram, por ai haram vjen nga ato gjëra që janë të ndaluara, e jo nga vetë baza e tubimit për Mevlud. Baza, pra, është e shëndoshë, ndërsa bishtnimet janë të ndaluara. Nëse tubimit për namazin e xhumasë i bishtnohen sende të këqija, nuk mund të thuhet se tubimi për xhuma është haram; por, bishtnimet janë haram. E, kështu është puna edhe me Mevludin!"

Këto ishin përgjigjet e Sujutiut në vërejtjet e Fakihaniut.

FALËNDERIMI I SHPREHET ZOTIT ME LLOJ-LLOJ ADHURIMESH

Ibni Haxheri e gjen një bazë edhe në sunnet për mevludin, për të cilin thotë: "Pejgamberi vjen në Medinë dhe i gjen jehudët që po agjëronin ditën Ashurasë. Kur i pyeti, ata i thanë: "Është ajo ditë kur Zoti e fundosi faraonin dhe e shpëtoi Musanë, e ne agjërojmë në shenjë falënderimi ndaj Zotit të madhërishëm" (Sahihajn). Nga kjo kuptohet puna e falënderimit ndaj Allahut për hir të ndonjë të mire që na e sjell ose për largimin e ndonjë të keqeje, duke e përsëritur atë për çdo vit. Falënderimi i shprehet Zotit me lloj-lloj adhurimesh, siç janë: agjërim, namaz, sadaka, lexim të Kuranit etj. Atëherë, a ka mirësi më të mirë e më të madhe se shfaqja, lindja e këtij Pejgamberi, që është mëshirë jo vetëm për myslimanët, jo vetëm për njerëzit, por edhe për të gjitha krijesat në ekzistencë?! Derisa edhe vetë Pejgamberi e agjëroi atë ditë në shenjë falënderimi ndaj Zotit që e shpëtoi Musanë, a mos t'i bëhet falënderim Zotit për lindjen e Muhamedit (a. s.), me anën e të cilit e shpëtoi njerëzimin nga errësira, nga injoranca, nga mizoria, nga armiqësia në këtë jetë e do t'i shpëtojë edhe në Ditën e Gjykimit të gjithë ata që i besuan?! Ky është një argument i fortë për tubimin në mevlude duke u mbështetur te kijasi, i cili në këtë rast kuptohet nga vetë puna e Pejgamberit (a. s.) dhe puna e tij është sunnet për ne. Pra, ai falënderoi Zotin për shpëtimin e Musasë, e ne kemi për detyrë të falënderojmë për dërgimin e Muhamedit (a. s.). Ky fakt nuk mund të mohohet, ngase i njëjti qëllim është në të dy rastet.

Si bazë tjetër për mevludin është edhe kjo: "Theri kurban (akika) për vetveten pas pejgamberllëkut", e dihet se atë detyrë e pati kryer gjyshi i tij në ditën e shtatë të lindjes së Muhamedit. Ajo detyrë nuk do të duhej përsëritur sikur të mos ishte për qëllim falënderimi ndaj Zotit, që e bëri mëshirë për botën. Ky është, pra, edhe një sinjal për ne se duhet përkujtuar dhe shprehur falënderim për ditëlindjen e tij.

Është thënë prej Pejgamberit (a. s.) se Ebu Lehebit do t'i lehtësohet ndëshkimi (adhabi) për çdo të hënë ngase qe gëzuar për lindjen e Muhamedit dhe në shenjë gëzimi e pati liruar nga robëria shërbetoren Thuveibe.

Sipas mendimit të Sujutiut, përkujtimi i ditëlindjes së Muhamedit (a. s.) është i argumentuar me: sunnet, ixhma dhe kijas. Të gjithë myslimanët në botë e festojnë ditëlindjen e tij. E festoi edhe vetë Pejgamberi, ngase agjëronte ditën e hënë dhe të enjte, kështu që kur e pyetën 'pse agjëron të hënën', ai u përgjigj: "Të hënën linda, të hënën më erdhi shpallja, të hënën bëra hixhretin."

S'ka dyshim se tubimi për mevlud duhet të jetë i kufizuar në ato punë, që janë falënderim i vërtetë dhe i sinqertë ndaj Zotit (xh. sh.), përkujtim i shëmbëlltyrës së Muhamedit (a. s.) që e praktikonte në të gjitha poret e jetës, përkujtim i këshillave nga Kurani, të cilat e përforcojnë besimin dhe nxisin në punë të mira, duke lexuar ndonjë pjesë prej tij, duke kënduar kaside që nxisin edhe më shumë

dashuri ndaj Pejgamberit dhe e përkujtojnë jetën e ardhshme, duke shpërndarë dhe ndonjë sadaka në të mirë të bashkësisë islame dhe ndonjë ushqim për familje dhe për miq. Çdo gjë që shpreh gëzim e hare për Pejgamberin, është punë e lejuar; ndërsa duhet ruajtur prej haramit dhe punëve të tjera që nuk përputhen me normat e sheriatit.

Nuk duhet të harrojmë se përkujtimet për ditëlindjen e Muhamedit (a. s.) duhet të jenë nga dashuria shpirtërore e besimtarit, të cilën e ndien në shpirtin e vet. Kështu është ngase as besimi i besimtarit nuk është i vlefshëm te Zoti pa dashuri ndaj Pejgamberit të Tij. Mirëpo, duhet ditur se vetëm këto manifestime nuk mjaftojnë për shprehjen e dashurisë ndaj tij. Nuk mjafton si shprehje e dashurisë ndaj Muhamedit (a. s.) vetëm tubimi për mevlud, leximi i disa ashereve, këndimi i disa kasideve, me të cilat lavdërohet ai, shtruarja e sofrave etj. Dashuria e sinqertë dhe e vërtetë ndaj tij është: zbatimi i sunneteve që na i la ai; orientimi i jetës dhe i sjelljeve sipas udhëzimeve që na i porositi ai; ndjekja e rrugës së tij ashtu si-kurse e ndoqën dhe e praktikuan as'habët e tij; njohja sa më e thellë e jetës dhe e sjelljeve të tij në raste të ndryshme, në familje, në ibadete etj.. Nëse tubimet e tilla e luajnë këtë rol, atëherë ato janë të mira dhe shumë të nevojshme; e nëse në ato tubime lexohen vetëm vargjet e njëjta që i përktheu në gjuhën shqipe Tahir ef. e që gati janë bërë si "tabu", atëherë nuk është arritur ajo që është kërkuar për të shprehur dashurinë ndaj Muhamedit (a. s.). Në tubimet e tilla duhet të jetë për qëllim lartësimi i vlerës së shehadetit – besimit, të cilin na e mësoi Muhamedi (a. s.) me anën e shpalljes që ia kumtoi Zoti i madhërishëm, sepse ne nuk kemi gjuhë, as nuk jemi të zotët ta lavdërojmë Pejgamberin edhe nëse përpiqemi me të gjitha fuqitë tona pas lavdërimit që i bëri Zoti i mëshirshëm kur tha: «Lart ta ngritëm zërin (përkujtimin) tënd (Muhamed)». Detyra jonë është ta përkujtojmë Pejgamberin tonë ashtu që të na bëhet shembull në çdo moment të jetës, në çdo veprim dhe në çdo sjellje tonë. Nëse për këtë qëllim organizohen tubimet, atëherë vijnë në shprehje thëniet e Pejgamberit (a. s.): *"Çka vlerësojnë si të mirë myslimanët, edhe te Zoti është e mirë." "Dora e Zotit është me xhematë, e kush ndahet, ndahet në Xhehenem." "Zoti nuk i lejon myslimanët të bien në ujdi për një punë që është e gabueshme."*

Kur qëllirni i organizimit për përkujtimin e ditëlindjes së Muhamedit (a. s.) është ky që u përmend, atëherë nuk iu duhet vënë veshi fjalëve të vëllezërve vehabijë e selefijjë, të cilët as nuk u bashkohen myslimanëve të botës në këso manifestime e as nuk pajtohen me qëndrimet e tyre. Prej tyre duhet kërkuar që të ndalin gjuhën dhe t'i lënë thashethemet, sepse, siç përmendëm, është rrezik i madh ndarja prej xhematit islam, e këtu është fjala për xhematin botëror islam.

Qëllimi i të gjithë myslimanëve në organizimin e manifestimeve të tilla është të arrihet një pikë mëshirë nga Mëshiruesi i pakufishëm në atë ditë kur do të jemi më të nevojshëm dhe kur do t'i lejohet shefaati këtij Pejgamberi të lavdishëm, për të cilin organizojmë tubime në shenjë gëzimi dhe përpiqemi të shprehim dashuri të sinqertë ndaj tij.

DITËLINDJA DHE DITËT E ZOTIT

Nga pikëpamjet e përgjithshme: Çdo punë që i sjell të mira bashkësisë e nuk është kundër ndonjë dispozite të fesë, e as nuk është çështje e porositur prej fesë, Islami nuk e ndalon atë. Qëllimi islam, fillim e mbarim, është për të mirën dhe interesin e njerëzisë. Pra, aty ku është dobia, aty është sheriati i Zotit.

Gjersa baza, motivi në manifestimin dhe përkujtirnin e ditëlindjes, është respektimi i traditës së personit të ditëlindjes, është përfitim nga sjelljet dhe vetitë e tij të bukura, madje është i tubimit, bashkimit dhe afrimit të njerëzve, i ndihmës dhe i bamirësisë reciproke ndërmjet njerëzve; është kthesë në të përkujtuar dhe në të përmendur më shumë të Zotit (xh. sh.), duke dëgjuar pjesë të leximit nga Kurani dhe këshilla të larta nga hadithi. Të gjitha këto janë mirënjohje dhe falënderim ndaj Zotit, i cili iu dhuroi atë të cilit i përkujtojmë ditëlindjen, dhuroi të mira në fe dhe në dynja. Pa dyshim, një përkujtim i këtillë është i dobishëm dhe i frytshëm.

Mirëpo, pasi që këto tubime më vonë filluan t'i përshkojnë gjëra të pakëndshme, lloj-lloj bid'atesh, filloi edhe kundërshtimi, jo ndaj vetë esencës së tubimeve dhe përkujtimeve, por ndaj devijimeve të futura në këto raste, andaj edhe shpeshherë kemi pasur rastin të dëgjojmë fjalë edhe për vetë "mevludin" si bid'at etj.

Nga i njëjti aspekt dhe nga i njëjti motiv edhe qytetarët organizojnë, në manifestimet dhe përkujtimet e këtilla, tubime kulturore, fetare, sociale etj. Njerëzit përkujtojnë heronjtë dhe ditët heroike, i përkujtojnë dëshmorët me mirënjohje, duke ngacmuar, ndër të tjera, ndjenja patriotike, duke zgjuar ndjenja morale e shpirtërore.

Nga pikëpamja fetare: Eshtë mirë të themi çka thanë dijetarët (aty ku është dobia e bashkësisë, është dispozita e Zotit) dhe nuk është haram gjithçka që nuk e bënë të parët dhe nuk është bid'at, as gjë e keqe gjithçka që u lajmërua nga çështjet e futura në ideologji, në adhurime, në sjellje, derisa ato nuk janë të përfshira me ndonjë dispozitë apo të mbështetura në ndonjë bazë. Ne e pamë më parë se çka është baza e tubimeve të tilla.

Për këtë justifikim të këtyre tubimeve dhe manifestimeve po shtojmë:

– Fjalën e Zotit: **"Ve selamun alejhi jevme vulide ve jevme jemut",** madje, përsëritjen e tekstit nëpërmjet gjuhës së krijesës dhe fjalët e Zotit: **"Ve selamun alejje jevme vulidtu ve jevme emutu."** Në këto dy ajete gjejmë argumente të forta mbi respektin e ditëlindjes dhe të vdekjes. Sepse, po në këto dy raste manifestohen fuqia e Zotit dhe fshehtësitë specifike të mprehtësisë së Tij si krijues. Atëherë, si është rëndësia e përkujtimit të ditëlindjes apo të vdekjes së njeriut, për të cilin është vërtetuar në dijen e Zotit se do të ketë ndikim të madh apo të vogël në bashkësinë njerëzore?!

– I dërguari ynë, Muhamedi (a. s.), përkujtonte ditëlindjen e tij në çdo shtatë ditë dhe në shenjë falënderimi ndaj Zotit agjëronte ditën e hënë. Në realitet, me këtë agjërim ngjallte përkujtimin e një dite të ndershme nga ditët e Zotit. Kur u pyet se 'pse rregullisht agjëron atë ditë', ai tha: «Ajo është dita në të cilën u linda dhe në të cilën u dërgova (u gradova me gradën pejgamber).» Me këtë, kujdes që pati Pejgamberi ndaj kësaj dite udhëzon mbi pozitën e saj dhe mbi rëndësinë e përkujtimit dhe të respektit.

– Përmendet se në haxhin lamtumirës Pejgamberi (a. s.) theri kurban aq deve, sa ishte numri i viteve të jetës së tij të bekuar.

– Gjithashtu, thuhet se Pejgamberi përkujtonte ditën e shtatë të lindjes së foshnjës, duke e emëruar dhe duke e bekuar në atë ditë. Dita e shtatë nuk do të kuptohej ndryshe vetëm duke e përkujtuar ditëlindjen, pra manifestim i përnjëhershëm i dy ditëve.

– Pejgamberi përkujtoi edhe ditën e Ashurasë, duke porositur agjërimin e saj.

– Kur bashkojmë të gjitha këto dokumente dhe të gjitha dobitë e përmendura, ngjallja e përkujtimit të ditëlindjeve është dobia më e madhe e ditëve të Zotit për njerëz kur tubimet e tilla nuk përcillen me ndonjë ves të keq.

Për të parën herë, sipas burimeve më të besuara, në mënyrë të organizuar dhe të përshtatshme, ditëlindjen e Pejgamberit e manifestoi sunduesi Mudhaffer (Togrol) - sundues (i Irbilit) në Irak, por pasi që dijetarët e asaj kohe e lejuan dhe konstatuan se është çështje e ligjshme. Me atë rast ai bëri shpenzime të mëdha, duke shpërblyer dhe gostitur masën e popullit, duke i lënë të gjithë të kënaqur, saqë në histori nuk është e njohur prej ndokujt tjetër një organizim i tillë. E, kur hartuan dijetarët vepra me përkujtime të lindjes, të jetës dhe të mrekullive të Pejgamberit, ai i shpërbleu me dhurata të mëdha sa askush pas tij.

PËR TRADITËN POZITIVE TË PËRKUJTIMIT

Më vonë, tradita e përkujtimit të ditëlindjes së Pejgamberit (a. s.), me manifestime të ndryshme e të mëdha, filloi edhe në shtetet dhe qytetet tjera islame. Pastaj u zgjerua manifestimi edhe në ditëlindjet e disa evliave etj. Mirëpo, në shumë raste, kuptohet shumë më vonë, manifestimet e tilla u përshkuan edhe me gjëra të ndaluara e të dëmshme; u bënë sëmundje të vetë fesë dhe të bashkësisë, andaj dijetarët u angazhuan që ose t'i kthejnë manifestimet e tilla në bazë, ose t'i ndalojnë në përgjithësi. Dhe, sigurisht, më mirë do të ishte të ndalohen në tërësi sesa të praktikohen kur në to përdoren gjëra të ndaluara – haram.

Myslimanët manifestojnë dhe përkujtojnë ditëlindjen e pejgamberit islam, të dërguarit për dashuri dhe për paqe mes njerëzisë, udhëzues dhe ndriçues të rrugës së drejtë, të cilin e dalloi Zoti nga të gjithë njerëzit tjerë, duke i dhënë atij çka nuk i dha kujt më parë, duke e mësuar sa asnjë më parë as më prapa, duke e frymëzuar dhe pajisur me libër që nuk zbriti si ai prej qiellit në tokë dhe duke e bërë kusht vërtetimin e tij në deklaratën e besimit, saqë besimi i njeriut nuk është i plotë pa vërtetimin e dërgatës së tij.

Zoti dhe melaqet e tij e lavdërojnë dhe e bekojnë Pejgamberin (a. s.); lavdërojeni, respektojeni dhe përshëndeteni edhe ju, o besimtarë!

(Pjesë nga libri "Komente dhe mendime islame", Prishtinë, 1995, fq. 373–382. Referenca: https://flladi.wordpress.com. Përpunuar nga HeR)

EMIGRANTËT TANË, TË DYTËT PËR NGA BESIMI ISLAM

Mosha mesatare e emigrantëve shqiptarë në Itali është 33 vjeç, ndërsa ndarja gjinore është pothuajse e barabartë: 51.1% janë meshkuj e 48.9% femra; 25,1% e numrit të përgjithshëm të tyre janë minorenë.

Shkruan: Zejnulla Sadiku

Islami në Itali është feja e dytë kryesore mbas Krishterimit. Fenomeni i emigracionit dhe prejardhja e popullsisë me shumicë myslimane e ka renditur Islamin si fenë e dytë në vend[i] Sot popullsia myslimane që banon rregullisht në Itali është 2.6 milionë banorë; shumica prej tyre janë me shtetësi italiane. Numri i myslimanëve në Itali është stabil, me një rritje vjetore afërsisht njëqind mijë persona. Italia është shteti i katërt në Bashkimin Evropian me numrin me të madh me myslimanë pas Francës (6 milionë), Gjermanisë (5 milionë), Britanisë Madhe (4 milionë).

Vlerësimet janë bërë pas një serie kërkimesh nga Fondacioni ISMU (Iniziative e Studi sulla Multietnicità), në bashkëpunim me ORIM Lombardia (L'Osservatorio Regionale per l'integrazione e la multietnicità), të rishikuara me të dhëna të përditësuara nga ISTAT (Instituto Nacionale di Statistica) dhe Ministria e Brendshme nga 1 janari 2017.

Nëse i shtojmë edhe 170.000 të huaj të parregullt myslimanë, në rreth 40% të totalit të emigrantëve të parregullt që ISMU vlerësoi, numri i myslimanëve rritet në 2.8 milionë ose në 4.5 % të popullsisë italiane. Sipas vlerësimeve, parashihet që përqindja të rriten në 6,2 ose në 3,6 milionë, deri në vitin 2030.

Myslimanët e Italisë ndahen në tri kategori: të natyralizuar, të lindur tashmë italianë (domethënë i lindur nga një çift mysliman, ose të paktën një prind italian në kohën e lindjes), italianë të konvertuar, për të cilët mendohet se janë njëqind mijë aktualisht. Sa i përket kombësisë, vlerësohet se shumica e myslimanëve të huaj që banojnë në Itali vijnë nga Maroku (440 mijë), Shqipëria (336 mijë), Bangladeshi (141 mijë), Egjipti (111 mijë)

Fotografi e 8 gushtit 1991, kur shqiptarët "pushtuan" Barin. (FotoArkiv)

dhe Pakistani (106 mijë).

Nga analizat e bëra del se myslimanët që banojnë në kryeqytet (Romë) vijnë nga 42 kombe të ndryshme dhe nga 3 kontinente të ndryshme, prej të cilëve 92% duhet të jenë sunitë dhe 8% shiitë. Brenda bashkësisë së Romës, kështu, shfaqet një Islam "i vogël" multietnik dhe shumëkombësh, shumë i larmishëm, me shumë faktorë etnikë dhe kulturorë. Kjo shumësi e bashkësive islame sigurisht që përfaqëson një element pozitiv, veçanërisht kur krahasohet me qytetet tjera të mëdha evropiane.[ii]

KOMUNITETI SHQIPTAR NË ITALI

Historiku i mërgatës shqiptare është i hershëm. Vetë pozita e vendit ku jetojnë shqiptarët është e tillë që i bën ata të lëvizin në drejtime të ndryshme. Duke analizuar aspektin kohor, bashkësitë më të vjetra shqiptare përbëhen nga arbëreshët në Itali dhe arvanitasit në Greqi. Në radhën e këtyre bashkësive të vjetra mund të hyjë pa mëdyshje edhe bashkësia shqiptare e Egjiptit. Pas këtyre vijnë bashkësitë shqiptare në Turqi, SHBA, Belgjikë, Australi e në ndonjë vend tjetër.

Të fundit vijnë mërgimtarët e katër dekadave të gjysmës së dytë të shek. XX. Shumica e tyre janë vendosur apo bëjnë përpjekje të vendosen në shtetet e ndryshme të Evropës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada.

Shqiptarët në Itali kryesisht veçohen në dy komunitete, si rezultat i valëve të ndryshme të emigrimit. Komuniteti i parë janë arbëreshët - u vendosën në Itali në shekujt XIV-XV dhe emigruan kryesisht për shkak të zhvillimeve politike e luftarake në Shqipëri. Arbëreshët përbëjnë një nga pakicat etno-gjuhësore më të mëdha në Itali. Prej vitit 1999, gjuha arbëreshe (shqipe) njihet nga qeveria italiane si gjuhë “e pakicës etnike dhe gjuhësore.”

Komuniteti i dytë janë mërgimtarët shqiptarët që u vendosën në Itali pas rënies së komunizmit në Shqipëri, përkatësisht pas vitit 1990, kur një numër i madh shqiptarësh emigruan masivisht drejt Italisë, duke formuar, për nga numri, komunitetin e dytë më të madh të emigrantëve në këtë vend.[iii]

Emigrantët shqiptarë në Itali janë komuniteti i dytë më i madh në numër për nga besimi islam. Në vendin e parë gjenden emigrantët me kombësi marokene. Menjëherë pas tyre, në vendin e dytë, renditen emigrantët shqiptarë, ku sipas Institutit Kombëtar të Statistikave në Itali jetojnë 490.483 shqiptarë, prej të cilëve 271 mijë persona janë deklaruar të besimit islam. Shqiptarët me prejardhje nga Kosova, të besimit islam, renditen në vendin e 9, me 49 mijë persona, si dhe myslimanët nga Maqedonia (shumicën e të cilëve e përbëjnë shqiptarët), numri i të cilëve, sipas ISMUS, llogaritet në 35 mijë myslimanë, ndërsa 14.126 prej tyre kanë bërë kërkesë për të marrë shtetësinë italiane. [iv]

Mosha mesatare e emigrantëve shqiptarë në Itali është 33 vjeç, ndërsa ndarja gjinore është pothuajse e barabartë 51.1% janë meshkuj e 48.9% femra; 25,1% e numrit të përgjithshëm të tyre janë minorenë.

Analiza e ekspertëve italianë të statistikave ka identifikuar se në çdo 100 emigrantë në Itali, 8.4 prej tyre janë emigrantë shqiptarë. Sipas raportit të censusit të popullsisë italiane, në periudhën kohore 2001-2019, komuniteti i emigrantëve shqiptarë në Itali është rritur me 143.6%. Përqindja më e lartë e tyre është pozicionuar në pjesën veriperëndimore të Italisë, me rreth 35.2%.

Qytetet italiane më të populluara nga emigrantë shqiptarë janë Milano, ku jetojnë 5.1% e numrit të përgjithshëm; Firenca, ku banojnë rreth 3.8% e tyre; Roma, ku banojnë 3.6% dhe Bari me 2.9%.[v]

BASHKËSITË ISLAME DHE THEMELIMI I TYRE

Shoqatat myslimane në Itali pasqyrojnë shumësinë dhe larminë tradicionale të Islamit. Megjithatë, ka katër shoqata, të cilat për nga numri dhe historia e marrëdhënieve me administratën publike, në veçanti me qeverinë, janë bërë pika referuese "institucionale" të Islamit në Itali. Ato janë: C.C.I.I. (Qendra Kulturore Islame në Itali), e cila e udhëheq Xhaminë e Madhe të Romës, U.C.O.I.I. (Unioni i Komunitetit Islam në Itali), C.I.I. (Konfederata Islamike Italiane) dhe COREIS (Komuniteti Fetar Islam Italian).[vi]

Komuniteti islam në Itali është i organizuar në formë shoqatash. Në vitin 1971 u themelua shoqata e parë islame nga studentë myslimanë - L’USMI, të cilët hapën edhe vendin e parë për adhurim (mesxhid) në Itali, një lokal të vogël në qendrën historike të Peruxhës, të quajtur Moschea di Via dei Priori.

Në vitet ’70-të (shek. XX) në Romë lind Qendra Islamike Kulturore (C.C.I.I.) me ndihmën dhe përkrahjen e ambasadoreve të vendeve islame, të cilët duhej të bënin projektin e parë për Xhaminë e Madhe në Romë, e cila filloi nga viti 1974 dhe u hap në vitin 1995.

C.C.I.I. që nga viti 1974 ka qenë e vetmja organizatë islame italiane me personalitet juridik. Kjo shoqatë udhëheq Xhaminë e Madhe në Romë, e cila financohet nga vende arabe-islame, përgjithësisht nga Arabia Saudite dhe Maroku, ndërsa Egjipti bën përzgjedhjen e imamit.

Unioni i Komunitetit Mysliman në Itali (U.C.O.I.I.) është themeluar në vitin 1990. U.C.O.I.I. është organizata e parë islame për nga madhësia dhe shtrirja e saj, e cila ka bashkuar dhe ka nën udhëheqje 163 mesxhide në gjithë Italinë. Në statutin e saj thuhet se U.C.O.I.I. synon realizimin e Marrëveshjes nga Art. 8, për t’i garantuar komunitetit islam në Itali praktikimin e adhurimeve në mënyrën sa më të mirë.

Për shkak të mungesës së një marrëveshjeje me shtetin italian, ajo është krijuar ligjërisht si një shoqatë, edhe pse objektivat dhe aktivitetet e U.C.O.I.I. pasqyrojnë qartë natyrën e një organi kulti.[vii]

Bashkësia Fetare Islame Italiane (COREIS) rrënjët i ka nga vitet 90-të. Qendra kryesore e saj është në Milano. Anëtaret e saj janë në gjashtë rajone të Italisë.

Unioni Mysliman në Itali (UMI) është themeluar në vitin 2008 dhe ka bashkuar afërsisht 50 shoqata marokene në gjithë Italinë.

Rinia Islame në Itali (GMI) është themeluar në vitin 2001, si përgjigje e fortë dhe pozitive e 11 Shtatorit. Në Shoqatë aderojnë formalisht mbi 1.000 të rinj, pa llogaritur edhe shumë simpatizantë të tjerë. Ajo ka një numër të madh aktivitetesh, përgjithësisht fetare. Koordinon 16 zyra dhe 14 të tjera janë në proces bashkimi.

Shoqata Islame Italiane e Imamëve dhe e Udhërrëfyesve Fetarë lindi në vitin 2012, me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale dhe formimit dhe të udhërrëfyesve (hoxhallarëve) të fesë, që do të operonin në vend.

Deri më sot janë mbledhur një numër emrash dhe informacionesh për 255 shoqata islame që operojnë në të gjithë territorin italian - 160 operojnë në Italinë veriore, 5 prej tyre dëshirojnë të veprojnë në nivel kombëtar në tërë territorin italian, 44 në Italinë qendrore, 44 në Italinë jugore.[viii]

UNIONI I SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË ITALI (U.A.M.I.)

U.A.M.I. fillet e saj i ka nga një grup studentësh shqiptarë në Itali, të cilët emigruan pas viteve 2000 për të studiuar në Itali. Edhe pse larg atdheut, ata dëshironin të ruanin besimin dhe kulturën e tyre. Ky vullnet dhe kjo dëshirë bëri lidhshmërinë dhe afrimin e studentëve shqiptarë në Itali. Kështu, ata filluan të njiheshin edhe më shumë ndërmjet tyre dhe kjo u bë shtytës kryesor për themelimin e U.A.M.I. Meqë si studentë ishin edhe më të lirë se krahu punëtor, ata u bënë iniciuesit kryesorë të aktivitetit fetar dhe kulturor të shqiptarëve myslimanë në Itali, kështu që në vitin 2008 u bë takimi i parë vjetor në qytetin e Udines, në të cilin takim morën pjesë mbi 300 persona, duke mos munguar edhe mysafirë të ftuar, ligjërues, nga Italia dhe nga trojet shqiptare si: Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, ndërsa një vit më vonë erdhi edhe themelimi i Shoqatës.[ix]

Nga Takimi vjetor i UAMI-t. (FotoArkiv)

Unioni i Shqiptarëve Myslimanë në Itali është themeluar në mars të vitit 2009, nga shoqata dhe qytetarë shqiptarë me vendbanim në Itali, përkatësisht shqiptarë nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria. Për herë të parë komuniteti ynë është riparaqitur në nivel nacional në mënyrë perfekte, mbi bazë të normave ligjore të shtetit italian.

Unioni ka prezantuesit e vet në 25 qytete të ndryshme në shtetin italian. Gjithashtu, nën udhëheqjen e saj janë gjashtë shoqata dhe 3 qendra kulturore islame.[x]

Si çdo shoqatë, edhe U.A.M.I. ka organizimin dhe aktivitetet e saj. Ajo organizon konferenca dhe seminare mbi temat e dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor. Organizon kurse trajnimi në çështje kulturore, fetare, gjuhësore, ligjore dhe sociale. Organizon ngjarje kulturore, rekreative, sportive, artistike dhe turistike. Merret me shkrimin, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të shtypura dhe audiovizive. Ofron shërbime informacioni, udhëzime tekniko-ligjore, ose administrative, për komunitetet dhe shoqatat shqiptare në Itali, si dhe për emigrantët në përgjithësi. Përgatit dhe zbaton projekte solidariteti shoqëror dhe ndërkombëtar në favor të popullatave dhe komuniteteve në nevojë në Itali dhe jashtë saj. Bashkëpunon me shoqatat dhe organizatat tjera për qëllime dobiprurëse dhe të solidaritetit social. Bashkëpunon me organe të tjera, publike dhe private, me qëllim të forcimit të marrëdhënieve ekonomike midis Ballkanit dhe botës prodhuese italiane si dhe integrimit të Shqipërisë dhe shteteve të tjera të Ballkanit në Bashkimin Evropian.[xi]

Unioni i Shqiptarëve Myslimanë në Itali në planprogramin e vet ka edhe takimin vjetor. Takimi treditor i UAMI-it është një event ku marrin pjesë rreth 300 vetë dhe ftohen ligjërues nga Shqipëria, trevat e Shqipërisë dhe nga Italia. Përveç ligjëratave fetare dhe kulturore, takimi përfshin edhe shumë aktivitete të tjera, si turne në mini-futboll, aktivitete enkas për femrat, program zbavitës dhe kulturor për fëmijët, panair, workshope, shëtitje turistike të organizuara në zonë, hedh një short për shkuarjen falas në Umre etj.[xii]

Gjatë Takimit vjetor të UAMI-t më 24-25 janar 2015, në Salsomaggiore Terme-PR, ishin mbledhur shqiptarë nga e gjithë Italia, shumica e tyre ishin nga Shqipëria. Kishte edhe nga Kosova dhe nga Maqedonia. Ata kishin ardhur me familje, për t’i kaluar pushimet që kishin për hir të festës së Pashkëve dhe në të njëjtën kohë kishin organizuar një seminar, në të cilin kishte ligjërata, programe të ndryshme sportive, takime etj.

Vërtet, një organizim i mrekullueshëm nga vëllezërit e Shqipërisë, të cilët meritojnë një falënderim të veçantë që janë bërë shkak për të bashkuar gjithë atë rini dhe ato familje për të kaluar tri ditë bashkë, për t’u çmallur, për t’i qarë hallet se bashku, për të diskutuar e debatuar për tema më të ndryshme që i interesojnë mërgatës sonë.[1]

MEJTEPI I UNIONIT TË SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË ITALI

Prej aktiviteteve më të rëndësishme, por edhe më të suksesshme të imamëve nëpër xhamitë shqiptare në Itali, është mësimbesimi. Zhvillimi i projekteve edukative ka dimensionin kombëtar e fetar, ku fëmijët mësojnë edukatën islame, por edhe atë kombëtare, shqiptare. Datat e aktiviteteve apo kurorëzimit të sukseseve me nxënësit nëpër Unione apo Xhami janë të rëndësishme dhe përcillen me vëmendje nga prindërit, nga xhemati, por dhe mysafirë të ftuar nga vendlindja.

Më 8 shkurt të vitit 2015 UAMI filloi projektin “Mejtepi që na bashkon”, në gjashtë qytete të Italisë, me një numër total prej 94 nxënësish të moshave 9 deri në 13 vjeç. Projekti synon t’u ofrojë fëmijëve, imamëve dhe prindërve një metodë të re për mësimbesimin: “Ndriçimi i Jetës”, metodë kjo bashkëkohore, kualitative dhe efikase. Aplikimi i metodës pa-

Moment gjatë dhënies së medaljeve në Olimpiadën vjetore UAMI 2015. (FotoArkiv)

ralelisht, në nivel nacional, ka si objektiv njohjen dhe vëllazërimin e fëmijëve si në një shkollë të vetme. Metoda përbëhet nga nëntë libra, të cilët kryhen në një periudhë katërvjeçare.

Standardi pedagogjik i Metodës është studiuar mirë si në përmbajtje, ashtu dhe në ndarjen e lëndëve në të nëntë librat. UAMI vendos edhe planprogramin e mësuesit, ku përcakton ndarjen e lëndës dhe afatet kohore. Secila xhami do të ecë paralelisht sipas planit mësimor.

Metoda në programin e saj gjithëpërfshirës ka paraparë librat, të cilët në brendësi kanë të gjitha lëndët dhe temat bazë që nevojiten për formimin e myslimanit, si: Kuranin, beismin, fik'hun, moralin, hadithet e zgjedhura, historinë e Pejgamberit (s.a.w.s.), texhvidin, historinë e pejgamberëve dhe të njerëzve të devotshëm, si dhe pjesët artistike: poezi, ngjyrosje, pjesë teatrale etj.

Garimi si motivacion për të gjithë po ashtu është pjesë e Programit. Nxënësit e të gjitha xhamive marrin pjesë në një konkurs vjetor, i cili do të shoqërohet me aktivitete sportive dhe argëtuese. Fituesit do të shpërblehen me dhurata, për të nxitur si fëmijët, ashtu edhe prindërit dhe mësuesit që të garojnë për rezultate sa më të mira. Gjatë aktiviteteve si: konkursi vjetor, pikniku apo turneu i futbollit, fëmijët do të kenë mundësinë të njihen nga afër me njëri-tjetrin, të krijojnë shoqëri dhe mbi të gjitha do të kuptojnë se ata kanë shumë vëllezër që e mësojnë fenë si ata.[xiii]

Më 7 qershor 2015 u mbajt Olimpiada e parë, cila e mbylli takimin dyditor në Cervia (Ravenna), ku 55 fëmijë nga gjashtë qytete të Italisë zhvilluan olimpiadën e parë të mësimbesimit, pjesë e projektit *Mejtepi UAMI*. Ishin dy ditë intensive plot gjallëri dhe aktivitete. Fëmijët zbukuruan çdo moment me entuziazmin e tyre. Zoti i shpërbleftë me të mira mësuesit që kanë punuar me shumë zell në këto 5 muaj, qëkur nisi Projekti: Zejnullah Sadiku, Shengjile Sadiku, Ylli Kaiku, Petrit Leti, Velian Sina, Zamir Xhatufa, Roland Ibrahimi, Eris Pirra dhe Anita Braka. Falënderojmë gjithashtu dhe lutemi për të gjithë vëllezërit dhe motrat që kanë punuar për realizimin e këtij aktiviteti. Xhamia fituese për këtë vit u shpall ajo e Grossetos.[xiv]

(Teksti që po botojmë këtu në vazhdime është punim diplome, FSI, Prishtinë, 2021, mentor dr. asoc. Fahrush Rexhepi)

.....

[i] Anita Braka, https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=5286

[ii] Fabrizio Ciocca, Musulmani in Italia: una presenza stabile e sempre più italiana 14 Maggio 2019. https://www.lenius.it/musulmani-in-italia/2/ per numrin e muslimaneve lexo edhe Giovanni Brambilla Le associazioni islamiche in Italia Paper ISMU ottombre 2020 p. 2

[iii] Diaspora e Shqipërisë në shifra INSTAT 2020, fq. 10

[iv] https://portalb.mk/230478-studim-shqiptaret-e-italise-komuniteti-i-dyte-me-i-madh-musliman-pas-marokeneve/

[v] https://shqiptari.net/censusi-i-popullsise-ne-itali-zbulohen-te-dhenat-e-fundit-per-shqiptaret-ne-itali/

[vi] Ferrari Alessandro Diritto, *Immigrazione e Cittadinanza*, fasc. n. 3/2018. Rivista quadrimestrale Pg 101, Cfr. M. Bombardieri, Mappatura dell'associazionismo islamico in Italia, in A. Angelucci, M. Bombardieri, D. Tacchini, pag 11-34.

[vii] Nader Akkad Phd Raporto UCCOII sulla presenca dei musulmani in Italia 25 Ottombre 2017 https://ucoii.org/la-storia/

[viii] Antonio Angelucci, Maria Bombardieri e Davide Tacchini Islam e Integracuone in Italia 2014 Cicero Venezi pag 11-34, lexo edhe Giovanni Brambilla Le associazioni islamiche in Italia Paper ISMU ottombre 2020/. pag 8

[ix] Altin Braka, Kryetar i U.A.M.I,. Intervistë e bërë në zoom me 4 mars 2021

[x] Antonio Angelucci, Maria Bombardieri e Davide Tacchini Islam e Integracuone in Italia 2014 Cicero Venezi. Shih dhe Giovanni Brambilla Le associazioni islamiche in Italia ottombre 2020/.

[xi] http://uamionline.it/associazioni

[xii] http://uamionline.it/takimi-xii-vjetor-uami/

[xiii] http://uamionline.it/mektebi-qe-na-bashkon-uami-nis-projektin-e-mesim-besimit-per-femijet-nga-9-13-vjec

[xiv] https://m.facebook.com/uamiassociazione/photos/a.663737317093343.1073741844.413972428736501/663748963758845/?type=1&source=57&refid=52&ref=m_notif&notif_t=like&__tn__=

http://uamionline.it/1462/

[1] Dr. Shefqet Krasniqi, *Qëndrimi në kohë II*, Prishtinë 2012, fq. 80 .

DHJETË IMAMËT DHE TRANSMETIMET QË ATA KANË BËRË

Shkruan: Hasime Salihu

Siç kemi përmendur tashmë, dhjetë dijetarë të kirâeteve janë bazat e kësaj shkence. Megjithëse në fillimet e zhvillimit të saj përmendeshin më tepër përfaqësues, me kalimin e kohës, duke bërë studime më të thella, të gjitha kirâetet u vlerësuan në bazë të kritereve të lartpërmendura dhe, në fund, si kirâete të besueshme u vlerësuan 10 imamët e mëposhtëm: Imâm Nâfi: Ebû Abdirrahmân Nâfi b. Ebî Nuajm el-Lejthî (v. 169/785) nga Medina. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Kâlûn (v. 220/835) dhe Uersh (v. 197/812); Imâm Ibn Kethîr: Abdullah b. Kethîr el-Mekkî (120/738) nga Meka. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: el-Bezzî (v. 250/864) dhe Kunbul (v. 291/903); Imâm Ebû Amr: Imâm Ebû Amr b. el-A'lâ el-Mâzinî (v. 154/770) nga Basra. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: ed-Dûrî (v. 240/854) dhe es-Sûsî (v. 261/874); Imâm Ibn Âmir: Abdullah b. Âmir el-Jahsûbî (v. 118/736) nga Shâmi (Damasku). Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Hishâm (v. 245/859) dhe Ibn Dhekuân (v. 242/856); Imâm Âsim: Ebû Bekr Âsim b. Ebi'n-Nexhûd (v. 128/745) nga Kûfa. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Ebû Bekr Shu'be (v. 190/805) dhe Hafs (v. 180/796). Duke qenë se është imami ynë në lexim, do të paraqesim disa informacione rreth tij dhe Hafsit.

DISA TË DHËNA PËR IMAM ASIMIN DHE HAFSIN

Emri i plotë i Imam Asimit është Ebu Bekr Asim b. Behdele b. Ebin Nexhud el'Kufi. Është i pesti në radhën e imamëve të kiraeteve.

Imam Asimi është i lindur në Kufë në vitin 45 H (665 M). Të gjithë jetën e ka kaluar në Kufë dhe në vitin 127 ose 128 H (744 ose 745 M), në moshën 80 e ca vjeçare, është ndarë nga kjo botë. Numërohet ndër dijetarët më të mëdhenj të tabiinëve.

Behdele është emri i nënës së tij. Sa për emrin e të atit, ka një transmetim të dyshimtë, sipas të cilit emri i babait është Abdullah.

Imam Asimi e ka mësuar prej Ebu Abdirrahman es-Sulemî kiraetin e hazreti Ali b. Ebi Tâlib (radijallahu anh). Ebu Abdirrahman es-Sulemî e ka mësuar Kuranin edhe nga Abdullah b. Mesudi, Ubej b. Ka'bi, Zejd b. Thabiti dhe Osmani (radijallahu anhum). Kuranin e ka lexuar 13 herë përpara Zejdit, i cili ka qenë kryetar i komisionit, i cili bëri për herë të parë në histori mbledhjen e Kuranit në periudhën e Ebu Bekrit (radijallahu anh) dhe në krye të komisionit të dytë që bëri shumëzimin e Kuranit në periudhën e Osmanit (radijallahu anh).

Imam Asimi ka qenë kryemësues i Kuranit në Kufë pas es-Sulemiut dhe në mësimet e tij kanë marrë pjesë edhe dijetarë të mëdhenj si: Ebu Hanife, Sufjan eth'Theuri, A'mesh dhe Halil b. Ahmed.

Dy nxënësit e tij më të mëdhenj janë Hafs b. Sulejman dhe Ebu Bekr Shu'be. Imam Asimi kiraetin e Aliut ia ka mësuar Hafsit, kurse kiraetin e Ibn Mesudit ia ka mësuar Shu'bes.

Imam Asimi kishte një zë të jashtëzakonshëm dhe një lexim unik. Gjuhën arabe e dinte më së miri dhe kishte një të folur shumë ndikuese. Përveç këtyre, ai kishte një moral të mirë, ishte modest dhe me devotshmërinë e tij kishte fituar zemrën e të gjithëve.

Shu'be na e transmeton kështu bukurinë e zërit të mësuesit të tij: "Nuk kam parë asnjë njeri që lexon më bukur se Imam Asimi. Kur ia dëgjoje zërin, të dukej sikur kishte zile në fytin e tij."

Ky personalitet i nderuar merrej me tregtinë e grurit. Me këtë punë ai siguronte të ardhurat e tij ekonomike. Në fund të jetës ka humbur edhe shikimin, por mësimdhënia e tij ka vazhduar edhe pas kësaj fatkeqësie.

Kiraeti i Imam Asimit ishte i thjeshtë sidomos për joarabët, për shkak se nuk përmban veçori të rënda si *taklil, imale, ihtilas* apo *tes'hil*. Për këtë arsye transmetimi i Hafsit është parapëlqyer nga shumica e vendeve islame.

Imam Asimi, i cili është argument në kiraet, ka transmetuar gjithashtu edhe hadithe si një person i sigurt (thika).

Hafs b. Sulejmân: Imam Asimi e ka thjeshtër (- djalë i gjetur, nga martesa tjetër) Hafs b. Sulejmanin. Emri i tij i plotë është Ebû Omer Hafs b. Sulejmân b. Mugîre el-Esedî. Ai ka lindur në vitin 90 H (709 sipas kalendarit diellor) në zonën e Qerbelasë, afër Kufës. Është i njohur me nofkat "Hufejs", "Ebû Dâvûd" dhe "Bezzâz".

Siç thamë më sipër, Hafsi ka mësuar kirâetin e Hz. Aliut (radijallahu anh). Senedi (zinxhiri i transmetimit) i tij është kështu: Hafs b. Sulejman → Asim b. Behdele → Ebu Abdirrahman es-Sulemi → Ali b. Ebi Talib (radijallahu anh) → Hz. Muhammed (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Midis kiraetit të Hafsit dhe atij të Shubes ka 520 dallime. Kur Hafsi e ka pyetur mësuesin e tij për shkakun e këtyre dallimeve, Imam Asimi i është përgjigjur kështu: "Ty të kam mësuar çfarë më ka transmetuar Ebu Abdirrahman es-Sulemiu, kurse Shu'bes atë që më ka transmetuar Zir b. Hubejshi."

Hafsi ka udhëtuar në Bagdad dhe më pas në Mekë, ku ka bërë mësimdhënien e kiraetit të Imam Asimit. Edhe Hafsi, si mësuesi i tij, ka transmetuar hadithe të ndryshme që ndodhen në veprat *Sunen* të Tirmidhiut dhe Ibn Maxhes.

Data e vdekjes së Hafsit është e dyshimtë midis vitit 180 dhe 190 H. Ibn el-Xhezeri ka përzgjedhur datën 180 H (796 e. s.).

Pesë dijetarët tjerë të kirâeteve janë: **Hamza:** Ebû Ammâra Hamza b. Habîb

ez-Zejjât (v. 156/773) nga Kûfa. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Halef (v. 229/843) dhe Hal'lâd (v. 220/835); **Imâm el-Kisâî:** Ebu'l-Hasen Ali b. Hamza el-Kisâî (v. 189/805) nga Kûfa. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: ed-Dûrî (v. 240/854) dhe Ebu'l-Hârith (v. 240/854); **Ebû Xha'fer:** Jezîd b. Ka'ka' el-Mahzûmî (v. 130/748) nga Medîna. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Isa b. Uerdân (v. 160/776) dhe Sulejmân b. Xhemmâz (v. 170/786); **Imâm Ja'kûb:** Ja'kûb b. Is'hâk (v. 205/820) nga Basra. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Rauh b. Abdilmu'min (v. 234/848) dhe Ruvejs Muhammed b. el-Muteuekkil (v. 238/852); **Imâm Halef:** Halef b. Hishâm (v. 229/843) nga Kûfa. Prej tij kanë transmetuar dy râuîtë: Is'hâk b. Ibrâhîm (v. 286/899) dhe Idrîs b. Abdilkerîm (v. 292/904).

PËRFUNDIMI

Ashtu siç thotë edhe ez-Zerkeshî, **Kurani** dhe **kirâetet** janë gjëra të ndryshme, të cilat nuk duhen ngatërruar me njëratjetrën. Kurani është fjala e dërguar pejgamberit Muhamed (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), si një shpallje e mrekulli hyjnore (muxhize), kurse kirâetet janë mënyrat se si kjo fjalë lexohet me *med*, *kasr*, *imâle*, *idgâm* etj., të cilat janë transmetuar në gradën *muteuâtir* prej sahabëve.

Kjo fushë është edhe më e sulmuara nga orientalistët, të cilët në çdo mënyrë mundohen të sulmojnë autenticitetin e Kuranit famëlartë. Kjo është edhe një nga arsyet që kirâetet duhen studiuar mirë dhe me kujdes, sepse në çdo moment njeriu mund të bie në grackën e këtyre sulmeve, gjë që për fat të keq ka ndodhur edhe më parë. Prandaj, është një temë që kërkon vëmendje, maturi e kujdes.

Gjatë gjithë shkrimit u munduam të paraqesim një panoramë të përgjithshme, në mënyrë që të japim një ide në lidhje me çështjen e kirâeteve. Por, jemi të sigurt që një artikull nuk mund të jetë i mjaftueshëm për këtë temë. Për këtë arsye, këshillojmë që lexuesit të shfletojnë edhe libra të tjerë dhe urojmë që kërkimet në këtë temë të vazhdojnë edhe më tej.

(Fusnotat janë hequr nga Redaksia gjatë përpunimit të tekstit)

LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

1. Ahmeti, Sherif. *Kur`an-i, përkthim me komentim në gjuhën shqipe*.
2. Muslimi, *Sahihul Muslim*, Liban.
3. Iljazi, Ali. *Kur`ani famëmadh nga këndvështrimi shkencor*, Gjakovë.
4. Fahd ibn Abd al Rahman ibn Sulejman, *Dirasat fi Ulumul Kur`An*, Maktabah at-Tavbah Rumi.
5. Muhamed ibn Umer ibn Salih Bazemuli, *El Qirat ve uthuruha fi tefsiri vel ahkam*, Meka.
6. Latiq, Xhemal, "Zbornik rada", 2005, Sarajevë.
7. Karaj, Elton. "Shkenca e kiraeteve", në "Zani i Naltë", Tiranë.
8. Silajxhiq, Qamil dhe Trebinjac, Ibrahim. *Tedzvid, pravilla ucenje Kur`ana*, Sarajevë, 2003.
9. Ebû Uthmân Saîd b. Mansûr b. Shu'be el-Hurasanî, *Sunen*, Dâru'l-Asîmî.
10. Shoshiq, Xhevat. "Dialektne razlike medzu Kiraetima", në "Zbornik rada".
11. Zurkânî, "Menâhilu'l 'Irfân Fî 'Ulûmi'l Kur'ân", Ibnu'l Xhezerî, Bejrut.

Medreseja në Konicë, Çamëri, e ndërtuar në vitin 1870 (foto nga Arben Llalla, 2022; në bashkëpunim).

PRANIMET, ME KUSHTE TË QARTA

Disa dijetarë eminentë të shkencave islame qartë e kanë bërë të ditur se lejohen veprimet me hadithin daif në veprat e mira, në asketizëm, në devotshmëri, në çështjet që ngjallin dëshirën për veprim dhe që tërheqin frikë, në inkurajim dhe nxitje për vepra të vlefshme.

Shkruan: Melek Bislimi

Imam Ebu Abdull Hakim الامام أبو عبدالله الحاكم (v. 405 H), autor i veprës "El-mustedrek المستدرك", në kapitullin "El-edeb" (Edukata) transmeton një *hadith merfu* nga Ibni Abbasi (r. a.), se Pejgamberi (alejhi-selam) ka thënë: "*Vërtet, çdo send ka ndershmëri* (fisnikëri) – لكل شيء شرفأن ". Këtë hadith e ka transmetuar përmes rrugës së Muhamed ibni Muavijete, nga Musadif ibni Zijad, nga Muhamed ibni Ka'b Kurdhij. Pastaj, këtij transmetimi (hakimi) ia ka bashkëngjitur një hadith tjetër të gjatë, i cili transmetohet nga Ebu Mikdad Hisham ibni Zijad, nga Kuredhij dhe për këtë hadith ai ka thënë se është "hadith sahih – حديث صحيح ", të cilin edhe Hisham ibni Zijad Nasrij edhe Musadif ibni Zijad Medini e transmetojnë nga Muhamed ibni Ka'b Kuredhij, Allahu e dinë më së miri, por unë nuk kam dëshiruar ta kapërcej këtë temë pa e përmendur (transmetimin e parë), sepse ai ka përfshirë edukata (etika) të shumta.

Në lidhje me Musadif ibni Zijadin, Akili është shprehur se ai është metruk (i lënë). Kurse Hakim Nisaburi në veprën e tij "El-mizan" ka transmetuar se Imam Ibni Meini, Dare Kutni e të

tjerë se Muhamed ibni Muavijeten e kanë konsideruar si gënjeshtar.

Por, Hakimi është shprehur se, megjithatë, nuk kam dëshiruar ta kapërcej këtë temë pa e përmendur[1].

16. Ima Ebu Muhamed Ibni Hazm الامام أبو محمد بن حزم (v. 456 H), i cili në veprën e tij "El-muhal-la المحلى" pasi përmend hadithin në lidhje me lutjen (duan) e kunutit, thotë: Kunuti është përmendje e Allahut dhe lutje; ne këtë e duam (e dëshirojmë), kurse ky tekst (hadith) "All-llahume ihdini fimen hedejte ..." edhe pse nuk është prej atyre (teksteve) që mund të argumentohemi me këtë, por ne, në lidhje me këtë nga i dërguari i Allahut (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) nuk kemi gjetur ndonjë tekst tjetër. Ndërsa Imam Ahmed ibni Hanbeli (Allahu e pastë mëshiruar) ka thënë se hadithi i dobët te ne është më i dashur sesa mendimi. (Pastaj Ali Ibni Hazmi shprehet se) Edhe ne jemi të këtij mendimi (edhe ne themi këtë).[2]

JO TRILLIMEVE DHE GËNJESHTRAVE

17. Imam Ebu Bekr Bejhekijju الامام أبو بكر البيهقي (v. 458 H), në veprën e tij "Shuabul imani – الإيمانشعب " thotë: Vërtet, dijetarët e hadithit kanë toleruar në pranimin (e hadithit), i cili është transmetuar në lidhje me lutjet (duatë) dhe veprat e mira, derisa nuk është prej atyre që dihet se ata kanë trilluar hadithe (hadith mevdu), apo kanë gënjyer.

18. Imam Ebu Bekr Hatib الامام أبو بكر الخطيب (v. 463 h), i cili në veprën e tij "El-kifaje- الكفاية", në lidhje me këtë temë, respektivsht se nga cilët transmetues duhet pranuar hadithin, ai këtë temë e kishte radhitur në kapituj: në kapitullin e parë shënon 'me temën', kapitulli në lidhje me atë që duhet zgjedhur (pranuar) nga ata që janë të besueshëm dhe të urryerit të përcjelljes dhe transmetimit nga të dobëtit. Pastaj shënon se duhet transmetuar nga të përpikëtit dhe të besueshmit. Pastaj, në lidhje me këtë ai thotë: Kapitulli në lidhje me rigorozitetin dhe rreptësinë në hadithet e dispozitave dhe lejimin (tolerimin) në (hadithet) e veprave të mira.

Pastaj thotë: Sa u përket haditheve që ndërlidhen me ngjalljen e dëshirës për vepra të mira, (hadithet në lidhje) me kështellat dhe ngjashëm me ato, vërtet sipas të gjithë dijetarëve (ar. meshajih) lejohet që ato të shkruhen.

Vlen të ndalemi dhe t'i kushtojmë vëmendje shprehjes së tij "vërtet sipas të gjithë dijetarëve", ngase ky nuk bën dallimin mes kategorive të transmetuesve, që nënkuptohet se sipas tij të gjithë transmetuesit e dobët janë njësoj. Dhe, praktikisht qëndrimin e tij e shfaq në veprat e tij "El-xhami الجامع", "Adab el-fekih vel mutefek-kih – الفقيه و المتفقهآداب"[3].

19. Imam Ebu Omer ibni Abdulberri مام أبو عمر بن عبدالبرالا(v. 463 H), në hyrje të veprës së tij "Et-temhid التمهيد" thotë: Hadithi i dobët nuk hidhet (nuk refuzohet, nuk mënjanohet), edhe nëse nuk argumentohet me të (edhe nëse nuk merret për argument), sepse ndoshta ndonjë hadith me sened të dobët ka kuptim të vlefshëm (sahih).[4]

Në veprën e tij " بيان العلمجامع " transmeton nga Ebu Mua'mer Abbad ibni Abdusamed hadithin merfu nga Enesi (r. a.) " من أدى الفريضة، و علَّم الناس الخير – *kush e kryen obligimin* (farzin) *dhe njerzëve ua mëson të mirën* (të dobishmen, hairin) .....", pastaj në lidhje me Ebu Mua'merin ka thënë: Ai është metruk te dijetarët e hadithit, ndërsa të gjithë dijetarët tolerojnë në veprat e mira (ar. fedaili e'mali), kështu që ata transmetojnë nga të gjithë, porse ata janë rigorozë në dispozita.

20. Imam Ebu Bekr ibni el-Arabij مام أبو بكر بن العربيالا (v.543 H), në veprën e tij "Aridatul ehvedhij الاحوذيعارضة" thotë: Ajo që është në brendinë time (sipas mendimit tim), Allahu e di më së miri, është atë që kemi transmetuar nga Imam Ahmedi, i cili lejon hadithin e dobët (daif) në devotshmëri (çiltëri).

Imam Tirmidhiu në *Sunenin* e tij transmeton hadithin: *"Atij që teshtin, i kthehet tri herë; nëse e shton më shumë* (nëse teshtin më tepër se tri herë), *atëherë, nëse dëshiron ia kthen, e nëse dëshiron nuk ia kthen."*[5]

Tirmidhiu këtë hadith e konsideron hadith të dobët (daif), sepse ky hadith është hadith garib dhe ka sened mexhhul (transmetues të panjohur). Mirëpo, Ibni el-Arabij në lidhje me këtë hadith thotë: Ky hadith, edhe nëse është mexhhul (i panjohur), porse me të është mustehab (e preferuar) të veprohet, sepse është lutje e mirë (e hairit), në lidhje me atë që është në kuvend dhe afrim ndaj tij.[6]

Madje, Ibni Haxher Askalani në veprën e tij "Fet'hul bari"[7] ia ka përshkruar Ibni el-Arabiut të ketë thënë se më prioritare është të veprohet me të – فالاولى العمل به.

21. Imam Ebu Amr ibni Salah أبو الامام عمرو بن الصلاح (v. 643 H), në veprën e tij të njohur në shkencën e hadithit "Ulumul hadith – ابن الصلاح في مقدمة علوم الحديث " thotë: Lejohet te dijetarët e hadithit dhe te të tjerët tolerimi në senedet (zinxhirët) dhe transmetimi i të gjitha llojeve të haditheve të dobëta, përveç haditheve mevdua (të trilluara, të sajuara, d.m.th. nuk lejohet), (lejohet transmetimi) pa i kushtuar kujdes sqarimit të dobësive të atyre (haditheve), përveç atyre haditheve që ndërlidhen dhe kanë të bëjnë me cilësitë e Allahut të Lartësuar, dispozitave të sheriatit që kanë të bëjnë me hallallin dhe haramin dhe ngjashëm me ato (duhet sqaruar dobësinë e tyre). (lejohet transmetimi i haditheve të dobëta) Në çështjet që kanë të bëjnë me kështellat (ar. vaidh), tregime, vepra të mira, të gjitha artet (llojet) që ngjallin dëshirën për veprim (ar. tergib) dhe që tërheqin frikësim (ar. terhib) dhe të gjitha sendet që nuk ndërlidhen me dispozitat dhe akiden (besimin).

Prej atyre që është transmetuar se ata janë të mendimit për këtë tolerim në lidhje me ato që i përmendëm më parë, janë Abdurrahman ibni Mehdi dhe Ahmed ibni Hanbeli[8].

22. Imam Abduladhim Mundhirijju الامام عبدالعظيم المنذري (v. 656 H), autori i veprës "Tergib ve terhib الترغيب و الترهيب". Mundhirijju qëndrimin e tij ndaj hadithit të dobët e bën të qartë në hyrjen e veprës së tij *Tergib ve terhib*, ku e tregon metodologjinë dhe mënyrën e shkrimit të haditheve në këtë vepër; tregon se aty gjenden hadithe sahih (autentike), hasen dhe të dobëta, porse ai shënon se kush është transmetuesi i hadithit (Buhariu, Muslimi etj.) dhe jep shenjë se çfarë hadithi është - është sahih, hasen apo daif. Prandaj, kjo vepër e bën të qartë se Mundhiriu e pranon hadithin daif[9].

23. Imam Neveviu الامام النووي (v. 676 H), qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje e bën të qartë në hyrje të veprës së tij "Edhkar الاذكار", ku thotë: "Dijetarët e hadithit, fukahatë (juristët) dhe të tjerët thonë se lejohet dhe është mustehab (e preferuar, e pëlqyer) të vepruarit me hadithin daif në veprat e mira, ato që ngjallin dëshirën për veprim (ar. tergib) dhe që tërheqin frikësim (ar. terhib), përderisa ato (hadithe) nuk janë të menduara (të trilluara, të sajuara). Sa u përket dispozitave, siç janë hallalli dhe harami, shitblerja, kurorëzimi (niqahu), shkurorëzimi dhe ngjashëm me këto, në dispozitat e tilla nuk veprohet përveç me hadith sahih (të saktë), apo hadith hasen, përveç nëse hadithi i tillë është si masë preventive dhe rezervë (ar. ihtjat), si për shembull nëse transmetohet ndonjë hadith daif, i cili bën të urryer disa shitblerje apo disa kurorëzime (niqahe)."[10]

Qëndrimin e tij Imam Neveviu e shpreh edhe në shumë vepra të tij, si për shembull në "Erbeiine nevevijje الاربعين النووية" në hyrje të kësaj vepre, respektivisht në faqen 3. Po ashtu në veprën e tij "Terehhus bilkijami الترخص بالقيام لذي الفضل و المزية من اهل الاسلام", në faqen 45.

23. Imam Ibni Tejmijje الامام إبن تيمية (v. 728 H). Ibni Tejmijje këtë çështje e ka shënuar në dy vende në veprën "Mexhmu-ul fetave الفتاوىمجموع", në vëllimin 1/250 dhe në vëllimin 18/65-68. Po ashtu, këtë çështje e ka theksuar edhe në "Iktida siratul mustekim الصراط المستقيم اقتضاء" në 1/134.

Në vazhdim do të shënojmë qëndrimin e tij ashtu siç e ka shënuar në *Mexhmu-ul fetava*, ku ai thotë: Nuk lejohet që të bazohet në sheriatin (islam) mbi hadithe të dobëta (daif), të cilat nuk janë sahih (të sakëta) e as hasen. Por, Ahmed ibni Hanbeli dhe të tjerët nga dijetarët kanë lejuar që të transmetohet në lidhje me veprat e mira, për të cilat nuk dihet se a janë të vërtetuara dhe nëse nuk dihet se ato janë gënjeshtra.

Për faktin se nëse të vepruarit dihet (kuptohet), se ai është i ligjësuar përmes argumentit legjitim (të sheriatit) dhe në lidhje me vlerat e tij, është transmetuar ndonjë hadith që nuk dihet se (hadithi) është gënjeshtër, lejohet që shpërblimi të jetë i vërtetë (hakk, respektivisht ka shpërblim), porse askush nga dijetarët nuk ka thënë se lejohet që ndonjë send përmes hadithit daif të bëhet vaxhib apo mustehab. Kush thotë kështu, vërtet ai e ka kundërshtuar nonsensin (ar. ixhman).

Po ashtu, nuk lejohet që një send të ndalohet (të bëhet haram) përveç me argument legjitim (të sheriatit), mirëpo nëse dihet (kuptohet) për ndalimin e tij (se një send është i ndaluar) dhe transmetohet ndonjë hadith që kërcënon vepruesin e atij (hadithi), por nuk dihet se ai hadith është gënjeshtër, lejohet që atë (hadith) ta transmetojë. Prandaj, lejohet që të transmetohet në çështjet që ngjallin dëshirën për veprim dhe që tërheqin frikë, përderisa nuk dihet se ai është gënjeshtër.

Ngjashëm me këtë janë edhe Israilijjatet (tregimet në lidhje me Beni Israil), ku lejohet që ndonjë tregim të transmetohet, përderisa nuk dihet se ai (tregim) është gënjeshtër, lejohet që ato (tregime) të transmetohen me qëllim të ngjalljes së dëshirës për veprim dhe tërheqjes frikë, në ato çështje që dihet se Allahu i Lartësuar ka urdhëruar në sheriatin tonë dhe ka ndaluar në sheriatin tonë. Mirëpo, në sheriatin tonë të vërtetojmë thjesht përmes Israilijjateve, të cilat nuk janë vërtetuar, këtë nuk e ka thënë asnjë dijetar, madje as Imam Ahmedi dhe dijetarët tjerë nuk janë bazuar mbi këto tregime në sheriat (për nxerrjen e dispozitave bazuar mbi këto).[11]

Qëndrimin e tij e shënon edhe në pjesën e 18/65-68, nga Mexhmu-ul fetave. Prandaj, dijetarët thonë se edhe Imam Ibni Tejmijje radhitet në mesin e atyre që pranon të vepruarit me hadith daif, përderisa hadithi nuk është mev-duë.[12]

24. Imam Alauddin ibni Turkmani الامام علاءالدين بن التركماني (v. 750 H), i cili në veprën e tij "Muntehab fi ulumil hadith المنتخب في علوم الحديث", vepër kjo e cila është rezyme (shkurtesë) e veprës së Ibni Salahut thotë: Transmetohet (hadithi) daifi (i dobëti) jo mevdu, pa sqarim.[13]

25. Imam Ibni Kajjim Xhevzijje الامام ابن قيم الجوزية (v. 751 h) në veprën "El-vabilus-sajjibi الوابل الصيب" e ka shpjeguar veprën "El-kelumut tajjib الكلم الطيب" të Ibni Tejmijes. Gjatë shpjegimit, nuk refuzoi asnjë nga ato hadithe që i kishte shënuar Ibni Tejmijje. Madje, i ka shpjeguar dhe ndonjëherë edhe ka shtuar. Qëndrimi i tij mund të kuptohet edhe prej veprave të tjera të tij, si për shembull vepra "Err-rruh الروح ", "Hadil ervahi هادي الارواح", "Revdatul muhibbin روضة المحبين".[14]

26. Imam Imadudin ibni Kethir عمادالدين ابن كثيرالامام (v. 774 H), autori i tefsirit Ibni Kethir, i cili në veprën e tij "Ihtisar ulumul hadithi احتصار علوم الحديث" është shprehur ngjashëm sikurse Imam Ibni Salahu. Qëndrimin e tij (të Ibni Salahut) e kemi shënuar pak më parë, respektivisht në nr. rendor 21.

ULJA E SHIKIMIT NDAJ FEMRAVE TË HUAJA

Qëndrimin e tij Ibni Kethiri e vërteton edhe gjatë komentimit të ajetit nr. 30 të sures En-nur, kur flet për të ulurit e shikimit (mosshikimin) ndaj femrave të huaja, ku në lidhje me këtë çështje shënon hadithin që e trans-metojnë Ebu Umamate, Ibni Omeri, Hudhejfeja dhe Aisheja (r. a.). Për këto hadithe ai thotë se në senedet e tyre ka dobësi (da'f), porse në lidhje me ngjalljen e dëshirës (ar. tergib) dhe ngjashëm me atë, tolerohet të veprohet me të.

27. Imam Ibni Rexheb Hanbeli ابن الامام رجب الحنبلي (v. 795 H), në veprën e tij "Sherh ilel tirmidhiu شرح علل الترمذي" kur flet për transmetimin nga transmetuesit e dobët, të cilët janë të akuzuar për gënjeshtër, mos mbamendje dhe neglizhencë. Ndër të tjera ai thotë: Unë më parë kam shënuar qëndrimin e Ibni Ebu Hatimit se lejohet transmetimi i atij që shpesh është neglizhent (i shkujdesur) për ato çështje që nuk janë prej dispozitave, kurse transmetimi i atyre që janë të akuzuar për gënjeshtër, nuk lejohet, përveç me sqarimin dhe tregimin e gjendjes së tij dhe ky mendim është i saktë - Allahu e di më së miri.[15]

28. Imam Zejnuddin Iraki زين الدين الامام العراقي (v. 806 H) në veprën e tij "Sherh elfijjetihi شرح ألفيته" thotë: Sa i përket hadithit jo mevdu, e kanë lejuar tolerimin në zinxhirin (senedin) e tij dhe transmetimin e tij, pa e sqaruar dobësinë e tij, nëse nuk ka të bëjë me dispozitat dhe akiden (besimin), por (hadithi, transmetimi) ka të bëjë me ngjalljen e dëshirës për veprim dhe tërheqjen frikë, si është rasti me kështellat, tregimet, veprat e mira dhe ngjashëm me to.[16]

29. Imam Seraxhuddin Bulkini الامام سراج الدين البُلقيني(v. 805 H), medimi i të cilit përputhet plotësisht me mendimin e Ibni Salahut (të cilin e kemi shënuar pak më parë, respektivisht në nr. rendor 21). Ky imam kur përmend mendimin e Ibni Salahut në lidhje me këtë çështje, ai nuk e komenton me asgjë, që nënkupton se ai ka të njëjtin mendim dhe shënon se Ibni Salahu ia përshkruan këtë qëndrim Imam Ibni Mehdiut dhe Imam Ahmedit, pastaj (Seraxhuddin Bulkini) shton dhe thotë se Hatibi ka shënuar se ky është edhe mendimi i Sufjan ibni Ujejne, Sufjan Thevriut dhe Jahja ibni Muhamedit.[17]

30. Imam Hafidh Nasiruddin Dimeshkijj الامام الحافظ ناصرالدين الدمشقي (v. 841 H), i cili gjatë shpjegimit të veprës së tij "Ukudud dureri عقود الدرر" thotë: Transmetimi i hadithit daif (përveç hadithit mevdu) është i lejuar në veprat e mira, në këshilla dhe ngjashëm me to. Po ashtu është kjo gjendje, ku lejohet të vepruarit me këtë lloj të hadithit sipas xhumhurit (shumicës së dijetarëve).[18]

31. Imam Hafidh ibni Haxher Askalanijju الامام الحافظ ابن حجر العسقلاني(v. 852 H) qëndrimet e veta në lidhje me hadithin daif i ka shënuar në disa vepra, si për shembull në hyrje të veprës e tij "Tebjinul axhebi تبيين العجب " dhe atë që përcjell Imam Sehaviu në fund të veprës së tij "El-kaulul bedi القول البديع", se Ibni Haxheri lejon të vepruarit me hadithin daif.[19]

Qëndrimet e tij mund të hasen edhe nëpër shumë vepra të tij, si për shembull në veprën "El-kaulul musedded fidh-dhebi an musned lilimam Ahamed.[20] القول المسدد في الذب عن المسند للامام أحمد", ku sa për ilustrim mund të shënojmë

qëndrimin e tij në lidhje me hadithin numër 8, në senedin e të cilit është Ebu Ikal أبو عقال, për të cilin vetë Ibni Haxheri në veprën e tij "Et-tekrib" thotë se ai është metruk[21]. Megjithatë, Ibnii Haxheri në lidhje me këtë hadith ka thënë: Ky hadith është në lidhje me veprat e mira dhe nxitje për xhihad për hir të Allahut. Në këtë (hadith) nuk ka diçka që është e pamundshme në sheriat (në kundërshtim me sheriatin) e as në mendje (kundër logjikës). Të gjykosh se është i kotë (i pavlefshëm), thjesht sepse e ka transmetuar Ebu Ikali, kjo nuk mban (nuk është e arsyeshme). Ndërkaq, është njohur metodologjia (mënyra) e Imam Ahmedit në tolerimin e transmetimit të haditheve në lidhje me veprat e mira, por jo në hadithet në lidhje me dispozitat.[22]

32. Imam Kemal ibni Hummam الكمال بن الهمام الامام (v. 861 H) në veprën e tij të njohur "Fet'hul kadir فتح القدير" në fillim të kapitullit në lidhje me faljen e namazit me imam (në temën imamëllëku, ar. Imamete) thotë: Me hadithin e dobët (daif) jo mevdu (i trilluar), veprohet me të në veprat e mira.[23] الضعيف غير الموضوع يُعمل به في فضائل الاعمال.

Po ashtu, qëndrimin e tij e shënon edhe në kapitullin në lidhje me dispozitat për të vdekurit (xhenazen), respektivisht kur flet për bartjen e kufomës (xhenazes), ku ndër tjera ai thotë: Veprat e preferuara (mustahab, sunnetet) vërtetohen me hadith daif, por jo me hadith mevdu.[24]

Nga thënia e parë e tij, respektivisht në veprën e tij *Fet'hul kadir 1/303*, kuptohet se lejohet (ar. xhaiz) të veprohet me hadith daif. Kurse nga thënia e dytë e tij, respektivisht në veprën e tij *Fet'hul kadir 2/95*, kuptohet së është mustehab (sunnet) të veprohet me hadith daif. Në anën tjetër, nga këto thënie të tij kuptohet se ai përveç hadithit mevdu, nuk ka përjashtuar asnjë lloj tjetër të hadithit daif.[25]

33. Imam Shemsuddin Sehaviu شمس الدين السخاوي الامام (v. 902 H) në veprën e vet "Fet'hul mugith المغيثفتح " e bën të qartë qëndrimin e tij se ai ka të njëjtin qëndrim me dijetarët të cilët i shënuam më parë, respektivisht ai e pranon të vepruarit me hadithin daif.[26]

34. Imam Xhelaluddin Sujuti الامام جلال الدين السيوطي (v. 911 H) qëndrimin e bën të qartë në të gjitha veprat e tij, por më së qarti e bën në veprën e njohur "Tedriburr-rravi تدريب الراوي"[27].

35. Imam Muhamed ibni Abdulbaki Zerkani محمد عبدالباقي الزرقانيالامام (v. 1122 H), komentuesi dhe shpjeguesi i "Muvet-ta الموطأ" të Imam Malikut dhe "Mevahib ludnijje المواهب اللدنية" të Imam Shihabuddin Kastalani (v.923 H), i cili në shpjegimin e "Mevahib ludnije" thotë: Është e rëndomtë dhe normale që muhadithinët (dijetarët e hadithit) të jenë tolerantë (në lidhje me hadithet daife), por jo në dispozita dhe akide (besim), përderisa (hadithi) nuk është mevdu.[28]

Këta ishin disa dijetarë eminentë të shkencave islame, të cilët qartë bënë të ditur se lejohen veprimet me hadithin daif në veprat e mira, në asketizëm, në devotshmëri, në çështjet që ngjallin dëshirën për veprim dhe që tërheqin frikë, në inkurajim dhe nxitje për vepra të vlefshme.

Krahas këtyre kolosëve, ka edhe shumë dijetarë të tjerë që janë të këtij mendimi, të cilët qëndrimin e tyre e kanë shënuar nëpër veprat e tyre.

Në literaturën islame gjenden shumë vepra të autorëve të ndryshëm, të cilët kanë shkruar në lidhje me veprat e mira, në asketizëm, në çështjet që ngjallin dëshirën për veprim dhe që tërheqin frikë, në devotshmëri etj., numri i të cilëve është shumë i madh. Dijetarët thonë se ne nuk pretendojmë se të gjithë ata në veprat e tyre kanë transmetuar hadithe të dobëta, por megjithatë në disa prej atyre veprave gjenden edhe hadithe daife.

Në vazhdim do të shënojmë disa vepra, me tema të ndryshme, të cilat përmbajnë hadithe të dobëta, vepra këto të cila i ka shënuar Muhamed Avvame në veprën e tij "Hukmul ameli bil hadithid daifi".[29]

MBI 70 VEPRA PËR ASKETIZMIN, DEVOTSHMËRINË DHE VETVETEN

Veprat që ndërlidhen me asketizmin (zuhdin dhe tesavufin), devotshmërinë dhe llogaritjen e vetvetes (ar. muhasebe), në këtë fushë janë shkruar më shumë se 70 vepra, nga dijetarë të ndryshëm. Ndër dijetarët më të njohur që kanë shkruar në këtë fushë janë:

Ibni Mubareku المباركابن.

Muafi ibni Imran Mevsilij بن عمران الموصليالمعافي .

Veki ibni Xherrah بن الجراحوكيع .

Esed ibni Musa أسد بن موسى .

Ahmed ibni Hanbel أحمد بن حنبل .

Henad ibni Serij بن السريهناد .

Ebu Davud Sixhistani أبو داود السجستاني.

Ebi Hatim Razij أبي حاتم الرازي.

Ibni Ebi Asim Nebil أبي عاصم النبيلإبن.

Bejhekijju البيهقي.

Hatib Bagdadiالخطيب البغدادي.

Ndërkaq, prej dijetarëve që kanë shkruar në fushën e çështjeve etiko-morale (etikës islame, ahlakut), janë;

Ibni Ebu Dun'ja إبن أبي الدنيا.

Ebu Nuajm Esbehani أبو نعيم الاصبهاني.

Ibni Asakir إبن عساكر.

Në lidhje me lutjet (duanë) kanë shkruar shumë dijetarë. Ndër ata janë:

Muhamed ibni Fudajl ibni Gazvan محمد بن فضيل بن غزوان me titull "Ed-dua الدعاء".

Taberaniju الطبراني, me titull "Ed-dua الدعاء".

Ibnii Sunni السنيإبن, me titull "Amelul jevmi vel-lejleti اليوم و الليلةعمل".

Mehamilij محاملي, me titull "Ed-dua الدعاء".

Bejhekiju البيهقي, me titull "Ed-deavat الدعوات.

Në lidhje me vlerat e Kuranit qerim dhe vlerat e leximit të tij, ndër dijetarët më të njohur që kanë shkruar në këtë lëmi janë:

Ebu Ubejd أبو عبيد.

Mustegfirij المستغفري.

Në lidhje me vlerat e dërgimit të salevateve mbi të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.), ndërkaq, ndër dijetarët më të njohur që kanë shkruar në këtë lëmi janë:

El-Kadi Ismail ibni Is'hak Malikij القاضي إسماعيل بن إسحاق المالكي.

Numejri النميري.

Ibni Beshkuval بَشْكُوالإبن .

Dhe, në lidhje me çështjet që ngjallin dëshirën për veprim dhe që tërheqin frikë dhe inkurajim dhe nxitje për vepra të vlefshme. Kjo çështje është shënuar nga shumë autorë nëpër veprat e tyre, por ekzistojnë edhe disa vepra që janë shkruar enkas për këtë çështje, vepra këto të cilat kanë shënuar hadithe sahih, hasen dhe daif. Ndër ato janë:

"Kitab tergib ve terhib الترغيب و الترهيبكتاب " i autorit Ebu Kasim Tejmij أبو القاسم التيمي.

"Kitab tergib ve terhib الترغيب و الترهيبكتاب " i autorit Imam Hafidh Zekijuddin Abduladhim ibni Abdulkavij Mundhirij الامام الحافظ زكي الدين عبدالعظيم بن عبدالقوي المنذري.

"Shu'abul imanشعب الايمان " i autorit Bejhekij للبيهقي.

(Punimi, në disa vazhdime, është temë diplome e autores në FSHI)

---

[1] Po aty, 47.

[2] Po aty, 48.

[3] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 49.

[4] Ibni Abdulber-ri, Ebu Omer Jusuf Ibni Abdullah, *et- temhid lima fi muvatta minel meani vel esanid*, nashir: vezaret evkaf vesh-shunul islamij, Magrib, 1387 H, 1/58 (në hyrjen e kësaj vepre kolosale). Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*,bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 49.

[5] Tirmidhi, *Sunen Tirmidhi*, 5/84, nr. hadithit 2744.

[6] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq, 50.

[7] Ibni Haxher Askalani, *Ahemd Ibni Ali, fet'hul bari sherh sahih buhari*, darul ma'rife, Bejrut, 10/606, nr. hadithit 6222.

[8] Ibni Salah, Shejh Imam Hafidh Myfti TekijuddinEbu Amr Othman Ibni Abdurrahman, *mukadimet Ibni salal fi ulumil hadithi*, mektebetul farabi, Damask, 1404 H – 1984 M, fq, 61.

[9] Imam Mundhirijju, *Tergib ve Terhib*, Dar ihja turathul arabi, Bejrut, 1388 H-1968 M, fq, 1/35-38.

[10] Imam Neveviu, *Edhkar*, 7.

[11] Ibni Tejmijje, Ahmed Ibni Abdulhalim Ibni Abdullah Harrani Dimeshki Hanbeli, *Nashir, vezaret shuun islamije ved da've vel irshad saudite*, mexhmu-ul fetave, 1/250.

[12] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 213.

[13] Po aty, 55.

[14] Po aty, 55.

[15] Ibni Rexheb Hanbeli, Imam Hafidh Abdurrahman ibni Ahmed, *sherh ilel tirmidhi, darul mel-lah*, 1/90. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 57.

[16] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 58.

[17] Po aty, 58.

[18] Po aty, 58.

[19] Po aty, 58.

[20] Ibni Haxher, Ahmed Ibni Ali, *el-kaulul musedded fidh-dhebi an musned lilimam Ahamed*, nashir mektebetu Ibni tejmijje, 1401H, fq, 9. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 59.

[21] Ibni Haxher, Ahmed ibni Ali, *tekribut-te'hdhib*, darul asimeti, 1421 H, fq. 1026, nr. 7386.

[22] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 59.

[23] Kemal ibni Hemmam, Kemaluddin Muhamed Ibni Abdulvahid, *sherh fet'hul kadir*, daru ihjaut turathul arabij, Bejrut, 1/303.

[24] Kemal ibni Hemmam, *fet'hul kadir*, 2/95.

[25] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq, 59.

[26] Imam Sehaviu, Ebu Hajr Muhamed ibni Abdurrahman, *Fet'hul mugith bi sherhi elfijetil hadithi*, mektebetul darul minhaxh, Rijad, 1/147 e më pas.

[27] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq. 60. Për më tepër mund të shfletohet vepra e tij Tedriburr-rravi, kur flet për hadithin daif.

[28] Zerkani, Ebu Abdullah Muhamed ibni Abdulbaki, *sherh el-al-lame zerkani ala mavahib ludnijje bil minehi muhamedije*, darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1/147. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq. 60.

[29] Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tetbiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 H- 2017 M, fq. 60-67.

NJË MBULESË E FORTË AMERIKANE E SIGURISË SI ZGJIDHJE

Zyrtarë të lartë të SHBA-së kanë paralajmëruar për atë që ata e quajnë “rol gjithnjë e më shkatërrues” i Moskës në Ballkan, duke thënë se Rusia po minon demokracinë në rajon.

Shkruan: Dr. Selim Ibraimi

Ballkani Perëndimor historikisht ka zënë një vend të veçantë në politikën e jashtme dhe të sigurisë së Federatës Ruse. Nga një përzierje e interesave strategjike dhe lidhjeve etno-kulturore, Rusia e percepton veten si mbrojtëse e shteteve ballkanike që u formuan pas rënies së Perandorisë Osmane, shkatërrimit të komunizmit e sidomos pas ardhjes në pushtet të presidentit rus Vladimir Putin. Shekulli rus për të cilin Rusia ëndërronte pas vitit 1918 gjendet jashtë sferës së saj, për shkak të kufizimeve ekonomike dhe demografike, ndërsa 100 vjet më parë bolshevikët ishin të bindur se do ta mbisundonin atë. Por, bota me një rend të ri politik dhe në sajë të zhvillimeve progresive tekniko-teknologjike, e rendit SHBA-në në majën e politikës botërore, e cila në vitin 1917 u paraqit si një fakt demoralizues për Rusinë. Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Rusia ishin të rraskapitura dhe të thyera nga LPB-ja.

Përkundër pandemisë globale - “gripit spanjoll”, e cila gllabëroi globin me sëmundjet infektuese, vetëm SHBA-ja doli fituese nga angazhimi i saj në fund të luftës. SHBA-të arritën të vendosin shtyllat e para të Lidhjes së Kombeve dhe rendin ndërkombëtar liberal, megjithëse nuk ishin anëtare të Lidhjes për shkak të kufizimeve nga Senati. Kriza ekonomike globale dhe LDB-ja, e bënë SHBA-në edhe më të fortë për shkak pozitës gjeografike. Rrezet amerikane të lirisë filluan përhapjen në Evropën e pasluftës pasi kërcënimet e reja nga sovjetikët ishin brengosëse për të gjitha kombet. Ishte misri i kuq, mielli, qumështi në formë pluhuri i paketuar dhe ushqime tjera nga SHBA-ja që transportohej dita-ditës nëpër brigjet e Evropës Perëndimore, ish-Jugosllavisë dhe vendeve të kapluara nga kriza anembanë globit.

Me fjalë të tjera, perspektiva e anëtarësimit në BE për shtetet si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja është një opsion i mirë për Komisionin Evropian për të mbajtur stabilitetin e brishtë në Ballkanin Perëndimor. Në bazë të sondazheve, popujt ballkanikë më mirë dëshirojnë të jenë pjesë e BE-së sesa të jenë aleate ekonomike e Rusisë. Por, jo gjithnjë ka qenë kështu raporti dhe disponimi i qeverive dhe banorëve të Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi në BE është një angazhim tepër i rëndë, që nuk kërkon vetëm ndryshime ligjore, por edhe ndërrime në shoqëritë ballkanike. Për BE-në, një kaos i ri në Ballkan do të ishte një fatkeqësi për vetë evropianët. SHBA-ja me përvojën e saj ndërkombëtare goxha të madhe, bën përpjekje për të qëndruar si mbështetës ndaj mosmarrëveshjeve të shteteve të Ballkanit, gjë e cila u vërejt me disa ndërhyrje nga diplomatë të rangut të mesëm për të tejkaluar mosmarrëveshjet. Aktualisht, në grindjet për kufijtë në Ballkan dhe për anëtarësimet e reja, SHBA, BE, Turqia dhe Rusia kanë role dhe misione të ndryshme në Ballkan, ndërsa dërgimi i 1.500 trupave amerikane në Evropë është një sinjal se amerikanët do të vazhdojnë të qëndrojnë, por duke punuar kundër ndikimeve hibride ndaj shteteve të lëna në vakum. Kështu ishin raportet e Fuqive të Mëdha në fillim të viteve 50-të të shekullit XX në Ballkan, kur u vendos që Jugosllavia e Titos të ishte një shtet që do të balanconte rusët me Perëndimin. Megjithatë, politika ndërkombëtare dhe rajonale është e tillë dhe shtetet do të veprojnë në bazë të interesave të tyre kombëtare e sidomos ekonomike, për të zgjedhur ndërmjet ekonomisë euro-aziatike, ose ekonomive perëndimore.

PRESIONE TË FSHEHTA DHE TË HAPURA NGA RUSIA

Në këtë fushë zyrtarë të lartë të SHBA kanë paralajmëruar për atë që ata e quajnë “rolin gjithnjë e më shkatërrues” të Moskës në Ballkan, duke thënë se Rusia po minon demokracinë në rajon. Ish-komandanti i lartë i forcave amerikane në Evropë Curtis Scaparrotti paralajmëroi se Ballkani po përballet me një presion të fshehtë dhe të hapur nga Rusia dhe se Uashingtoni dhe NATO duhet të bëjnë më shumë për ta mbajtur rajonin larg nga Rusia. **“**BE po bën një gabim duke ndjekur strategjinë e NATO-s për zgjerim në drejtim të lindjes duke ju mundësuar vendeve post-komuniste që të bëjnë një zgjedhje midis Perëndimit apo Rusisë”, tha shefi i diplomacisë ruse Sergey Lavrov.

Zyrtarët evropianë dhe amerikanë të ndarë me vite rreth politikës së jashtme të presidentit amerikan Donald Trump, ende nuk kanë ndonjë plan afatgjatë për të parandaluar fushatën e fshehtë të Rusisë në Ballkan dhe në BE si minuese e demokracive perëndimore dhe ato fragjile. Për nga aspekti historik, humbja e Krimesë nga Rusia gjatë viteve 1855-1856, e detyroi Perandorinë Ruse të vërshojë drejt Ballkanit. Gjatë gjithë shekullit XIX, Fuqitë e Mëdha kishin qëllime të ndryshme gjeopolitike mbi “Çështjen Lindore” dhe Perandorinë Osmane.

Rusia në atë kohë dëshironte të hynte në “ujërat e ngrohta” të Mesdheut dhe këtë synonte ta bënte duke shfrytëzuar daljen e saj të natyrshme në Detin e Zi.

Rusët ndoqën një politikë të jashtme pansllave dhe për këtë arsye mbështetën fuqishëm Bullgarinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Greqinë. Britania e Madhe dëshironte t’ia mohonte Rusisë hyrjen në “ujërat e ngrohta” të Detit Mesdhe dhe Londra mbështeti integritetin e Perandorisë Osmane. Po ashtu Franca dëshironte t’i forconte pozitat në Ballkan, veçanërisht në Levant. Austro-Hungaria dëshironte që Perandoria Osmane të mos shuhet, pasi që të dyja perandoritë ishin të trazuara dhe të përbëra nga etni të ndryshme. Austro-Hungaria gjithashtu konsideronte se një prani e fortë osmane në Ballkan do të ishte një kundërpeshë ndaj thirrjeve nacionaliste serbe ndaj subjekteve serbe në Bosnjë, Vojvodinë dhe

Tendencat e politikës së jashtme të Rusisë të zbërthyera në grafikë (1682-2014)

Ngjarjet e kaluara	Vitet	Ndikimi (%)
Politika zgjeruese e Pjetrit të Madh (1682-1724) dhe Katerinës së Madhe (1762-1796) për dalje në ujërat e ngrohta në Mesdhe	1682-1724, 1762-1796	40
Konflikti ushtarak francezo-rus. Fundi i Republikës së Dubrovnikut pasoi në fillim të vitit 1808	1806-1808	60
Lufta mes Turqisë dhe Rusisë në Krime	1853-1856	20
Pushtimi i Moldavisë nga Rusia	1870-1871	60
Traktati i Berlinit. Traktati i Shën Stefanit-Traktati i paqes midis Rusisë dhe Turqisë në 1878	1878	40
Krijimi i Federatës Ballkanike pas Revolucionit të Tetorit dhe shtrirjes së ideologjisë komuniste në Ballkan	1920-1921	80
Federata Ballkanike nën ndikimin e Josif Stalinit në Ballkan-Kominterna	1919-1943	70
Përhapja e ideologjisë komuniste nga partitë komuniste nacionale të shteteve ballkanike nga emisarët sovjetikë	1919-1943	70
Konferenca e Jaltës 4-11 shkurt, 1945	1945	75
Politbyroja ruse me presidentin Tito, 1948	1948	20
Lëvizjet kundër komunizmit, Shqipëria largohet nga BRSS-ja në 1961 dhe Lëvizja e Shteteve të Painkuadruara në 1961	1961	20
Protestat në Çeki dhe Hungari në 1953-1960, Lëvizja e punëtorëve në Gdansk-Poloni në 1980	1953-1960 dhe 1980	60
Vdekja e presidentit Tito	1980	50
Shpërbërja e Jugosllavisë - RSFJ-së	1990	60
Shpërbërja e BRSS-së, rënia e komunizmit dhe reformat e Gorbaçovit	1991	30
Boris Jelcin 1991-1999. Propaganda dhe taktikat hibride. Shërbimet inteligjente GRU (1992) dhe përfaqësitë diplomatike	1991-1999	40
CIS-shtetet e 'Commonwealth-it': Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani në 1991	1991	65
Konflikti ushtarak në Ballkanin Perëndimor - lufta në Slloveni	1991	20
Konflikti ushtarak në Ballkanin Perëndimor - lufta në Kroaci	1991-1995	40
Konflikti ushtarak në Ballkanin Perëndimor - lufta në BeH	1992-1995	60
Samiti i Bukureshtit për infiltrimin në Ballkan. Kultura, feja dhe financat	2008	80
Aneksimi i Krimesë	2014	70

Tabela A. Ngjarjet historike

në pjesët tjera të perandorisë.

Rusia këtë disbalancë të re të forcave e menaxhonte mirë duke përkrahur serbët dhe bullgarët në luftën e tyre kundër osmanëve. Këta të fundit, këtë mbështetje ruse e shfrytëzuan kundër etnive tjera në Ballkan. Gjermania me politikën *Drang nach Osten* synonte ta kthente Perandorinë Osmane në koloninë e saj dhe kështu përkrahte integritetin e saj.

Në fakt, kjo politikë e re e Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë nuk shkonte në favor të Rusisë dhe Moska më pas u bë një ndër faktorët kryesorë të krijimit të "Lidhjes Ballkanike", si formë e re e pranisë dhe ndikimit. Këtë aleancë të re Rusia e shihte si mjet thelbësor në rast të një lufte të ardhshme kundër rivalit të saj, Perandorisë Austro-Hungareze dhe botës perëndimore.

Tani, një shekull nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore, Rusia po merr rol qendror në politikën e shteteve të Ballkanit duke i aktivizuar partitë nacionaliste në rajon kundër Perëndimit. Spiunazhi dhe propaganda si pjesë e strategjisë ruse të intervenimeve hibride, jo vetëm në BE, por edhe në Ballkan, e kanë pasur efektin afatgjatë në masat e gjera popullore. Duke filluar nga Beogradi, Banjalluka e deri në Shkup, metodat hibride të qeverisë ruse kanë ngjallur emocionet e vjetra të popullatës lokale. Rusia nuk është e vetmja fuqi në rajon. SHBA me vite ka bërë përpjekje që shtetet e reja të hyjnë në sferën e sigurisë perëndimore.

E gjithë kjo politikë amerikane po bëhet nën presionin e mjegullës së dendur ruse që ka përfshirë rajonin me vite. Në fund, SHBA duhet të dalë me një strategji të re dhe afatgjate për Ballkanin. Pa këtë plan të ri, rajoni vështirë se do të shkojë drejt reformave dhe largimit nga ndikimi i aktorëve malinj të shekullit. Megjithatë, Beogradi dhe Moska kanë interesa të përbashkëta strategjike për një Ballkan të ri, ku sipas planeve ruse "Serbia duhet të marrë rolin udhëheqës dhe dominues". Në Kongresin amerikan dhe sidomos nga demokratët janë lëshuar disa shqetësime serioze për këtë tërheqje të çuditshme amerikane nga rajoni, duke shpërndarë mjegull për qeveritë reformatore, por të korruptuara. Aksi i ri serborus paraqet rrezik potencial për destabilizimin e Maqedonisë së Veriut, të Kosovës dhe të Bosnjës.

Pa dyshim se gjendja nuk është e mirë në viset tjera të rajonit, ku forcat proruse në Maqedoninë e Veriut dhe në përgjithësi popullata maqedonase ende po vazhdon të ketë një preferencë të lartë për Kishën Ortodokse Ruse dhe pansllavizmin. Rrymat liberale, ose ambasadorët e kohës së presidentit Obama në Ballkan, kanë tentuar që nën presidencën e re të Trumpit të parandalojnë stacionimin e përhershëm rus në Ballkan dhe në Maqedoninë e Veriut, megjithatë në proces afatgjatë për shkak të lidhjeve emocionale të shteteve të Ballkanit, do të jetë vështirë për Uashingtonin të ketë një letër garantuese dhe mbështetje se nuk do ta kundërshtojnë në të ardhmen praninë e SHBA-ve si fuqi në jug të Gadishullit. Loja ruse do të vazhdojë të paraqesë rrezik për Evropën juglindore, në kohën kur Uashingtoni po bën lëshime dhe tërheqje strategjike nga Lindja e Mesme. Me vëmendje duhet të ndiqen raportet serboruse në dilemën "Një Ballkan me dhe pa Rusinë". Të dyja vendet vendosën lidhje në vitin 1838, duke i zhvilluar më tej marrëdhëniet diplomatike në vitin 1940 në mes BRSS së atëhershme dhe ish-Mbretërisë së Jugosllavisë. Raportet e mira serbo-ruse vazhduan edhe pas shkatërrimit të komunizmit.

Pasi në fund të vitit 1806 Perandoria Osmane u bashkua me Francën e Napoleon Bonapartës dhe u sulmua po në të njëjtën kohë nga Rusia dhe Anglia, Karagjorgji i Serbisë kërkoi nga Rusia të plotësonte kërkesat e rebelëve serbë, të cilët ishin çuar kundër forcave osmane. Rusia e cila kishte fituar statusin e një perandorie të fuqishme, në atë kohë, iu ofroi ndihmë dhe bashkëpunim serbëve. Serbia e cila nuk ishte fuqi rajonale, e pranoi ofertën e Rusisë mbi autonominë nën osmanët dhe paralelisht nënshkroi një aleancë me Perandorinë Ruse në vitin 1807. Asgjë nuk ka ndryshuar në këto 160 vitet e fundit në marrëdhëniet ruso-serbe; vetëm roli serbo-rus në Ballkan ka marrë një formë të re. Rendi rajonal i Ballkanit, që ishte si rrjedhojë e LPB-së, ishte shumë i paqëndrueshëm, pasi të gjitha shtetet e dala nga rrënojat e perandorive sollën kokëçarje të re për paqeruajtësit në Konferencën e Versajës. Pritjet e popullatës lokale dhe 'sundimtarëve' të rinj ballkanikë ndaj Fuqive të Mëdha ishin të tepërta, pasi kërkonin që Parisi, Londra, Moska, Berlini dhe Uashingtoni të merreshin me shumë sfida që buronin nga institucionet e dobëta. Prapambetja ekonomike, pakicat etnike dhe ekspozimi strategjik i shteteve ndaj fuqive të jashtme ishin pengesat kryesore të paqes së brishtë dhe të zhvillimit. Ndikimi i depresionit ekonomik ishte i rëndë në rajonin e Evropës juglindore, ekonomitë e së cilës ishin kryesisht të llojit agrar. Polarizimi politik, rritja e ekstremizmit etnik, duke përfshirë këtu edhe aktivitetin e partive komuniste dhe partive të djathta, vazhdonin të ishin faktorë në drejtim të hapjes së hapësirës për depërtimin e ideologjive të huaja në Ballkan. Pas Revolucionit të Tetorit dhe tendencave për formimin e Federatës Ballkanike, prania ruse në formën e saj ideologjike paraqiste rrezik të tërthortë për shoqëritë e sapoformuara dhe cila u bë më e rrezikshme në dy dekadat e para të shekullit XXI. Tashmë ndikimi rus është transformuar në mjete hibride kundër demokracive të reja të Ballkanit në mjediset ku popullata është me përbërje të përzier fetare dhe etnike.

INTERESIMI RUS PËR BALLKANIN, I PËRHERSHËM

Andaj, dekada e dytë e shekullit XXI tregoi se interesimi rus për Serbinë dhe Gadishullin Ballkanik është i përhershëm. Sipas Ministrisë së Jashtme të Serbisë, mbi 70 traktate bilaterale, marrëveshje dhe protokolle janë nënshkruar mes dy shteteve, duke filluar nga ekonomia, armatimi dhe burimet energjetike. Në një farë shkalle, vizitat e fundit të diplomatëve rusë do ta rritin edhe më shumë interesimin e SHBA-së për Serbinë, sepse pa një Serbi qoftë edhe jo aq perëndimore, SHBA do të ishte e pafuqishme për të vazhduar ndikimin e saj të plotë në Ballkan. Uashingtoni si duket do të fillojë një diplomaci të re me Beogradin dhe jo më atë të shkopit, por vetëm të karotave. Serbia - vend i shtatë milion banorëve, po bëhet përsëri si nyja e dikurshme jugosllave, e një rëndësie strategjike, duke thithur fonde nga jashtë në emër të sigurisë evropiane dhe amerikane.

Sipas burimeve tregtare, Rusia është tregu i katërt më i madh i eksportit të Serbisë pas Gjermanisë, Italisë dhe Bosnjës. Por, 881.3 milionë euro e barabartë me 1.1 miliardë dollarë amerikanë të importeve, janë të pakta nga gati 10 miliardë euro në mallra që Serbia i plason në tregjet e shteteve anëtare të BE-së. Politika e Perëndimit, përkundër investimeve, nuk ka dhanë rezultate pozitive në opinionin e banorëve të Serbisë, por edhe të shteteve tjera të Ballkanit.

Nga ana tjetër, Serbia ka nënshkruar "Planin e Veprimit për Partneritet Individual" me NATO në vitin 2015 dhe mbetet e angazhuar për të hyrë në BE. Serbia është e interesuar për tanke dhe automjete të blinduara, ose sistemet e mbrojtjes ajrore S-300. Sistemet raketore S-300 do ta favorizonin Serbinë në rajon, duke e



Grafiku A. Nga viti 1682 deri 2014
Lakorja me ngjyrë të kaltër tregon ndryshimet e ndikimeve ruse gjatë perandorive, suksesin, efikasitetin dhe strategjinë e ndikimit. Ndërsa, vija lineare me ndërprerje tregon mesataren e zhvendosjes së suksesit të ndikimit perandorak në proporcione evidente.

bërë ushtarakisht më të fortë se çdo shtet tjetër fqinjë.

Gara për armatim lë hapësirë për konflikt të armatosur në të ardhmen në Ballkan dhe mbetet të shihet se kush do t'i fitojë zemrat dhe mendjet e banorëve të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Kur bisedojmë rreth "Një Ballkani me dhe pa Rusinë", kjo nënkupton një rajon pa dhe me SHBA-në.

Për më shumë, "tërheqja amerikane" do t'i linte ballkanasit në një pozitë jo të mirë, të cilët në fund të shekullit XX krijuan një marrëdhënie speciale me Uashingtonin. Duke parë rajonin dhe sistemin ndërkombëtar nga këto të dhëna historike, Ballkani do të ndryshojë nga kriza evropiane, pushtimi rus i Krimesë dhe nga politikat shtetërore-nacionaliste të cilat janë jashtë parametrave demokratikë. Është e paqartë variabla se si do të vepronin kombet e rajonit në këtë vakum gjeopolitik pa ndihmën e amerikanëve.

Në këtë fazë mund do të shohim një rritje të dominimit rus në rajon, për shkak të lidhjeve historike të rajonit me Moskën. Por, çfarë do të ndodhë nëse projekti drejt BE-së së bashkuar do të dështonte, apo vetë BE-ja dhe eurozona do të shkonin drejt kolapsit?! Kur amerikanët do të ishin larguar nga rajoni, ideja për unitet në BE të ketë dështuar dhe Ballkani të jetë fragmentuar, Rusia pa dyshim se do ta plotësonte këtë vakum. Por, si çdo herë mbetet konstante variabla se si do të vepronin shtetet properëndimore në këtë vakum? Është e njohur se Rusia në një skenar të tillë do të bënte përpjekje për dominim në Ballkan. Skenari tjetër më optimist është që SHBA të vazhdojë të mbajë hegjemoninë në sistemin ndërkombëtar dhe të luajë një rol të rëndësishëm ashtu si më parë, në të gjitha qendrat e vendosjes. Aktualisht SHBA-ja është fuqia e vetme që mund të projektojë forcë në të gjithë globin, ka një ekonomi më të madhe dhe pozitë gjeografike që nuk mund ta shohim në vendet tjera që pretendojnë ta kundërshtojnë apo konkurrojnë atë.

Nga ana tjetër, Moska vazhdon ta kundërshtojë këtë prani amerikane dhe bën përpjekje të përmirësojë bashkëpunimin gjithëpërfshirës realist me vendet e Evropës juglindore. Rajoni i Ballkanit ka një rëndësi të madhe strategjike për Rusinë, përfshi rolin e saj si një qendër kryesore transporti dhe infrastrukture që përdoret për furnizimin me gaz dhe naftë në vendet e Evropës Perëndimore.

Por, rend i ri ndërkombëtar me forca të reja është krijuar edhe në të kaluarën dhe këtu më së shumti e kanë pësuar kombet-popujt që nuk kanë pasur kapacitete që të përballojnë këtë rregull, apo të kundërshtojnë forcat rivale rajonale dhe globale. Së fundi në këtë ekuacion hynë të gjithë ata që jetojnë në Ballkan. Me ardhjen e presidentit të ri amerikan Joe Biden duhet vëzhguar se si do të zhvillohen marrëdhëniet ruso-amerikane dhe implikimet e politikave të jashtme në Ballkan. Biden në një artikull për Foreign Affairs (r.b.) thotë se SHBA është e përgatitur për të udhëhequr. "Putini sipas tij dëshiron t'i thotë vetes dhe secilit që mund ta bëjë të besojë se ideja liberale është 'e vjetruar'. Por, ai e bën këtë sepse ka frikë nga fuqia e tij."

Sidoqoftë, në dekadën e tretë, deri në 2030, fuqitë perëndimore nuk duhet të nënvlerësojnë rolin e Rusisë në Ballkan, edhe pse ekonomia e Moskës është në rënie, pasi ajo ka aftësinë për të sulmuar të gjitha portet kryesore të energjisë së infrastrukturës të shteteve me lidhje të mira me SHBA-në dhe BE-në. Në vitet e ardhshme SHBA-ja duhet të ketë në fokus veçanërisht këtë lloj të kërcënimeve në Ballkanin Perëndimor. Rusia përveç luftës tradicionale, mund të përdorë opsionet tjera për të mbajtur vendet e Ballkanit Perëndimor jashtë sferës së interesave të BE-së dhe NATO-s. Blloku i 'Shteteve të Pavarura të Ballkanit' është ndër platformat ruse dhe qëllimet e përhershme të Rusisë. Aktualisht, pengesat janë të njëpasnjëshme për SHBA-në në Ballkan dhe tërheqja e menjëhershme nga Siria veçse është pjesë e paralajmërimeve se SHBA me të vërtetë po ndryshon. Në Ballkan, Uashingtoni po përpiqet të krijojë një ba-

lancë strategjike mes kombeve, por pa e definuar mirë planin afatgjatë konfuzioni i ri mund të hapë ndarje të reja dhe me pasoja për raportet e tyre. Rusia përkundër rënies ekonomike dhe të popullsisë, po bën një modernizim të shpejtë të armatimit strategjik dhe duke qenë e involvuar me propagandë arriti për një kohë të shkurtër të rrit sentimentin e vjetër pansllavist në Ballkan.

KREMLINI NUK HEQ DORË NGA POLITIKAT AGRESIVE

Në fund, BE-ja është në krizë, Rusia nuk heq dorë nga politikat agresive, kurse Ballkani vazhdon të jetë i paintegruar në strukturat perëndimore. E gjithë kjo ndikon në thyerje dhe lindjen e gjeopolitikave të reja, me kryqëzime të rëndësishme për dekadën e tretë në Ballkan. Variabla ishte e panjohur për vitin 2014 se si do të vepronin qeveritë e Ballkanit në rrethanat e pas aneksimit të Krimesë. Mirëpo, skenari u bë realitet kur Rusia veproi gjatë ndërtimit të "zonave të ftohta" të sigurisë antiperëndimore në ish-republikat jugosllave. Përveç Krimesë, sytë e Kremlinit do të vazhdojnë të jenë të drejtuar nga Ballkani, nga Baltiku dhe Lindja e Mesme. Bullgaria dhe Rumania janë një ndër pengesat e erës së politikave të zgjerimit të presidentit Vlladimir Putin. Sipas parashikimeve, "Përroi Turk" i gazit duhet të bëhet funksional dhe gazsjellësi tjetër alternativ me emrin "Teslla" mund t'i ashpërsojë marrëdhëniet e shteteve të Ballkanit me BE-në dhe SHBA-në. Për të nënshkruar marrëveshje me palën ruse, Moskës i duhen qeveri proruse dhe antiperëndimore. Rusia tenton të mbajë Ballkanin të ndezur, andaj opsioni amerikan për një Ballkan paqësor dhe stabil është më i përafërt me rrjedhat euro-aziatike.

Ulja ekonomike, korrupsioni, klientelizmi dhe jostabiliteti politik-ndëretnik vazhdojnë të mbajnë peng të ardhmen e Ballkanit. Politikanët e korruptuar në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë i kanë forcuar pozicionet e tyre në komunitetet etnike dhe me rrezik që kjo mund të shërbejë si bazë për ndërhyrje ruse. Rusia është duke e zhvilluar diplomacinë publike në shtetet e Ballkanit, por Kremlini është i lidhur ngushtë me qeverinë në Serbi dhe grupe të caktuara ultra nacionaliste, etnike dhe fetare që e duan kthimin e Rusisë në Ballkan. Ndërkohë, ashtu siç kemi nënvizuar më lart, Serbia vazhdon politikën e dyfishtë midis Uashingtonit dhe Moskës. Investimet e huaja kanë rritur oreksin e qeverisë serbe për rishikime të reja dhe mundësi për të blerë armë moderne ruse. Bosnja me plagë të vjetra mbetet pikë e nxehtë, ku BE dhe SHBA-ja si garantuese e paqes dhe stabilitetit kanë shprehur shqetësime për të ardhmen e federatës. Federata boshnjake është pothuajse e gjunjëzuar nga politikanët e papërgjegjshëm. Maqedonia e Veriut pas zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë dhe hyrjes në NATO ka lëvizur në drejtim të duhur, por së fundi zënkat me Bullgarinë dhe vazhdimi i qëndrimeve proruse i disa pjesëve të caktuara të komunitetit maqedonas janë shqetësuese. Drejtësia e pavarur, ashtu si në vendet e tjera të Ballkanit, është ende larg prej Shqipërisë, ku sentimenti rus është jo aq i theksuar. Mali i Zi u bë anëtar i NATO-s, ndërsa kapitali rus vështirë të eliminohet nga tregu malazez.

Bashkësia ndërkombëtare në këtë fazë të ndryshimeve të mëdha në Evropë duhet të ruajë ekuilibrin e sigurisë në Ballkan. Ndryshimet në BE mund të sjellin zhvillimin e skenarëve shtesë të gjeopolitikës së sektorëve. Blloku i parë ndoshta mund të drejtohet nga Serbia me pjesët tjera ku jetojnë serbët, ndërsa blloku i dytë ka gjasa të menaxhohet në të ardhmen nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Struktura e re e Ballkanit do të mbështetet nga SHBA-të si një mur i ri kundër Rusisë dhe Kinës dhe do të kërkojë pajisje ushtarake dhe personel për t'u përballur me sfidat e reja në zhvillim. Një pjesë e ushtarëve të vendosur në batalionet në Gjermani dhe në Britani të Madhe do të detyrohen të shpërndahen në shtetet mike të Uashingtonit në Ballkan, për shkak të pamundësisë së qeverive për vetëmbrojtje nga armatimi rus. Rrethoja ushtarake ndërlidhet te disa shtete që ende nuk janë pjesë e NATO-s, ose fragmentimi i tyre përbën rrezik të mundshëm për anëtarët e rinj të NATO-s. Në botën e re, BE duhet të miratojë politika të reja për Ballkanin Perëndimor, si një politikë për parandalimin e trazirave në shtetet kufitare të BE-së që janë nën ndikim rus.

Do ta përfundoj qasjen e ndikimit rus

Ngjarjet aktuale	Vitet	Ndikimi (%)
Ardhja e Vladimir Putinit në krye të shtetit	1999-2000	70
Aderimi i Hungarisë, Çekisë dhe Polonisë në NATO në 1999	1999	40
Aderimi i Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO	2009	30
Aderimi i shtatë shteteve të Baltikut në NATO në 2004	2004	40
Furnizimi me gaz i Evropës dhe Ballkanit	2010-2020	40
Çështja mes Kosovës dhe Serbisë	1998-2020	70
Roli i Rusisë në OKB	-2020	60
EAEU - Unioni Euro-Aziatik mes Bjellorusisë, Kazakistanit dhe Rusisë	2014	50
Lufta në Ukrainë	2014	70
Armatimi i ushtrisë së Serbisë	2015-2020	80
Grusht shteti në Mal të Zi	2016	40
Grusht shteti në Maqedoninë e Veriut	2017	40
Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO	2017	40
Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO	2020	30
Përdorimi i medieve dhe përfaqësive diplomatike	2000-2020	70
Republika Serbe e Bosnjës dhe lidhjet me Serbinë	2010-2020	70
Vladimir Putin riemërohet president i Rusisë	2020-2036	60

Tabela B. Aktualitetet

Sqarim (për tabelën B): Përqindjet këtu janë të kushtëzuara nga Teoria Bejziane, e cila justifikon probabilitetin e ngjarjes përkatëse. Shndërrimi në përqindje është i nevojshëm për të caktuar saktësinë e analizës dhe në të njëjtin rast të krijohet lidhja me tri ngjarjet që kërkohet në Teorinë Bejziane siç janë: ngjarja apriore (historike), e tashme (aktualitetet) dhe posteriore (parashikimi). Lexuesi duhet ta kuptojë ngjarjen aktuale si një interval kohor, që në këtë rast është ndërmjet viteve 2000 dhe 2020, për shkak të peshës që zë në zëvendësimin e formulës së probabilitetit.

në Ballkanin Perëndimor me aktivitetet e shërbimeve ruse, ku pa dyshim edhe ato perëndimore dhe të shteteve fqinjë zhvillojnë kundër njëri-tjetrit operacione klandestine në sferën e konkurrencës dhe mbrojtjes së interesave kombëtare. Inteligjenca e jashtme e Rusisë, ose **SVR**, merret me propagandën dhe dezinformimin, duke i dhënë një emër të ri artit të përdorur për operacionet e ndikimit. Qeveria ruse i dha një emër të ri, por metodat, struktura dhe punonjësit nuk ndryshuan. Sipas një raporti të "NESLINE", propaganda ruse dhe lufta psikologjike prodhohen nga një seksion sekret i **GRU** –së, i njohur si "Njësia 54777" në kuadër të "Programit të Luftës Psikologjike" të GRU-së. Për të kuptuar kompetencat e "Njësisë 54777", së pari është e nevojshme të analizojmë prejardhjen e saj. Në ish-BRSS analizat psikologjike me fokus ndikimin në masat popullore u kryen nga "Drejtoria Speciale e Propagandës", e përfshirë në Drejtorinë Masive të Ushtrisë Ruse, e quajtur "Glavpur" - **(Glavnoye Politicheskoye Upravlenie, ose Departamenti Kryesor Politik).** Në vitin 2019, ushtria ruse e festoi me krenari njëqindvjetorin e "GLAVPUR"-it, të themeluar nga Këshilli Ushtarak Revolucionar i Bolshevikëve një vit e gjysmë pas Revolucionit të Tetorit si departamenti politik për të mbikëqyrur mijëra komisarë, për të spiunuar dhe mbikëqyrur komandantët. Historikisht komunistët rusë kurrë nuk u besuan ushtarëve të tyre, pasi ushtarët rusë kishin luajtur një rol vendimtar në të gjitha përpjekjet e suksesshme për grusht shtet në historinë ruse. Ishin komisarët politikë ata që e mbajtën Ushtrinë e Kuqe gjallë dhe të organizuar, kurse besnikëria e ushtrisë sovjetike mbeti një objektiv kryesor i "Glavpur"-it. "Drejtoria Speciale e Propagandës", në teori, merrej me zhvillimin e metodave të përmbysjes së moralit të ushtrive armiqësore, por gjithashtu ishte kryesisht e përqendruar në personelin e saj ushtarak sesa në ushtarët perëndimorë. Kur BRSS u shemb, ushtria e re ruse dëshironte të shpëtonte të paktën disa pjesë të "GLAVPUR"-it, veçanërisht "Drejtorinë Speciale të Propagandës", duke e transferuar më vonë të njëjtën drejtori nën GRU-në. Presidenti rus Vladimir Putin e restauroi "GLAVPUR"-in në vitin 2018, por "Njësia 54777" mbetet nën kontrollin e GRU-së. Që nga themelimi i saj në vitin 1918, GRU ka qenë gjithmonë një shërbim inteligjence në shkallë të plotë, duke drejtuar operacione në të gjithë botën. Ndryshe nga KGB-ja, e cila u shpërbë dhe më pas u modifikua në disa agjenci të veçanta, GRU ka mbetur një institucion i vazhdueshëm gjatë epokës sovjetike dhe post-sovjetike. "Psyop" për operacionet psikologjike luftarake, të cilat zhvillohen vazhdimisht, në kohë paqeje dhe në kohë lufte, organizohen dhe ekzekutohen si operacione si nga territori i Rusisë, ashtu edhe nga territoret e vendeve që janë objekt i politikës ruse. Por, objektivat kryesore të informacionit dhe ndikimit psikologjik përcaktohen nga udhëheqja ushtarake dhe politike në drejtim të shteteve, pjesë e operacioneve ruse.

Gjatë kësaj periudhe, lufta psikologjike ruse mund të kryhet në nivelin strategjik dhe operacional në bashkëpunim me forcat dhe mjetet e agjencive federale të degëve ekzekutive të Federatës Ruse, organizatave shtetërore, civile dhe fetare.

Për më tepër, "Njësia 54777" për qëllimet e veta mund të shfrytëzojë çdo organ qeveritar dhe institucion publik ose fetar, si: Kishën Ortodokse Ruse, mediat sociale dhe kanalet televizive të drejtuara nga shteti, klubet atletike, agjencitë turistike, programet e gjuhëve ruse dhe personelin sekret civil nën mbikëqyrjen e GRU-së. Në të njëjtën linjë është edhe SVR-ja, pa-



Grafiku B. Nga viti 1999-2020

Lakorja me ngjyrë të kaltër tregon ndryshimet e ndikimeve ruse gjatë qeverisjes autoritare, suksesshmërinë, efikasitetin dhe strategjinë e ndikimit. Ndërsa, vija lineare me ndërprerje tregon mesataren e zhvendosjes së suksesit të ndikimit rus në proporcione më pak evidente, por duke shfrytëzuar metodat hibride.

sardhësi i Drejtorisë së Parë të KGB-së. Në vitin 2018, gazeta “Uashington Post” raportoi për dy organizata të dukshme të diplomacisë publike që synojnë të mërguarit rusë, por me të vërtetë drejtohen nga “Njësia 54777” dhe financohen përmes granteve të qeverisë ruse. E para është “InfoRos” dhe dyta është “Instituti i Diasporës Ruse”, i cili mban faqet e internetit të organizatave të tjera me temë të zakonshme si “Këshilli Botëror i Koordinimit të Bashkatdhetarëve Rusë” që jetojnë jashtë Rusisë dhe “Fondacioni për Mbështetjen dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Bashkatdhetarëve”. Ky fondacion u krijua me urdhër qeveritar në vitin 2011, themeluar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe “Rossotrudnichestvo.”

Nga raportet e huaja shihet se lufta psikologjike e Rusisë do të vazhdojë në të gjitha format dhe do të paraqesë rrezik të drejtpërdrejtë për të gjitha shtetet dhe Ballkanin Perëndimor. E ardhmja e rajonit do të vështirësohet në dekadën e tretë nga përplasjet ruse dhe amerikane në fushën e luftës psikologjike në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, rendi i ri evropian pas aneksimit të Krimesë, bota postpandemisë, ekstremizmi, migrimi, kriza e eurozonës, ndryshimet klimatike, politikat ekonomike kineze në Ballkan për t’i joshur qeveritë e rajonit, partnershipi i ri euro-amerikan, aktorët joshtetërorë dhe kërcënimet tjera, do ta bëjnë Ballkanin më të ekspozuar ndaj ndikimeve ruse. Vetëm një mbulesë e fortë amerikane e sigurisë do t’i bënte kërcënimet e së ardhmes më të zbehta për shtetet e Ballkanit. Halford Xhon Makinder (Sir Halford John Mackinder) dhe Nikollas Xhon Spikman (Nicholas John Spykman) me teoritë e “Heartland-it” dhe “Rimland-it”, i vendosën bazat e rivalitetit të forcave në sistemin ndërkombëtar. Nëse ata sot do të ishin gjallë, me siguri se më së miri do të mund ta parashikonin të ardhmen e Ballkanit dhe rolin rus.

[i]Kobilov, Firdavs. 2020. "Internationalaffairshouse." *AIIA.* 7 24. Accessed 11 3, 2020. https://www.internationalaffairshouse.org/russian-role-in-western-balkans-does-russia-act-as-a-power-or-security-maximizer/.

[ii]Joe Biden. 2020. Foreign Affairs. 3 15. Accessed 11 7, 2020. https://www.foreignaffairs.com/articles/united-states/2020-01-23/why-america-must-lead-again?

[iii] Andrei Soldatov. Michael Weiss. 2020. "Newline." https://newlinesmag.com/. 12 7. Accessed 12 10,2020. https://newlinesmag.com/dispatch/inside-russias-secret-propaganda-unit/?fbclid=IwAR1xRncFIj7JoBKjz8RekNy1mX-tdfAeH3lsqGGu55yQ4dZfj6zdij9RVoQ.

Tabela C. Ngjarjet e parashikuara në dekadën e tretë

Ngjarjet e dekadës së tretë	Vitet	Ndikimi (%)
Presidenti Putin dhe Rusia do të vazhdojnë trendin e qeverisjes autoritare në dekadën e tretë	2020-2030	80
Popullsia e Rusisë do të ketë rënie, bazuar në trendet demografike	2020-2030	50
CAPTA, do të ketë rënie	2020-2030	50
Rusia do të vazhdojë politikat e pushtimit të shteteve fqinje, zhvillimit të metodave inteligjente	2020-2030	65
Në vendet e Ballkanit me popullatë ortodokse dhe kulturë të njëjtë Rusia do të rrit investimet në mësimin e gjuhëve, të historisë dhe të kulturës ruse	2020-2030	70
Forcimin e propagandës në vendet e Ballkanit Perëndimor	2020-2030	70
Intervenime dhe përpjekje për përçarje në mjediset multietnike	2020-2030	65
Dislokimin e teknologjisë ushtarake	2020-2030	70
Përdorimin e gazit si mjet politik dhe ekonomik	2020-2030	75
Shfrytëzimi i resurseve natyrore për rivalitet ekonomik ndaj Perëndimit	2020-2030	70
Përdorimin e vetos në Këshillin e Sigurimit në OKB	2020-2030	90
Forcimin e medieve që propagandojnë politikën ruse	2020-2030	90
Operacionet kibernetike	2020-2030	85
Blerjen e figurave politike duke përdorur metoda korruptuese	2020-2030	70
Insistimi për hapjen e korridoreve drejt Adriatikut, në Neum të Bosnjës	2020-2030	60
Krijimi i zonave speciale ushtarake dhe qendrave strategjike inteligjente në Ballkan	2020-2030	80
Ndërtimi i centraleve nukleare për prodhimin e energjisë bërthamore (në Bullgari)	2020-2030	50

Sqarim (për tabelën C): Siç e përshkruam zgjidhjen e problematikës më lart, që lidhet me ndikimin rus në “Dekadën e Tretë”, përqindjet janë projeksione të varura nga ngjarjet e mëparshme si ajo “Historike” dhe “E tashme”. Ndërsa Teoria Bejziane ngjarjet e ardhshme i lidh më fort me ngjarjet e kaluara (historike). Pra, nga kjo nënkuptojmë se parashikimet analitike në mënyrë statistikore janë reale duke u bazuar në historikun e ngjarjeve në periudhat kohore të ndryshme.

Grafiku C. Parashikimi nga 2020-2030



Lakorja me ngjyrë të kaltër tregon rritjen e ndikimit, e ilustruar me anë të lakores, që tregon varësitë nga metodat hibride, si dhe tendencën e njëtrajtshme të rritjes së politikave të jashtme ruse në dekadën e tretë.

SHEJH SHAMILI DHE CAR NIKOLLA

Car Nikolla i dërgon shejh Shamilit një letër, në të cilën ai thotë se nëse ai heq dorë nga ideja e organizimit të myslimanëve në Kaukaz nën një flamur, ai do t'i ofrojë atij një gradë të lartë, një kurorë në kokë dhe do t’i japë një thesar të madh.

Përgjigjja e shejh Shamilit në këtë letër ishte mahnitëse:

"Unë jam Shamili, i cili lufton për pavarësinë dhe lirinë e Kaukazit! Unë jam një mysliman që betohem të mos ia kthej shpinën Allahut për carin e kësaj bote të përkohshme. Po e bëj të qartë për herë të fundit, me këtë letër, se nuk do t'i përgjigjem kësaj ftese. Kështu, edhe nëse trupi im i vdekshëm do të copëtohet dhe nëse kjo tokë në të cilën jetoj do të shkatërrohet. Kjo është përgjigjja ime, të cilën car Nikolla dhe shërbëtorët tuaj duhet ta dinë! Nuk ia kthej shpinën Allahut dhe do ta vazhdoj rrugën deri në vdekje."



Më pas ndodhën shumë luftëra të përgjakshme. Forcat ruse u mposhtën betejë pas beteje. Car Nikolla i emëroi gjeneralët e tij më të shquar për të kontrolluar Kaukazin. Gjeneralë ishin Fraytag, Svarts, Klugenav dhe Argutinski, që kishin mundur Napoleonin. Ishte kjo ushtri e posaçme, e cila përbëhej nga 50 mijë burra. Sulmet nisën në katër drejtime të ndryshme. Por, përsëri rusët e humbën betejën karshi myslimanëve.

Burimet ruse këtë luftë, e cila u zhvillua në vitin 1843, e tregojnë si më poshtë: "Shamili shkatërroi gjithçka në Avaristan. Ai kapi bazat tona, të tilla si Unsoluk, Balakan, Moksok, Ahalchi, Tsanah, Hassat, Gergebil, Burunduk, Hunzah, Nizovaye, Ziran dhe Gimry dhe shkatërruan gjithçka. Shpenzuam shuma të mëdha, pësuam humbje të tmerrshme të njerëzve në Avaristan. Duhet të konkludojmë se kjo ishte beteja më e ashpër dhe më e dëmshme që kemi përjetuar ndonjëherë."

Kjo luftë e poshtëroi car Nikollën I dhe i shkatërroi planet e tyre.

Shejh Shamili është i njohur si luftëtar më i madh i luftës guerile në historinë e botës. Vdiq në Medinë, pasi kreu haxhin më 4 shkurt të vitit 1871, në moshën 74-vjeçare. Është varrosur në varrezat e quajtura Baki. Në këto varreza shtrihen burrat dhe gratë që dëgjuan thirrjen e Pejgamberit (a. s.) dhe dhanë jetën për kauzën e tij. Allahu e mëshiroftë!

Përgatiti: prof. Bujamin Salija
(në bashkëpunim)

FIGURA ISLAME: HFZ. HALID EF. QAMILI (1908-1989)

NURI I FLISTE ME HESHTJE

Hfz. Halid ef. Qamili lindi në vitin 1908 në Tetovë, në një familje të vjetër qytetare. Mësimet e para do t’i marrë te hoxha i mirënjohur i asaj kohe, hfz. Sulejman ef. Shehapi, tek i cili edhe do ta kryejë hifzin.

Pas kryerjes së hifzit do të punësohet si myezin në Xhaminë e Gam-Gamit. Në vitin 1948, duke shkuar në xhami për ta thirrur ezanin e sabahut, nga forcat policore të regjimit të atëhershëm do të rrëmbehet dhe do të dërgohet në ‘Monopol’.

Pas disa ditëve do të vdesë imami i Xhamisë, hfz. Havzi efendiu. Për pasojë, ky do të lirohet nga ‘Monopoli’ për ta përgatitur xhenazen dhe varrimin e hoxhës së nderuar.

Prej vitit 1948 deri në vitin 1975, deri në pensionim, do të jetë imam në Xhaminë e Gam-Gamit. Nga viti 1975 deri më 1989 do të vazhdojë të shërbejë në xhami si mualim.

Hfz. Halid efendiu në mesin e tetovarëve njihet si një ndër mualimët më të mirë të asaj kohe. Një pjesë e madhe e tetovarëve kanë bërë hatme të Kurani Qerimit para hoxhës së nderuar.

Përpos mësimit të Kuranit, hoxha i nderuar ka përgatitur dhe ka nxjerrë edhe disa hafëzë. Njëri prej kandidatëve për hafëz kam pasur nderin të jem edhe unë (Hysein Rizai), por për shkaqe shëndetësore të hoxhës, nuk arrita ta përfundoj hifzin.

Një karakteristikë tjetër e hoxhës së nderuar është se ai e ka mbajtur evidencën e leximit të hatmes ditore në Tetovë, ku themelues i kësaj tradite ishte hfz. Abdylxhemil ef. Jusufi (Bambari). Hatmja ditore fillimisht lexohej në Xhaminë e Çarshisë dhe pas rrënimit të Xhamisë, në vitin 1965, transferohet në Xhaminë e Sahatit dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Hfz. Halid ef. Qamili për realizimin e kësaj detyre të ndershme - leximin e hatmes ditore hartoi planprogramin, me anë të të cilit i emëronte lexuesit e hatmes brenda vitit kalendarik, i caktonte çdo lexuesi xhuzin, mbante kontrollin mbi lexuesit dhe i zëvendësonte lexuesit në rast

sëmundjeje apo të vdekjes së tyre. Ai këtë detyrë e bëri me përgjegjësi, duke lënë pas vetes dokument të shkruar, që tashmë është pjesë e Arkivit të Myftinisë së Tetovës.

Hafëzi ishte i heshtur. Në fakt, fliste nuri i tij. Pas një sëmundjeje të shkurtër, ai vdes në vitin 1989. Lajmi i vdekjes pikëlloi jo vetëm familjen e tij, por edhe të gjithë ata që e njihnin.

Hfz. Halid ef. Qamili u varros në varrezat e qytetit të Tetovës, në prezencën e një numri të madh të xhematit nga Tetova dhe rrethina. Allahu e mëshiroftë!

Përgatiti: Dr. Hysein ef. Rizai

KALON NË AHIRET IMAMI I MATEÇIT, NEBI EF. MEMEDI

"O ti shpirt i bindur plotësisht. Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar. Hyr në turmën e robve të Mi. Dhe hyr në xhenetin Tim."

Me dhimbje dhe pikëllim të thellë në orët e hershme të datës 8 shtator, 2022, morëm lajmin për kalimin në Ahiret të Imamit të Xhamisë së fshatit Mateç, hoxhë Nebi ef. Memedi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Hoxhë Nebi ef. Memedi u lind më 2.03.1963 në fshatin Mateç. Si imam i fshatit, ishte i përpiktë në kryerjen e detyrave që kishte. Merhumi si imam ka punuar disa vite edhe në Perëndim, në shumë xhami, në vende të ndryshme, prej të cilave kemi fjalë miradije.

Myftinia e Kumanovës humbi një imam dhe punëtor, i cili tërë jetën ia kushtoi shërbimit të fesë.

H.Nebi ef. Memedi u nda nga kjo botë kur më së shumti kishte nevojë për të familja e tij, fshati dhe Myftinia e Kumanovës, por ashtu ka qenë caktimi i Allahut fuqiplotë.

Njerëzit e mirë dhe të devotshëm si h. Nebi ef. Memedi gjithmonë lënë pas vetes dhembje, por edhe kujtime të mira, prandaj vepra e tij jetësore prej personi të ndershëm është ngushëllim edhe për familjarët dhe të gjithë ata që e kanë njohur.

Në emër të Myftinisë së Bashkësise Fetare Islame të Kumanovës dhe në emrin tim personal, i shpreh ngushëllime familjes së hoxhës, duke lutur Allahun e madhërishëm që familjes t'i japë durim në tejkalimin e kësaj dhembje të madhe, hoxhën ta mëshirojë dhe të na bashkojë në Xhenetin Firdeus. Vesselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu, thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftiut të Myftinisë së Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri.

U takofshim në Xhenet, vëllai ynë mulla Nebi Memedi-ka shkruar prof. Naser Ramadani në faqen e vet në Facebook.

Varrimi i merhumit është bërë në varrezat e fshatit Mateç.

BFI NË DHIMBJEN E FAMILJEVE QË HUMBËN TË RINJTË

Vizitë ngushëlluese në familjet që këto ditë humbën bijtë e tyre: në familjen e të rinjve të ndjerë Elmedin Izairi në Bogovinë, Adas Shabani në Dobërdoll, Elfat Neziri në Debresh, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 5 shtator, 2022.

Ndamë dhimbjen dhe parkrahjen e BFI në emër të të gjithë besimtarëve dhe të institucioneve të saj. Me lutjen drejtuar Allahut fuqiplotë, që t'u japë durimin e paluhatshëm, ndërsa merhumëve t'u falë xhenetin e amshueshëm.

Falënderojmë shoqëruesit - Myftiun e Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me bashkëpunëtorë, Sekretarin e Përgjithshëm z. Irsal Jakupi, me të cilët ishim bashkë në këto të pame. Vizitat ngushëlluese i koordinuan Sekretari i Myftinisë së Tetovës h. Namik ef. Xhaferi, bashkë me imamët dhe vaizët e fshatit Bogovinë: h. Akik Misini, h. Xhemaludin ef. Misini, h. Ejup ef. Mazllami dhe z. Blendi Imeri, i angazhuar në Myftininë e Tetovës.

Vërtet, ajo që të jep kurajo është sabri i prindërve, të cilët me plot bindje të imanit kanë pranuar caktimin e Allahut fuqiplotë, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

IKU NË AMSHIM ÖMER TUĞRUL INANÇER

Më 4 shtator, 2022, kaloi në amshim mistiku i njohur turk Ömer Tuğrul Inançer. Mistiku, juristi, avokati, muzikanti dhe shkrimtari i njohur u lind në vitin 1946 në Bursa të Turqisë, ka shkruar Musanif Rufati, Drejtor i Kulturës në Rijasetin e BFI të RMV, në një shkrim enkas për "Hënën e Re".

Inançer shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Bursa, kurse më pas vijoi studimet në Universitetin e Stambollit, ku mbaroi Fakultetin Juridik. Afërsisht njëzet vjet punoi si konsulent dhe avokat, ndërsa nga viti 1991 filloi angazhimin e tij si drejtor në Ansamblin Historik të Muzikës Turke të Stambollit në Ministrinë e Kulturës dhe të Turizmit.

Në vitin 2011, për shkak të moshës, kaloi në pension.

Ömer Tuğrul Inançer ka marrë pjesë në programe të ndryshme radiotelevizive si artist i ftuar dhe ka realizuar aktivitete muzikore në shumë koncerte vendore dhe ndërkombëtare. Ai gjithashtu mbajti shumë konferenca dhe mori pjesë në seminare brenda dhe jashtë vendit për çështjet e sufizmit. Përveç konferencave, ai ka qenë shumë aktiv edhe me ligjërata në lidhje me sufizmin, me artin dhe kulturën turke.

Që nga viti 1999 ishte drejtor i "Fondacionit të Kërkimit dhe të Mbijetesës së Muzikës dhe të Folklorit Sufi Turk". Ka shkruar 8 libra dhe shumë ese të ndryshme mbi mistikën islame.

Veprat e tij janë: Gönül Sohbetleri (2006), Gönül Gözü (Kenan Gürsoy ile, 2006), Dinle Neyden & Mesnevi Sohbetleri (2009), Muhabbet Peygamberi Hz. Muhammed (sav) (2010), Vakte Karşı Sözler (2012), Bir Muhammedî Aşık: Hz. Mevlana (2012), Sohbetler (2013), Mübârek Vakitler (2014) etj. – përfundon Musanif Rufati.

Zëri i Ömer Tuğrul İnançer-it kishte tingull të pakrahasueshëm. Ishte shërbyes i dy hilafeteve: Halveti Xherrahi dhe Mevlevi, ka shkruar Enris Qinami (Tiranë), pasi ka dhënë lajmin për ndarjen nga jeta të mistikut turk.

Ömer Tuğrul İnançer ka ndërruar jetë në moshën 83-vjeçare, duke lënë pas vetes libra dhe shkrime të shumta që i drejtohen ndërgjegjes dhe shpirtit të njeriut, thotë Abdullah Klinaku (Prishtinë).

Në gjuhën shqipe, sa kujtoj, janë botuar dy libra të tij: "Biseda shpirti" dhe "Dëgjoje nejin ç'thotë" nga "Logos-A", Shkup, që janë shumë frymëzues dhe motivues. Për atë çfarë dimë e çfarë njohim për kontributin e tij, Zoti e mëshiroftë dhe e faltë, ka shkruar në faqen e vet në Facebook Abdullah Klinaku.

Ashikët nuk vdesin, veç e ndërrojnë një vend – ka shkruar hoxha Havzi Ramadani (Tetovë).

Në vazhdim ai ka dhënë hadithin "Me të vërtetë Allahu nuk e merr dijen duke e shkulur atë (prej gjokseve të njerëzve), por e merr atë me vdekjen e dijetarëve."

Profesor Sulejman Mehazi (Tetovë) ka sjellë disa citate nga librat shqip të Ömer Tuğrul Inançer-it: "Lexojeni si duhet luftën për liri dhe pavarësi. Mos u kufizoni vetëm me librat e shkollës. Mos e shikoni atdheun të krijuar vetëm nga toka. Mos e shikoni vetëm nga trualli dhe fushat. Zbuloni atdheun kulturor. Zbuloni atdheun e dijes. Ruajini ato nga pushtimi." ("Biseda shpirti")

"Dashuria nuk është çmenduri, është marrëzi..., është një sjellje e hijshme me edukatë; ...dashuri quhet kur të mençurit i thonë lamtumirë mendjes dhe urdhërohet nga zemra. Të braktisësh mendjen me vullnet nuk është çmenduri. Kur ndodh pa vullnet, atëherë është sëmundje." ("Biseda shpirti", fq. 193)

"Dashuria nuk klasifikohet, është si kajmaku brenda qumështit. Kajmaku nuk ka shtresë të parë, të dytë, të tretë...të pestë; kajmaku është kajmak." ("Biseda shpirti", fq. 218)

Zoti na bashkoftë në botën e përtejme të bukur parajsore! – ka shkruar prof. Sulejman Mehazi në Facebook më 4 shtator.

Filloi rikonstruktimi i Xhamisë Eski në Tetovë. I lutemi Allahut fuqiplotë që sa më shpejt të përfundojnë punimet në këtë xhami, kurse kontribuesit t'i shpërblejë me më të mirat e Tij! – thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së BFI-Tetovë, prof. dr. Qani ef. Nesimi. (1.09.2022)

ZOTI E MËSHIROFTË AMBASADORIN RAMADAN NAZIFI

Më 3 shtator, 2022, ka ndërruar jetë në Berlin (Gjermani), ku ishte me detyrë, Ambasadori i RMV Ramadan Nazifi. I ndjeri është varrosur me nderime të larta shtetërore dhe fetare më 7 shtator në vendlindje, në Radushë (Shkup).

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu familjes i ka drejtuar mesazhe ngushëllimi, ku thuhet: "Ndërrimi jetë i Ambasadorit z. Ramadan Nazifi është një humbje dhe dhimbje e madhe për të gjithë ne. Ai ndërroi jetë duke kryer me nderin më të madh detyrën e diplomatit shqiptar, Ambasador i RMV në Berlin të Gjermanisë.

I ndjeri tërë jetën ia kushtoi arsimit dhe dijes, që i rezymoi me aktivitetin diplomatik si Ambasador në Zvicër dhe tash në Gjermani. Jeta e tij edhe një herë tregoi idealin e një intelektuali që diti të prezantojë me suksesin më të madh dinjitetin tonë kombëtar dhe fetar, e në veçanti të prezantojë me sukses vlerat e vendit nga vinte.

Në emër të Bashkësisë Fetare Islame dhe në emrin tim personal, i shprehim ngushëllime të thella familjes dhe popullit në përgjithësi dhe i bëjmë lutje të Madhit Zot që t'i falë xhenetin e amshueshëm, ndërsa familjes t'i japë durimin e paluhatshëm.

Zoti e mëshiroftë të ndjerin, Ambasadorin Ramadan Nazifi, thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Iku dhe Dani ynë! – ka shkruar Irfan Agushi nga Zvicra, me origjinë nga Radusha.

Për punën e tij flet gjithkush nga këndi i tij. Shumë njerëz patën nderin ta njohin për së afërmi, të mësojnë nga urtësia e tij, të përfitojnë dhe të veprojnë me këshillat e tij.

Unë kisha fatin, thotë Irfan Agushi, që në radhë të parë si familjarë, ta takoja në ditë gëzimi dhe në ditë hidhërimi që kishim në familjet tona. Iku Dani ynë - ashtu e thirrnim ne në familje Ambasadorin Ramadan Nazifi.

Në rolin e imamit dhe të gazetarit, me Danin në rolin e diplomatit, mikut dhe familjarit, jemi takuar shumë herë në vende të ndryshme - dikur në Shkup, e më vonë edhe në Zvicër.

Sonte (3 shtator, 2022) me ju do të përndaj një takim që kishim bashkë në kohën kur unë isha Imam në xhaminë Ikre në Thun.

Ishte ditë uikendi. Atë ditë kishim ftuar në xhaminë e re përfaqësues të lartë të Komunës, të Kantonit, të Departamentit të Arsimit, të Departamentit të Sigurisë dhe përfaqësues të tjerë. Tema kryesore ishte xhamia dhe roli i saj në rrafshin e sigurisë.

Nuk më kujtohet mirë në çfarë roli ishte prezent Ambasadori Ramadan Nazifi në atë takim, por ajo që më la përshtypje ishte paraqitja e tij para përfaqësuesve të shtetit helvetik. Në fakt, kur ne iu thamë të pranishmëve se në xhami ishte prezent edhe Ambasadori i Maqedonisë (së Veriut), u ndie menjëherë një lloj relaksimi në mesin e tyre. Këtë e vërtetuan më pas edhe bisedat e lira me ta.

Ne e prezantuam dhe i dhamë mundësinë të thotë dy-tri fjalë në këtë takim. Mes tjerash, më kujtohet që me një gjermanishte të bukur, iu tha të pranishmëve se është brengë edhe e institucionit që ai udhëheq mirëqenia dhe integrimi i popullatës sonë në shtetin helvetik.

Në varrimin e kushëririt tim, të Ambasadorit Ramadan Nazifi - Allahu (xh. sh.) e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus, ka shkruar në faqen e vet në Facebook, pranë fotografisë që ka publikuar, hoxha mr. Imer ef. Jusufi nga Radusha, Imam në Kërçovë.

Në një mënyre elegante foli për fetë dhe historikun e tyre në vendin tonë. Më pas shtoi diçka mbi tolerancën fetare ndër shekuj te shqiptarët dhe në fund u falënderua për mundësinë që i ofruam për të mbajtur fjalimin.

Përfaqësuesit komunalë më vonë na thanë se kishin qenë të nderuar që në këtë takim, në nivel lokal, të merrte pjesë Ambasadori i një shteti tjetër. Ne, shumë më shumë ishim të nderuar.

Njëherë tjetër - unë në rolin e gazetarit, e ai në atë të diplomatit, u takuam në një manifestim me rastin e pavarësisë së shtetit shqiptar. E pyeta se cili ishte dallimi mes Zvicrës dhe Gjemanisë sa i përket punës dhe aktivitetit të tij, pasi më herët kishte qenë në Gjermani – në Bon. Ai më tha se edhe këtu në Zvicër ndihet shumë mirë, por i duhej të punonte shumë, pasi çdo javë ishte në lëvizje. „Çdo javë kemi më shumë se tri ftesa dhe kjo bën që të premteve dhe të shtunave të jemi në terren gjithandej në mbarë Zvicrën", më thoshte.

Nuk më besohet që sonte po shkruaj një artikull për Danin.

Allahu e mëshiroftë, i faltë mëkatet dhe e bëftë nga banorët e xhenetit.

Miqve, shokëve, kolegëve, familjes - e sidomos familjes së tij të ngushtë - u shpreh ngushëllimet e mia më të thella.

Bëjmë dua për shpirtin e tij!

Përcillet nga Ebu Derda (Allahu qoftë i kënaqur me të) se Pejgamberi (salallahu alejhi ve selam) ka thënë: "Duaja e myslimanit që bën për vëllain e tij, në mosprezencë, është e pranuar dhe pranë kokës së tij qëndron një melaqe e ngarkuar që thotë: 'Amin, edhe për ty qoftë si ajo!' - sa herë që ai lutet për vëllain e tij." (Muslimi)

Allahu i Madhërishëm na bëftë nasib xhenetin dhe vendtakim me gjithë myslimanët - ka shkruar Irfan Agushi.

U NDA NGA JETA E KËSAJ BOTE HFZ. EMRI EF. HIRDA



Më 13 shtator, 2022, u nda nga jeta e kësaj bote hfz. Emri ef. Hirda (i lindur në vitin 1957), thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Telegram ngushëllimi familjes i ka dërguar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në të thuhet: Ndërroi jetë hafëzi i mirënjohur Emri Hirda nga Shkupi. Me dhimbje të thellë e përjetuam këtë lajm të rëndë.

Hafëz Emri Hirda tërë jetën ia kushtoi Islamit. Me zërin dhe mekamin e tij të bukur dhe jashtëzakonisht të këndshëm, dërgonte në zemrat e besimtarëve dashurinë ndaj fjalës së Allahut fuqiplotë, Kuranit famëlartë.

Ai e ngriti lart vetëdijen e besimtarëve, ndërsa te të rinjtë leximi i bukur i Kuranit famëlartë nxiste dhe inspironte pa masë që t'i rreken leximit të Fjalës së Allahut fuqiplotë. Leximin e Kuranit e përjetonte në mënyrën më të lumtur, duke lexuar në qendrat e ndryshme të Ballkanit dhe në gara ndërkombëtare. Me dinjitet përfaqësoi besimtarët e vendit. Ishte i urtë, i sjellshëm dhe i këndshëm me njerëzit.

Ndërrimi jetë i hafëzit Emri ef. Hirda është dhimbje dhe humbje për të gjithë ne, në veçanti për BFI të RMV. Andaj, familjes dhe gjithë besimtarëve u shprehim ngushëllime, me lutje drejtuar Allahut të Madhërishëm që rahmetliun ta mëshirojë me xhenetin e amshueshëm. Amin – thuhet në telegramin e ngushëllimit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Myftiu i Myftinisë së BFI-Shkup, dr. Qenan ef. Ismaili, në mesazhin e ngushëllimit familjes së merhumit, xhematlinjve të Shkupit dhe të gjithë atyre që e njohën hafëz Emri ef. Hirdën ka shkruar: Nga thellësia e zemrës i shprehim familjes së tij ngushëllimet më të sinqerta në emrin tim dhe në emër të Myftinisë së BFI-Shkup.

Familja e tij humbi njeriun e tyre të dashur, ndërsa Shkupi dhe xhemati i Shkupit një hafëz të përkushtuar me zërin e tij të dalluar, që i shërbeu xhematit dhe xhamisë gjatë gjithë jetës së tij, duke filluar nga Xhamia Isa Beu, pastaj disa vite radhazi në Novi-Pazar gjatë muajit të Ramazanit dhe së fundmi në Xhaminë Bedër në Butel.

I bëjmë lutje Allahut të madhërishëm që merhumin ta shpërblejë me Xhenet për kontributin e tij, ndërsa familjes t'ia shtojë durimin – thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Më 14 shtator, me namazin e drekës, iu fal namazi i xhenazes rahmetli Emri ef. Hirda, hafëz i mirënjohur i trevave tona, thuhet në njoftimin e BFI.

Në Xhaminë e Bedrit në Butel mevludin për shpirtin e merhumit e lexuan hoxhë Ferit ef. Selimi dhe Atullah ef. Ibrahimi. Ishin të pranishëm: Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Myftiun e Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Kryetari i Kuvendit të BFI h. Fejsal ef. Kadriu, Sekretari i Përgjithshëm z. Irsal Jakupi, Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim ef. Iseni dhe shumë ulema islamë. Në fjalën e tij Reis'ul-Ulemaja ngushëlloi familjen e ngushtë dhe shprehu dhimbjen në emër të BFI të RMV, si dhe foli për veprat madhore në shërbim të Islamit të hafëz Emri ef. Hirda.

Imami i Xhamisë së Bedrit, h. Ferit ef. Selimi, në emër të besimtarëve dhe të familjes u shprehu falënderime të gjithë të pranishmëve, duke përmendur disa segmente të mira të jetës së rahmetliut. Duanë e bëri Myftiu Qenan ef. Ismaili, ndërsa namazin ia fali kushëriri i merhumit, hafëz Atullah Ibrahimi.

Pjesëmarrja masive e xhematlinjve dëshmoi veprat dhe jetën e begatshme të rahmetliut. Zoti e mëshiroftë me xhenet merhumin, thuhet në njoftimin e BFI.

Hafëz i Kuranit, Imam i Xhamisë, zëri i ëmbël i qytetit të Shkupit, njeriu me bilbil në zemër,

freskia e shpirtit të xhematit, hafëz Emri Hirda (1957-2022): Shpirti Juaj - Lule Xheneti.

Ngushëllime familjes, fisit të gjerë dhe xhematit të pikëlluar, ka shkruar veprimtari i njohur Daim Hiseni, Shkup, në faqen e vet në Facebook më 14 shtator.

Varrimi u bë në fshatin Nikushtak, ka njoftuar hafëz Atullah Ibrahimi.

BFI: NGUSHËLLIME INSTITUCIONEVE ISLAME NË BOTË

Ndërron jetë veprimtari i madh, dijetari i mirënjohur dr. Jusuf el-Kardavi, i cili tërë jetën ia kushtoi Islamit dhe shpjegimit të vlerave të tij, thuhet në njoftimin e Shërbimit për Informim të BFI të RMV.

Është një humbje e madhe, sepse dr. Jusuf el-Kardavi ishte dijetar me një veprimtari të nivelit më të lartë, i cili i vendosi bazat e shpjegimit të Islamit në botën moderne, në veçanti: në sferën e jurisprudencës islame - Fikhut.

Ai i dha impuls të fuqishëm aktualizimit të Islamit dhe ishte inspirim i gjallë për të gjithë botën islame. Në të njëjtën kohë, ia prezantoi njerëzimit dhe botës vlerat islame, duke e bërë atë pjesë të fuqishme të mendimit shkencor, intelektual, moral etj.

Edhe pas kalimit në botën tjetër, dr. Jusuf el-Kardavi me veprat e tij të shumta, nga të gjitha sferat, ngel inspirim i së tashmes dhe i së ardhmes, drejt zhvillimit edhe më të madh të mendimit islam në botë.

Në emër të BFI të RMV dhe në emrin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef Fetahu,

u shprehim ngushëllime institucioneve islame në botë, myslimanëve dhe familjes më të ngushtë, me lutje Allahut fuqiplotë që ta pranojë në mëshirën e tij dhe ta shpërblejë me Xhenet.

Ne, të bindur dhe të kënaqur me caktimin e Allahut fuqiplotë, e themi këtë: "Vërtet, ne jemi të Allahut dhe vetëm tek ai do të kthehemi." (El-Bekaretu: 156) – Amin!, thuhet në njoftimin e Shërbimit për Informim të BFI.

KARDAVI: PSE PRAPAMBETJE?

Pretendimi se ligjet e pandryshueshme, të cilat përbëjnë një pjesë të legjislacionit islam, kanë bërë që vendet islame të jetojnë jetë beduine, larg civilizimit dhe zhvillimit, është i pabazë.

Këtu do të përmendim dy aspekte për ta demantuar këtë pretendim:

1.Vendet me shumicë myslimane, me pak përjashtime, nuk e zbatojnë legjislacionin islam, nuk e marrin për bazë legjislaturën islame, por pjesa më e madhe e tyre i zbatojnë ligjet laike, të cilat i kanë importuar prej Perëndimit. Për këtë, Islami nuk është fajtor pse këto shtete kanë ngelur të prapambetura.

2.Myslimanët kur u janë përmbajtur ligjeve të sheriatit islam, dhe kur gjyqësori ka vepruar sipas parimeve të legjislacionit islam, si dhe kur ata kanë jetuar në bazë të parimeve islame, kanë qenë në majë të civilizimit dhe e kanë udhëhequr njerëzimin. Në atë kohë ata kanë qenë mësues të botës, në lindje e në perëndim, dhe kjo ka zgjatur tetë shekuj me radhë. Atëbotë ata kanë qenë "vende të zhvilluara" dhe "populli më i ngritur", gjë që e kanë konstatuar historianët e civilizimit dhe të shkencës.

Islami ka qenë shtytësi i parë për ndërtimin e këtij civilizimi, që është veçuar me hyjnitet, me humanizëm, me moral dhe me universalitet. (Nga: Jusuf el-Kardavi, 'Fetva bashkëkohore', vëll. IV, fq. 190)

Përgatiti: Bashkim Aliu

NDAHET NGA KJO BOTË DIJETARI I MADH JUSUF EL-KARDAVI

Më 26 shtator, 2022, në Doha (Katar) është ndarë nga kjo botë dijetari i madh nga Egjipti Jusuf el-Kardavi (Youssef Qaradhawi), njofton bashkëpunëtori i rregullt i "Hënës së Re" Bashkim ef. Aliu.

Një jetë të tërë me sakrifica dhe përkushtim në rrugën e dijes, me trashëgimi të pasur shkencore, me mendime dhe fetva të rëndësishme për myslimanin bashkëkohor - vepra që më së miri flasin për profilin e tij intelektual; ideator i shumë nismave të dobishme për myslimanët; një mendje e ndritur me vizion të qartë...ky ishte Shejhu i cili me veprimtarinë e tij shënoi epokën në të cilën jetoi, si dhe vuri imza në thesarin e dijes dhe të thirrjes islame në shekujt XX dhe XXI. Një enciklopedi e dijes islame. Allahu të mëshiroftë, Shejh; ishte nder për mua që të takova, thotë Bashkim ef. Aliu.

Sipas mr. Artan Musliut, Abdullah el-Kardavi u lind më 9.09.1926 në fshatin Safet Turab, rrethi Gharbia, Egjipt. Fshati njihet për historikun e lashtë, ndërsa në të është varrosur edhe sahabiu i ndershëm Abdullah ibn Harith ibn Xhuzej ez-Zubejdi.

Që në moshën dhjetëvjeçare arriti të mësonte përmendsh Kuranin, rregullat e leximit dhe të dispozitave të tij.

Ka pasur një jetë shumë të vështirë, pasi që në moshën dyvjeçare i vdes i ati dhe kujdesin ndaj tij e merr xhaxhai.

Është arrestuar dhe është burgosur disa herë për shkak të qëndrimeve të tij. Për herë të parë arrestohet në vitin 1949, në kohën e sundimit të mbretit Faruk, ndërsa arrestohet edhe tri herë gjatë sundimit të Xhemal Abdunaserit.

Ka qenë i martuar dhe ka shtatë fëmijë-katër vajza dhe tre djem. Që të gjithë janë të shkolluar.

Ka studiuar në Fakultetin e Usul Dinit në Universitetin e Ez'herit, ku edhe diplomohet në vitin shkollor 1952-1953, si studenti më i dalluar. Në vitin 1973 doktoron në drejtimin e shkencave të Kuranit dhe të Sunnetit, duke marrë titullin Doktor Nderi, pasi që ishte me suksesin më të lartë që kishte njohur ndonjëherë ky fakultet. Doktorata e tij titullohej "Zeqati dhe ndikimi i tij në zgjidhjen e problemeve shoqërore".

Dr. Jusuf el-Kardavi është autor i afër 200 librave, autor i shumë punimeve shkencore, shumë fetvave dhe i një mori emisionesh televizive të incizuara. Librat e tij janë pritur shumë mirë në botën islame, andaj edhe janë përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe po ashtu edhe në gjuhën shqipe, në të cilën janë përkthyer mbi 50 tituj.

Prej librave të tij më të njohur mund të cekim: "Hallalli dhe harami", "Fetva bashkëkohore",

"Hyrje në studimin e sheriatit islam", "Fikhu i xhihadit", "Fikhu i pakicave myslimane",

"Fikhu i zeqatit" etj. – ka shkruar mr. Artan Musliu.

Sipas Eljasa Mahmudit, Shejhu ka lënë gjurmë të pashlyeshme në veprimtarinë e tij prej thirrësi në rrugën e Allahut, i cili gjatë tërë jetës së tij ishte zëri i arsyes, i argumentit dhe i mendimit të shëndoshë islam. Allahu e mëshiroftë dhe në Xhenetin Firdeus me pejgamberët, shehidët, me njerëzit e mirë dhe me dijetarët e Ummetit e bashkoftë! Amin!

Sot u largua një mendje e ndritur, njeriu që gjithë jetën ia kushtoi rrugës për te Zoti, dijetari që me librat e tij ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në kuptimin e Islamit dhe të jetës njerëzore, Jusuf el-Kardavi, pena e artë që foli të drejtën, larg egos dhe interesave personale, ka shkruar Vladimir Kera (Tiranë).

"Vdekja e dijetarit është një shembje në fortesën e Islamit." (Darimi, Mukaddime, 32, 1/351)

Një nga arsyet pse vdekja e dijetarëve është kaq e dëmshme, është se ata morën rolin kryesor në edukimin dhe arsimimin pas shpalljes që i erdhi Pejgamberit (a. s.), ka shkruar Ardit Hoxhllaku në faqen e vet në Facebook.

Gurët e themelit të pallatit islam janë dijetarët. Vdekja e një dijetari nënkupton rënien e një guri nga ndërtesa, hapjen e një të çare në këtë mur të rëndësishëm. Allahu e mëshiroftë me xhenet dijetarin dr. Jusuf el-Kardavi, i cili ia dorëzoi shpirtin Zotit të gjithësisë, ka thënë ai.

Të lumtur ishim pse jetuam në epokën e prof. Kardavit, por dhe ndiejmë dhimbje e pikëllim të thellë për vdekjen e tij, shkruan Driton Arifi.

Shejh Jusuf el-Kardavi është dijetari që gati për një shekull shndriti botën me dijen, me asketizmin, me guximin dhe mendjeprehtësinë e tij. Thuhet në Kuran: "(Dijetarët) do të jenë së bashku me ata që Allahu i begatoi: (me) pejgamberët, (me) besnikët e dalluar, (me) dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!" (En-Nisa: 69)

Vdiq duke mbetur zëri që artikuloi më së miri dertin, hallin dhe aspiratën e çdo myslimani në këtë kohë! Zot, merre me mëshirën Tënde të gjerë, siguroje për të Firdeusin e mos i lër myslimanët pa dijetarë të tillë, gjer në Kiamet! – thotë Driton Arifi.

Hoxha dhe Profesori ynë, falënderojmë Allahun (xh. sh.) që të patëm. Me ju do të ngelë krenar ummeti islam përgjithmonë, ka shkruar prof. Jusuf Zimeri në faqen e vet në Facebook. Ndarja e një dijetari të këtij kalibri nga mesi ynë është zbrazëtirë e madhe, por Allahu bën atë që do, ndërsa vepra juaj është e pavdekshme, andaj lutemi që Allahu t'ju ketë pranuar në mëshirën e Tij të përhershme dhe t'ju gradojë me Xhenetin Firdeus. Amin – ka thënë ai.

Për ndarjen nga kjo botë të dijetarit dr. Jusuf el-Kardavi kanë shkruar me dhjetëra njohës të jetës dhe të veprës së tij - shqiptarë e të tjerë. (HeR/desk)

Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شـــهادة للمنتجات الحلال

Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com